



universität
wien

UNIVERSITÄT LEIPZIG

MASTERARBEIT / MASTER THESIS

Titel der Masterarbeit / Title of the master thesis

Rhetorik und Kommunikation in der Albanischen Politik

Verfasser / Author

Irida Vorpsi

angestrebter akademischer Grad / academic degree aspired

Master (MA)

Wien, 2009

Studienkennzahl :

A 067 805

Studienrichtung::

Individuelles Masterstudium:
Global Studies – a European Perspective

Betreuer/Supervisor:

Ao.Univ.-Prof. Dr. Oliver Schmitt

Abstract in English

This master thesis addresses the ties of Rhetoric and Communication in the Albanian politics. It is aimed to demonstrate its pivotal role by analyzing the patterns of this process in the post communist society. Using research communicative methods, the paper offers a theory-based analysis of the situation of communication in Albania with a focus on the role of media and its functions in the process of communication intertwined with empirical research using anthropological elements like interviewing a set of politicians, member of the Albanian Parliament. By analyzing the impact of the communication's elements like language, faith and the use of different communication types on the way politicians frame their position in relation to the public, I want to crystallize how representative is this communication in the Albanian politics. The used methodology (analyzing a case study of a country in transition like Albania) and the implementation of the text analyses of the interviews and speeches unfolds in this paper how rhetoric provides a useful tool for measuring the interviewees' progress in the political sphere. The analyses of the relationship between media and politics want to draw upon the importance of considering the politics as a production of the media. This product is framed by rhetoric and the other elements of communication that contribute to bridge the message from the politicians to the recipient. To intertwine theory with practice, the theoretical framework is applied to the interviews by illustrating through the canonical narrative schema the relationship between rhetoric, communication and political sphere.

By portraying the above mentioned ties between rhetoric, communication process and politics as a crucial framework in which the politicians project their political future, the paper reveals a very important dimension of the political communication in unfolding complex social relations in a post communist society

Einführung

Diese Masterarbeit behandelt die Verknüpfungen zwischen Rhetorik und Kommunikation in der albanischen Politik. Sie hat zum Ziel, deren entscheidende Rolle zu demonstrieren, indem die Muster dieses Prozesses in der postkommunistischen Gesellschaft analysiert werden. Unter Verwendung von Methoden der Kommunikationsforschung bietet die Arbeit eine theoriebasierte Analyse der Kommunikationsverhältnisse in Albanien mit Schwerpunkt auf der Rolle der Medien und ihrer Funktionen im Kommunikationsprozess; dies wurde verflochten mit empirisch-anthropologischer Forschung, wie Interviews mit einer Reihe von albanischen Politikern und Abgeordneten des albanischen Parlaments. Durch die Analyse der Auswirkungen von Kommunikationselementen, wie Sprache, Glaube und die Anwendung von diversen Kommunikationstypen auf die Art und Weise, wie Politiker ihre Positionen in Bezug zur Öffentlichkeit festlegen, möchte ich herauskristallisieren, inwieweit diese Kommunikation für die albanische Politik repräsentativ ist. Die verwendete Methodik (die Fallstudie eines Transitionslandes wie Albanien) und die Durchführung einer Textanalyse der Interviews und Reden in dieser Arbeit legt offen, wie Rhetorik ein brauchbares Instrument zur Einschätzung der Vorgangsweise der Interviewten im politischen Bereich sein kann. Die Analysen der Beziehung zwischen Medien und Politik möchte auf die Bedeutung verweisen, die eine Betrachtung der Politik als ein Produkt der Medien haben kann. Dieses Produkt wird von Rhetorik und den anderen Elementen der Kommunikation bestimmt, die dazu beitragen, die Botschaft von den Politikern zu den Empfängern zu übermitteln. Um Theorie mit Praxis zu verflechten, wurden die theoretischen Rahmenbedingungen bei den Interviews insofern angewendet, als die Beziehung zwischen Rhetorik, Kommunikation und politischem Bereich durch den narrativen Kanon illustriert wird. Durch die Darstellung der oben angesprochenen Beziehungen zwischen Rhetorik,

Kommunikationsprozessen und Politik als entscheidende Rahmenbedingungen, in welchen die Politiker ihre politische Zukunft planen, macht die Arbeit eine sehr wichtige Dimension der politischen Kommunikation deutlich, die die komplexen sozialen Beziehungen in einer postkommunistischen Gesellschaft offen legt.

Pasqyra e lëndës

1. Hyrje	7
2. Aparati metodologjik	12
2.1. Përzgjedhja e grupeve të intervistuar	13
2.1.1. Vështirësitë dhe problematika	14
2.1.2. Mënyra dhe kushtet e zhvillimit të intervistave	17
2.2. Instrumentët antropologjikë	19
2.2.1. Lista e pyetjeve dhe mënyra e formulimit të tyre	20
3. Situata e komunikimit në Shqipëri. Vështrim i përgjithshëm	23
3.1. Roli i medias si pjesë sendërtuese e procesit të komunikimit në Shoqërinë shqipëtare pas viteve '90.	24
3.1.1. Tiparet e komunikimit	26
3.1.2. Funksionet e medias në procesin e komunikimit	28
3.2. Llojet e komunikimit	30
3.2.1. Gjuha dhe komunikimi	36
3.2.3. Feja dhe etnija si elementë të komunikimit në Shqipëri	38
3.3. Media dhe politika: një marrëdhënie komplekse: Rasti i Shqipërisë post komuniste	40
3.3.1. Politika si prodhim i medias	42
4. Retorika dhe elementët kryesorë në analizën e procesit të komunikimi	46
4.1. Retorika dhe komunikimi	46
4.2. Analizë teksti	52
4.2.1. Vështrim teorik	52
4.2.2. Analizë e intervistave të politikanëve të rrangut të parë	55
4.2.3. Analizë e intervistave të politikanëve të rrangut të dytë	60
4.2.4. Analizë e intervistave të politikanëve të rrangut të tretë	68
5. Përfundime	75
6. Bibliografi	82
7. Apendix	85

1.Hyrje

Retorika dhe komunikimi në politikën shqiptare është fokusi i studimit tim modest në përmblyllje të studimeve 2 vjeçare Master pranë Universitetit të Leipzig-ut dhe atij të Vjenës në kaudrin e programit Erasmus Mundus, Global Studies- A European Perspective.

Tema e përzgjedhur nuk është një rastësi, përkundrazi vjen si një nevojë e brendshme për të analizuar më thellë dhe në prerje tërthore situatën e komunikimit politik dhe rolin e retorikës në politikën shqiptare. Nevojë për të parë përtej lustrës së fjalimeve, demagogjisë së momentit, kushtëzimit të situatave. Mendoj se pas pothuajse 20 vitesh pluralizëm politik, është mjaft interesante të analizohet gjuha me anë të së cilës ky pluralizëm materializohet dhe bëhet i prekshëm për publikun dhe sa kjo gjuhë ndikon në karrierën politike të secilit. Është e udhës të flasim për elementë të mirëfilltë komunikimi dhe analizën ta bazojmë tek të tillë syresh duke mbajtur gjithmonë parasysh brishtësinë e sistemit në fjalë, një marrëdhënie e vështirë dhe e komplikuar mes emetuesit dhe receptuesit.

Po përse u zgjidh pikërisht komunikimi? Kjo qasje nuk është e rastësishme, ajo bazohet në atë që sot komunikimi përfaqëson: një metodë njohjeje që nuk ka ngelur pa lënë gjurmë në një gamë të gjerë fushash përfshirë këtu edhe historinë. E konsideruar si e tillë, pra si një metodë për të zbërthyer e analizuar fenomene e ngjarje, komunikimi është shumë i vlefshëm, sidomos në ligjërimin politik dhe në thellimin e analizës së shkakut dhe pasojës. Në këtë këndvështrim bien muret e ndasisë së shkencave duke shkrirë edhe kufijtë e hulumtimit dhe analizës së ndarë të fenomeneve dhe ngjarjeve. Një paradigmë e re na ndihmon për t'i analizuar ato: paradigma e ndërveprimit të individëve në shumë forma. Komunikimi në fakt nuk kushtëzohet domosdoshmërisht me konceptin e medias së shkruar që asociohet rëndom, përkundrazi, mediat janë vetëm një pikë në oqeanin e pafund të elementëve komunikues, një ndërmjetësues mes individit dhe botës që e rrethon në tërësinë e saj.

Por do të përqëndrohem edhe tek ajo sepse siç sugjeron Fuga, në Shqipërinë postkomuniste, është pikërisht shtypi i shkruar që mban pozicionin e medias më të privilegjuar në komunikimin e ideve¹. Nëse thellojmë mendimin dhe i referohemi Pedler-it, ky shtyp i shkruar është po aq i rëndësishëm në rolin e tij kulturor të krahasuar me atë të medias audio vizive në shekullin e XX-të².

Pa pretenduar se me anë të këtij punimi do t'i jepet përgjigje shumë diskutimeve në fushën e komunikimit dhe retorikës në politikën shqiptare si një fushë shumë e gjerë dhe e pasur me problematikë të larmishme, unë modestisht do të jap kontributin tim duke përdorur metodat studimore komunikative për të paraqitur një studim empirik bazuar në një analizë të hollësishme të një grupi intervistash dhe fjalimesh marrë një grupi parlamentarësh si përfaqësues të institucionit më të lartë ligjvënës në Shqipëri.

Këtu më duket me vend të shpjegoj dhe arsyen pse besoj se një studim i tillë është një shërbesë e mëtejshme në përpjekjen për të kuptuar sesi elementët e komunikimit janë bërë pjesë e shoqërisë shqiptare në një fushë të caktuar siç është komunikimi politik, proces ky i ngadaltë dhe mbarsur me fenomene tipike shqiptare, por jo vetëm.

Periudha e viteve 1990-2009 karakterizohet nga një realitet shumë interesant në një përpjekje të vazhdueshme për të instaluar një regjim demokratik, pjesë e të cilit është padyshim dhe klasa politike dhe mënyra sesi ajo ka ndërtuar marrëdhëniet jo vetëm mes shtresave të ndryshme brenda vetes, por edhe me ambientin e jashtëm. Një tranzicion i stërzgatur që mbart me vete shumë dramë dhe traumë, tronditje të rëndë të vlerave morale dhe adaptimin e një sistemi të ri ekonomik të shoqëruar me kriza të vazhdueshme ekonomike, sociale dhe politike.

¹ Fuga, Les mots dans la communication politique en Albanie, 11.

² Pedler: Sociologie de la Communication, 55.

Pjesë e kësaj panorame është edhe sistemi komunikues që politika ka ndërtuar me publikun, sistem ky që nuk mund t'i shpetojë luhatjeve dhe tensioneve që vetë shoqëria shqiptare ka përjetuar në këto vite duke mos patur një strategji orientuese, por duke u udhëhequr nga spontaniteti dhe sporadizmi dritëshkurtër.

Mungesa e kësaj strategjie ka çuar në raste ekstreme siç janë imitimet e këqija të modeleve ndërkombëtare pa u përpjekur t'i përkthejë në përvojë të vetën, por duke ndjekur shabllone shumë të huaja për realitetin specifik shqiptar ose duke ndjekur kokëfortë një rrugë të pashkelur më parë e duke sfiduar çdo rekomandim e këshillim, duke e futur veten në qorrsoakë institucionale e politike që vështirë se mund të harrohen. Më poshtë do të vijojë dhe zbërthimi hap pas hapi i tematikës së këtij punimi duke shpjeguar dhe metodologjinë kërkimore. Metodologjia e përdorur është ajo e zgjedhjes së një rasti studimor siç është rasti i një shoqërie në tranzicion (në rastin tim Shqipëria) dhe brenda këtij rasti do të kryhet një analizë krahasuese e fjalimeve dhe intervistave të marra grupit të ligjvënësve duke u fokusuar në elemnetët retorikë të përdorur prej tyre gjatë procesit të komunikimit.

Një pjesë të konsiderueshme të kapitullit të dytë do ta zërë dhe shpjegimi i procesit të formulimit të pyetësorit, mënyra sesi janë hartuar pyetjet, dilemat dhe vendimi për të hartuar një pyetësor larg pyetjeve me kontekst polemik, shumë neutral dhe duke mos prekur tema që do të mund të ilarizonin bashkëbiseduesin.

Është e ditur se cilësia e një kërkimi varet nga cilësia e mjeteve të mbledhjes së të dhënave dhe duke u nisur nga fakti se intervistimi dhe administrimi i pyetësorëve janë nga teknikat më të përhapura të kërkimit, unë do të ndalem në përshkrimin e tyre me hollësi duke u mbështetur dhe në instrumentët antropologjikë të përdorur.

Ajo çka dua të theksoj është rëndësia e intervistave kokë më kokë. Rëndësia e intervistave interaktive dhe përgatitja e pyetjeve të hapura duke lejuar kështu edhe përgjigje vetëm

pjesërisht të kategorizuara. Një hap i rëndësishëm që kërkon patjetër sqarimet përkatëse është përzgjedhja e grupit kampion të politikanëve që janë intervistuar duke u nisur nga grupet fillestare dhe duke argumentuar ndryshimet që janë bërë gjatë procesit të intervistimit për arsye subjektive krejtësisht të pavarura nga procesin i kërkimit.

Në vijim të këtij kapitulli do të kristalizohen vështirësitë e tejkaluara në kontaktimin e tyre, një proces që do të meritonte një studim më vete, por që nuk është në qendër të analizës së mëtejshme, edhe pse shkarazi do të preket si pjesë themelore e imazhit publik duke shpalosur karakteristikat e një kulture politike të cunguar shprehëse e një mentaliteti parrokial. Natyrshëm do të përshkruhet edhe mënyra e zhvillimit të intervistave, ambientet dhe kushtet përkatëse. Në kapitullin vijues do të përqëndrohem në një përshkrim deskriptiv të situatës së komunikimit politik në Shqipëri, situatë kjo që nuk mund të analizohet e shkëputur nga situata e përgjithshme e shoqërisë shqiptare.

Bëhet fjalë për një situatë të trazuar në dallgët e tranzicionit institucional, politik, ekonomik dhe social. Në qendër të këtij kapitulli do të jetë dhe retorika e përdorur në politikë si një ndër elementët kryesorë që kanë ndikuar dhe vazhdojnë të ndikojnë në procesin e komunikimit.

Kapitulli i katërt do të përqëndrohet në një analizë teksti të intervistave dhe fjalimeve të grupit kampion të politikanëve duke u thelluar në retorikën dhe elementët gjuhësorë të përdorur dhe duke shfrytëzuar metodën krahasuese.

Kapitulli i fundit do t'i kushtohet përfundimeve të nxjerra dhe do të përbëhet nga shqyrtimi i tezës fillestare të kërkimit dhe konkluzionet e nxjerra gradualisht gjatë procesit të hulumtimit dhe kërkimit. Ky kapitull do të kristalizojë tezën se komunikimi dhe retorika në politikën shqiptare gjatë periudhës e tranzicionit 1990-2009 në Shqipëri nuk janë zhvilluar ndryshe

nga hallkat e tjera të shoqërisë, përkundrazi kanë ndjekur ritmet e këtyre zhvillimeve jo rrallë tronditëse.

Situata e komunikimit në Shqipëri do të vijë nëpërmjet një vështrim të përgjithshëm, vështrim ky që do të hulumtojë rolin e medias si pjesë sendërtuese e procesit të komunikimit në shoqërinë shqiptare pas viteve '90 duke u ndalur në tiparet e komunikimit, por jo vetëm. Një pyetje që do të marrë përgjigje gjatë këtij punimi është edhe ajo, e cila i referohet funksioneve të medias në procesin e komunikimit dhe kjo do të arrihet nëpërmjet analizës së llojeve të komunikimit dhe marrëdhënies mes

gjuhës dhe komunikimit. Elementë shumë të rëndësishëm të komunikimit në Shqipëri konsiderohen edhe ai fetar dhe etnik, elementë këta që do të gjejnë pasqyrimin e duhur. Por si sillet media me politkën dhe vice versa?

Çfarë lloj marrëdhënie kanë ndërtuar ata dhe sa ndikon kjo e fundit në procesin e komunikimit me publikun? Prodhon politika lajm në media, apo është media që prodhon politikë dhe nëse po, si e realizon këtë proces?

Po retorika? Si ndikon ajo në procesin e komunikimit? Për t'ju përgjigjur njërës prej pyetjeve më të rëndësishme siç është kjo e sapopërmendur, do të merret në shqyrtim edhe raporti mes retorikës dhe komunikimit, raport ky do të zbërthehet më tej në të gjithë elementët e tij përmes analizës së teksit, e cila do të kryhet për të tre grupet në të cilat janë klasifikuar politikanët e intervistuar . Synohet të hulumtohet shkalla e përfaqësueshmërisë së këtij komunikimi dhe sa ndikon ajo në zhvillimet politike, përfshirë këtu dhe karrierën të vetë politikanëve të intervistuar.

Unë nuk pretendoj të rindërtoj historinë e këtyre viteve përmes intervistave, por dua të sjell dhe të parashtroj vizionin komunikues të politikës përmes tyre. Pra vlera e shtuar nuk qëndron në interpretimin tim, por në analizën e aktorëve të kohës pa të cilët ky komunikim

do të ishte një rrugë vetëm me një drejtim. Kjo është arsyeja pse janë zgjedhur si mjete intervistat dhe fjalimet në Kuvendin e Shqipërisë.

Komunikimi nuk është një trup amorf që mund të transplantohet në politikën shqiptare i huazuar nga ndonjë strategji në gjuhë të huaj, ai është një proces shumë kompleks dhe i ndërlikuar, pasqyrues i pagabuar i një shoqërie dhe gjithë problematikës që ajo mbart. Në Appendix do të jenë të transkriptuara intervistat e marra duke iu vënë në dispozicion kujtdo që ka interes për to.

Kapitulli II

Aparati metodologjik

Siç u përmend edhe në kapitullin hyrës, analiza e hollësishme empirike bazohet në intervistat e marra dhe në fjalimet e grupit kampion të ligjvënësve të intervistuar. Duke qenë se një kërkim shkencor i plotë duhet të bazohet jo vetëm në paraqitjen e përfundimeve, por edhe në përshkrimin e procesit, i cili i ka bërë të mundur këto përfundime, më duket me vend bërja transparent e këtij procesi duke u ndalur veçanërisht në krijimin dhe modifikimin e grupit kampion të intervistuarve dhe në shpjegimin e procesit të formulimit të pyetësorit duke u fokusuar në mënyrën e hartimit të tij.

Metodologjia e përdorur është ajo e zgjedhjes së një rasti studimor sic është rasti i një shoqërie në tranzicion(në rastin në fjalë Shqipëria) dhe kryerja e një analizë teksti krahasuese e fjalimeve dhe intervistave të marra grupit të ligjvënësve duke u fokusuar në elementët retorikë të përdorur prej tyre gjatë procesit të komunikimit duke synuar një përfundim përmbljedhës, i cili do të zbulojë rolin që luan retorika në komunikimin e klasës politike me publikun dhe si shfrytëzohen prej saj elementët e veçantë të tij.

Ky kapitull në pjesën e parë do të trajtojë mënyrën e formimit të grupit kampion të të intervistuarve dhe vështirësive që kam hasur në zhvillimin e intervistave, vështirësi këto që

kanë çuar edhe në ndryshimin e përbërjes së grupit të politikanëve të intervistuar. Më tej do të pasqyrohet dhe mënyra e zhvillimit të intervistave.

Pjesa e dytë përmban një vështrim fotografik të instrumenteve antropologjike të përdorur, listës së pyetjeve të formuluar dhe mënyrës së formulimit të tyre.

Në mbyllje do të argumentoj përzgjedhjen e fjalimeve si një prej elementëve kryesorë të analizës krahasuese, sepse kjo përzgjedhje nuk është e rastësishme, përkundrazi.

2.1. Përzgjedhja e grupeve të intervistuar

Pas fazës së parë kërkimore që është fokusuar kryesisht në leximin e materialeve, librave dhe artkujve që kanë lidhje të drejtpërdrejtë apo edhe të tërthortë me tezën kryesore dhe që kanë kristalizuar përpunimin e saj, nis edhe faza e përgjedhjes së grupit të politikanëve, intervistat e të cilëve do të jenë në qendër të analizës së tekstit që do të kryhet në kapitujt në vijim duke i dhënë formë kërkimit empirik. Mbështetja tek baza teorike është gjithmonë shumë e rëndësishme dhe unë këtu dua të sqaroj edhe arsyet e zgjedhjes sime për të intervistuar një grup të caktuar tek i cili do të fokusohem.

Po çfarë është një grup tek i cili fokusohemi? Sa i rëndësishëm është ai në një studim empirik dhe si procedojmë për të përfutur një të tillë sa më përfaqësues?

Për fat të keq më duhet të pranoj se sado përpjekje të bëj, nuk mund të gjithëpërfshij të tërë spektrin politik shqiptar me gjithë ndarjet e nëndarjet e tij dhe kompleksitetet që përfaqësojnë në grupin e të intervistuarve.

Gjithsesi jam munduar t'i mbetem besnike parimit për të lundruar në mënyrë të balancuar sa majtas e aq djathtas, për të sjellë formulën e përfaqësimit gjinor në politikë, për të mos mbetur peng e centralizimit të politikës në kryeqytet, por për të sjellë edhe refleksin sesi shihet politika shqiptare në pasqyrën e komunikimit në të gjithë territorin shqiptar.

Për këtë jam kujdesur të intervistoj ligjvënës nga jugu në veri, nga perëndimi në lindje duke u thelluar edhe në shtresa të ndryshme brenda politikës. Në këtë listë gjejmë nga politikanët e karrierës tek “profanët” e politikës dhe jam e mendimit se intervistat individuale të kryera prej meje mund të gjenerojnë hipoteza, por mbetet për tu analizuar aftësia e tyre për të përgjithsuar konkluzione të shtrira në hapsirë dhe në kohë si prerje tërthore e klasës politike shqiptare duke konsideruar numrin e këtyre intervistave.

2.1.1. Vështirësitë dhe problematika

Për të bërë një përfaqësim sa më të gjerë të klasës politike shqiptare së bashku me udhëheqësin tim menduam që grupin e politikanëve ta ndanim në tri shtresa kryesore: në shtresën e parë do të përfaqësoheshin politikanë të rrangut të parë në pozicionet drejtuese dhe në këtë listë u përfshinë:

Jozefina Topalli (PD); Fatmir Mediu (PR) Edi Rama (PS); Ilir Meta (LSI) Ben Blushi (PS) duke patur një përfaqësim sa gjinor, fetar, krahinor dhe politik të kënaqshëm.

Grupi i dytë përfshinte fillimisht politikanë me një profil më të ulët politik, por gjithsesi aktivë në jetën politike në rrangje ministrash dhe ish ministrash: Vangjel Dule (PBDNJ); Majlinda Bregu (PD); Aldo Bumci (PD); Bujar Leskaj (PD) dhe në grupin e tretë përfshiheshin intelektualë të mirëfilltë të angazhuar në kohë në politikën shqiptare, por pa patur një investim të përhershëm në të : Gjovalin Prenga (PD); Parid Teferici (PD) Pëllumb Xhufi (LSI) Besnik Bisha (PD); Tritan Shehu (PDR); Prec Zogaj (PD). Arsyeja pse zgjodha si metodologji në këtë rast intervistat individuale ka lidhje me vetë mënyrën sesi ato nuk e humbin përqëndrimin tek individit duke ofruar një mundësi më të madhe për të eksploruar në horizontin e gjerë të personalitetit të të intervistuarit ³ dhe ky është një nga synimet e mia: kuptimi më i thellë dhe i detajuar i fenomeneve dhe situatave shpeshherë shumë komplekse tek

³ Ritchie, Lewis, *Qualitative Research Practice*, 37.

të cilat janë bazuar pyetjet e formulara duke pasur ndrojnë se klasa politike shqiptare akoma nuk e ka arritur atë pjekuri qytetare që do t'i çlironte nga komplekset e përballjes me intervistën individuale. Edhe në këtë rast droja nuk ishte e pabazuar. Marrja e kontaktit me grupet e sipërpërmendura nuk rezultoi aspak e lehtë, përkundrazi shumë më e vështirë sesa e kisha menduar.

Rruga aq e thjeshtë në dukje, ajo zyrtare dështoi menjëherë sapo unë u përballa me pamundësinë për të kontaktuar si një qytetare e thjeshtë më të zgjedhurit qendrorë dhe vendorë. Numra telefoni të papërditësuar, mungesa e zyrave të pritjes dhe frenezia e fushatës elektorale në prag i bënte politikanët si Jozefina Topalli, Edi Rama apo Ilir Meta absolutisht të paarrtshëm për një studente në kërkim të një interviste. Në prag të dëshpërimit mu desh të kërkoja ndihmën e miqve dhe të njohurve të përbashkët, por pa sukses të dukshëm.

Niveli i komunikimit të politikanëve të grupit të parë kufizohej në rastin më të mirë me sekretaret apo shefat e kabinetit që nuk premtinin asgjë, as edhe 5 minuta nga koha e çmuar e shefave të tyre të zënë nga ethet e fushatës. Mendoj se është me vend ta përmend edhe këtë fazë si pjesë përbërëse e komunikimit, në këtë rast e atij të munguar. Më vjen ndër mend një episod aspak i këndshëm në selinë e LSI (Lëvizjes Socialiste për Integrim) ku më është dashur të shkoj tri ditë rrjesht e shoqëruar nga mospërfillja dhe moskorrektësia e kryetarit të kësaj partie edhe pse për intervistën e ndërmjetësuar nga një i njohur i përbashkët kishte rënë parimisht dakort. Kryetarët e minsitrat nuk përfillnin një intervistë që do të shërbente për një kërkim shkencor, ata i druhashin një fjale të thenë më tepër në prag të fushatës elektorale dhe kërkonin të jepnin vetëm intervista me shkrim duke pozuar me buzëqeshje të stampuar për ndonjë të përditëshme, intervista këto që do ti sillnin fryte të shpejta në zgjedhjet e fundit të qeshorit. Si përfundim, rrugëtimi im drejt mëmëdheut rezultoi me pak frytdhënës seç e kisha menduar: në listën time të të intervistuarve nuk kishte femra politikane të përfaqësuar,

por kjo për zgjedhjen e tyre: as Jozefina Topalli (Grupi i I-rë) dhe as Majlinda Bregu (Grupi i II-të) nuk gjeten asnjë hapsirë në axhendën e tyre për një intervistë 10 minutëshe.

Të njëjtin qëndrim mbajti dhe Fatmir Mediu, i cili i shmangej intervistave pas tragjedisë së Gërdecit, skandal ky që e detyroi të japë dorëheqjen. Nuk pata mundësi të kontaktoj as me Edi Ramën, shefin e opozitës shumë të zënë edhe duke bërë kryetarin e Bashkisë së kryeqytetit. Bujar Leskaj dhe Preç Zogaj pranuan të ma dërgonin intervistën me anë të postës elektronike, emaile që kurrë nuk mbërritën në kutinë time postare. Një ish- minsitër i Kulurës që i druhet një interviste të drejtëpërdrejtë do të ngjallte habi kudo në botë, përveç se tek unë që njihja këshilltarin që i shkruante fjalimet gjatë kohës që ishte minsitër dhe mbase nuk e konsideronte veten në lartësinë e tij në momentin që duhej të fliste vetë para një diktofoni. Në këto kushte mu desh të ridimensionoja diferencimin e grupeve dhe të zëvendësoja të intervistuarit e „paarritshëm“ me kolegë të tyre duke shpresaur se kësaj radhe gadishmëria do të ishte në një nivel më të lartë. Gjatë gjithë kësaj kohe kam punuar duke bluar në kokë pyetjen: Nëse ata nuk kanë kohë për një intervistë, sa kohë reale i dedikojnë kontaktit me elektoratin dhe qytetarin e thjeshtë? Si mundën të ndërtojnë ura komunikimi me zgjedhësit e tyre? Në fakt duke mos pranuar të intervistohen ata i mohuan vetës të drejtën për tu shprehur në lidhje me disa çështje shumë të rëndësishme të cilat zinin pjesën më të madhe të retorikës së tyre politike, por nuk ma mohojnë mua të drejtën morale për të analizuar edhe këtë komunikim të munguar.

Githsesi unë e përshkrova të tërë procesin e përgatitjes së diferencimit të grupeve duke ndjerë nevojën e të qenit e sinqertë më veten dhe në respekt të të intervistuarve, por pa dashur të dal në konkluzione të përshpejtuara.

Në respekt të punës së kryer dhe duke falenderuar të intervistuarit për kohën e dedikaur, fokusi i analizës sime do të jenë vetëm politikanët me të cilët munda të kontaktoj

personalisht. Intervistat e plota të tyre gjenden në Apendix në shërbim të secilit që dëshiron të njihet me përmbajtjen e tyre.

2.1.2.Mënyra dhe kushtet e zhvillimit të intervistave

Për zhvillimin e intervistave unë kisha menduar se do të kryheshin në vende sa më të qeta duke reduktuar në maksimum elementët që do të sillnin shpërqëndrim. Por për çudinë time të gjitha intervistat janë kryer në kafene. Asnjë nga politikanët/politikanet e intervistuar nuk la takim në zyrë, por në kafenetë pranë tyre. Për mendimin tim ky është një indikator edhe për mënyrën jashtë klasikes që propagandojnë politikanët shqiptarë. Kam pasur personalisht mundësinë për të kryer një praktikë pranë një deputeteje në Bungestag-un gjerman dhe të ndjek nga afër metodologjinë dhe modalitetet sesi funksiononte komunikimi i deputetëve me elektoratin dhe gazetarët në Perëndim. Deputetët do të flasin për ekzistencën e një zyre të tyre edhe gjatë intervistave, por adresat nuk janë të shpallura dhe as mundësitë e kontaktimit. Mungesa e intervistave të zhvilluara në zyrat përkatëse është një argument në favor të verejtjes së mësipërme, që thekson të qenit të veçantë të politikanëve shqiptarë edhe në mënyrën sesi ndërtojnë urat e komunikimit me publikun.

Duke iu kthyer modalitetit të zhvillimit të intervistave, fillimi i tyre është gjithmonë i lidhur me shpjegimin e qëllimit dhe formatit të saj.

Ajo çka jam përpjekur të kem gjithmonë në mendje është se i intervistuari duhet lejuar të sqarojë çdo dyshim që mund të lindi mbi përgjigjet. Si parim, edhe pse intervistat janë të regjistruara, unë kam mbajtur shënime në mënyrë të vazhdueshme.

Familjaritetin me çështjet që trajtohen në intervistë e konsideroj një element shumë të rëndësishëm, që e kam mbajtur parasysh gjatë zhvillimi të tyre. Materiali i shfletuar përpara se të përballesha me të intervistuarit me ka ndihmuar të ndjek bashkëbiseduesit edhe pse në

disa raste ka pasur tendenca për ta devijuar temën e bisedës në degëzime shumë specifike, të cilat sado interesante të jenë, i shmangen temës kryesore të bashkëbisedimit.

Një vështirësi që kam hasur ka qenë ajo e kryerjes së një interviste në praninë e një personi të tretë dhe kjo nuk është një praktikë e panjohur, përkundrazi isha e paralajmëruar paraprakisht gjatë leximit përgatitor⁴. Megjithatë ky fakt nuk ka ndikuar në cilësinë e intervistës, por gjithsesi ajo i kaloi kufijtë e një interviste individuale. Jam përpjekur gjatë gjithë kohës të jem e përpiktë dhe të gjendem në vendin e intervistës më herët, por jo rrallë kam pritur të intervistuarit që kanë mbërritur me vonësë.

Një element tjetër të rëndësishëm kam konsideruar edhe zgjedhjen e pyetjes së parë si një ogur i mirë për pjesën tjetër të kohës në prani të të intervistuarit. Më pas pyetjet e tjera vijnë rrjedhshëm edhe natyrshëm duke ruajtur kështu kontaktin me sy me bashkëbiseduesin dhe duke u përpjekur të mos krijoj ngërçe në bisedë. Durimi më ka karakterizuar gjatë gjithë procesit të kryerjes së intervistave duke i dhënë mundësi të intervistuarve të shprehen lirshëm dhe kam ndërhyrë vetëm në ndonjë rast ekstrem kur biseda po i largohej shumë temës.

Jam përpjekur të ndjek bashkëbiseduesin në përgjigjet e tij duke i bërë edhe pyetje shtesë nëse përgjigjet nuk kanë qenë shumë të qarta ose kanë pasur nevojë për tu sqaruar më tej. Një element tjetër që jam përpjekur të ruaj me fanatizëm është dhe përmbyllja e intervistës në mënyrë pozitive duke e pyetur bashkëbiseduesin nëse ka diçka për të shtuar.

Është shumë e rëndësishme për mua të marr çdo informacion që ka lidhje me temën në fjalë duke shfrytëzuar këtu pyetjet për të ngacmuar memorjen dhe imagjinatën e të intervistuarve.

⁴ Kreuger, *Moderating Focus Groups*, 118.

2.2.Instrumentët antropologjikë

Përdorimi i retorikës në komunikim është mjaft i dobishëm për vetë faktin se ndihmon në perfeksionimin e artit të argumentimit duke e plotësuar atë edhe me leximin mes rrjeshtave.

Ajo që nuk thuhet në mënyrë eksplicite , por që nënkuptohet dhe jo vetëm kjo. Ashtu siç do të shtjelloj më poshtë duke përdorur tezën e Kvalet, intervista nuk kryhet vetëm në një nivel, atë faktik, por tenton të zbërthejë edhe nëntekstin, gjë që arrihet përmes leximit të xhestikulacionit dhe mimikës.

Për t'ia arritur qëllimit në ndihmë më erdhi antropologjia dhe metodat e saj kërkimore përfshirë këtu edhe elementët kryesorë më anë të së cilëve bëhet i mundur kërkimi im duke u mbështetur në shtylla thelbësore të përgatitjes dhe analizës së elementëve me specifike siç kanë konkluduar edhe Pelto⁵„Elementët specifike me anë të së cilëve mund të kryhet një kërkim antropologjik janë edhe intervistat, por jo vetëm. Një elementët shumë i rëndësishëm në këtë fushë është edhe vëzhgimi i hollësishëm i sjelljes gjatë intervistave dhe përgatitja e tyre. Në këtë kuadër nuk mund të lihet pas dore fakti se të gjithë këta elementë janë jetësorë për të arritur në përfundime dhe për të nxjerrë konkluzione e përgjithësime prej analizës socio- kulturore.

Nisur nga analiza të tilla bëhet më i domosdoshëm vëzhgimi i hollësishëm jo vetëm i sjelljes siç theksonte Pelto, por edhe i kontekstit.

Ashtu siç nënvizon dhe Kvale⁶, qëllimi i kërkimit kualitativ përmes intervistave synon të mbulojë dy nivele, atë faktik dhe kontekstual edhe pse zakonisht është më e vështirë për të intervistuar në një nivel nënteksti.Po përse pikërisht intervistat? Sa na shërbejnë ato?

⁵ Pelto, Anthropological Research: The structure of inquiry, 251-254.

⁶ Kvale, Interviews: A Introduction to Qualitative research Interviewing, 32.

Intervistat në fakt janë veçanërisht të vlefshme për të kuptuar historinë që fshihet në eksperiencën e një të pyeturi⁷. Një avantazh që e kam përdorur edhe unë është informacioni që mund të përfitohet, informacion ky që ka lidhje të drejtëpërdrejtë por edhe të tërthortë me çështjen. Natyrisht që puna nuk do të ishte e plotë nëse nuk do ta përballja grupin e intervistave me një grup fjalimesh me autorë të njëjtë. Pasi kam lexuar me vëmendje një material shumë voluminoz që përfshin transkriptet e seancave parlamentare të legjislativave të Kuvendit të Shqipërisë prej viteve 1991 e deri më sot, kam mundur të përzgjedh 2-3 intervista për secilin politikan të intervistuar.

Duke qenë se dua të analizoj evolucionin e retorikës dhe si ka ndikuar ky ndryshim i retorikës në procesin e komunikimit dhe si pasojë edhe në karrierën politike të të intervistuarve, kam preferuar të zgjedh fjalime që datojnë fillimet e karrierës parlamentare për secilin dhe natyrisht edhe fjalime të mbajtura në legjislaturën e fundit.

Vihet re një lloj panorame e ndryshme pasi fillimet e karrierës politike datojnë në kohë të ndryshme për subjektet e përzgjedhura dhe natyrisht edhe kurbat e karrierës së tyre kanë kahje të ndryshme. Ajo çka dua të analizoj është si zhvillohet karriera në lidhje me pjesëmarrjen në politikë apo moshën dhe mbi të gjitha rolin e retorikës në komunikimin me publikun dhe si zhvillohet kjo retorikë në kohë. Do të kthehem kësaj analize në kapitullin përkatës që i dedikohet analizës së tekstit të intervistave dhe fjalimeve në Parlament të mbajtura në legjislaturë të ndryshme.

2.2.1. Lista e pyetjeve dhe mënyra e formulimit të tyre

Lloji i intervistës së përdorur është intervistë e standartizuar me pyetje të hapura, pyetje këto që janë bërë të gjithë të intervistuarve duke stimuluar intervista të shpejta që mund të analizohen dhe krahasohen më kollaj.

⁷ McNamara, General guidelines for conducting interviews, 10.

Parimet kryesore që më kanë ndjekur gjatë përgatitjes së pyetjeve kanë qenë të lidhura fort me përpjekjen për të shmangur kompleksitetin duke përdorur një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, gjuhë që i qëndron larg ambiguitetit dhe tenton të jetë sa më e specifike që mundet duke shmangur pyetje që shkaktojnë bezdi tek bashkëbiseduesi dhe sidomos ato me kuptime dyfishe.

Lista e pyetjeve në fakt ka gjeneruar nga objekti i këtij kërkimi dhe veçanërisht nga teza kryesore e vendosur në qendër të këtij punimi.

Në rastin në fjalë kjo tezë i referohet rolit të retorikës në komunikimin e klasës politike shqiptare dhe për të proceduar më tej me daljen në konkluzione duhen përdorur patjetër dhe shtyllat mbajtëse të tezës kryesore që janë teza më të vogla që duke u analizuar sëbashku dhe në tërësi do të ndihmojnë në mbështetjen dhe zbërthimin e tezës kryesore.

Për t'ia arritur këtij qëllimi na vjen në ndihmë dhe përthyerja e këtyre tezave më të vogla në pyetje që do të drejtohen të intervistuarve sipas praktikës që sugjeron përdorimin e të trija formave të tekstit që prodhohen si rezultat i strategjive të ndryshme të pyetjeve.

Këtu vlen të përmendet larmia e klasifikimeve siç është ai syresh, tek i cili fokusohet në nxitjen e narrativës duke vendosur në qendër të tekstit refleksionet e të intervistuarit bazuar në praktikat dhe eksperiencën e tij individuale⁸. Kjo është një praktikë, që i shkon përshtat shumë subjekteve që kanë një bagazh politik dhe e shfrytëzojnë atë në funksion të ndërtimit të procesit të komunikimit me publikun.

Qasja e dytë metodologjike përfshin pyetjet strukturore që nxjerrin në pah ngjashmëritë dhe ndryshimet dhe e treta është e prirur ti ofrojë më shumë hapsirë qasjes argumentuese⁹

⁸ Hollstein, Strauss, Qualitative Netzwerkanalyse. Konzepte, Methoden, Anwendungen, 340.

⁹ Kuhn, The skills of the argument, 68-71.

Në këtë këndvështrim Wengraf¹⁰ arrin në përfundimin se përdorimi i një strategjie të vetme nuk siguron suksesin e formulimit të intervistës, prandaj kombinimi i këtyre strategjive është mëse i rekomandueshëm.

Mbështetur në këtë qasje teorike vendosa ti kombinoj këto tri strategji si më poshtë duke qenë se analiza e tekstit që do të kryhet në kapitujt në vazhdim kërkontë larmi tekstesh, pra jo një format teksti monoton që do të mbështetej në njërin apo tjetrin model.

Prania e teksteve argumentative që janë produkt i pyetjeve të tilla si *‘çfare roli luan parlamenti në jëtë e vendit tuaj dhe në gjykimin tuaj çfarë roli duhet te luajë? Sa i rëndësishëm është për ju referimi ndaj ideologjive në politikë? Si e konsideroni profesionin tuaj si politikan?’*sidhe e atyre narrativë që përftohen nga pyetje si *‘A keni ju një model në politikë? Si e përfitroni Shqipërinë pas 30 viteve dhe si mund të arrihet aty? Cilat forma përdorni për të komunikuar me publikun?’* është po aq e rëndësishme sa edhe prania e një teksti bazuar në përshkrimi e ngjashmërive dhe ndryshimve siç është edhe rasti i pyetjeve: *‘çfar ë roli luan multimedia në komunikimin tuaj me publikun? (Blogsferat, Facebook, Twitter) ; çfarë gjuhe përdorni ju, gjuhë letrare apo dialekt dhe përse? A i përgatisni ju fjalimet paraprakisht apo improvizoni?’*

Kjo larmi pyetjesh dhe rrjedhimisht edhe tekstesh që përftohen prej tyre do ta bënte më përfaqësuese analizën e teksit dhe si rrjedhoje do të ndihmonte në mbështetjen e tezës kryesore dhe argumentimin më të plotë të saj. Identifikimi i tezës kryesore edhe i tezave mbështetëse sidhe përthyerja e këtyre të fundit në pyetje për intervistat përbën një pjesë shumë të rëndësishme të procesit.

Por përfundimi i procesit të formulimit të pyetjeve shënon fillimin e një faze tjetër po aq të rëndësishme siç është ajo e krijimit dhe diferencimit të grupit të të intervistuarve, fazë kjo që do të përshkruhet në një pjesë tjetër të këtij kapitulli. Duke iu kthyer sërish analizës së

¹⁰ Wengraf, Qualitative Research Interviewing: Biographic Narratives and Semi-structured Methods, 181.

formulimit të pyetjeve dua të shtoj se po aq me peshë është edhe vlerësimi dhe gjykimi i drejtë dhe sa më pak subjektiv që të jetë i mundur i teksteve që kanë prodhuar këto intervista. Lidhja direkte dhe e qartë e tezës kryesore me tezat mbështetëse dhe me pyetjet e intervistave është një tregues i mirëfilltë se intervistuesi e ka fare të qartë se përse po bën secilën nga pyetjet dhe kjo siguron intervistuesin se analiza qualitative që po kryen ndjek një fill logjik që do ti mundësojë zbërthimin dhe argumentimin e tezës kryesore

Ajo çka është më rendësi për këtë kapitull është identifikimi i aparatit metodologjik që bazohet sic e përmendëm edhe më sipër në zgjedhjen e një rasti studimor siç është shoqëria post komuniste shqiptare dhe hulumtimi i rolit të retorikës në ndërtimin e procesit të komunikimit mes politikës dhe publikut. Në ndihmë të këtij hulumtimi vijmë instrumentë antropologjikë sic janë intervistat, të cilat së bashku me fjalimet do të përbëjnë thelbin e analizës së tekstit që do të kryhet në kapitullin e katërt.

Ky proces kërkon një punë parapërgatitore që filtron grupin e të intervistuarve si dhe përshkruan problematikën e hasur gjatë këtij procesi, pa lënë mënjanë modalitetet e kryerjes së këtyre intervistave.

Kapitulli III

Situata e komunikimit në Shqipëri. Vështrim i përgjithshëm

Rënia e Perdes së Hekurt astu si në mbarë Evropën Qëndrore dhe Lindore solli ndryshime thelbësore edhe në shoqërinë shqiptare. Edhe pse më vonë se në vendet e tjera të Lindjes, rënia e komunizmit solli një metamorfozë të gjithanshme në politikë e ekonomi, por jo vetëm. Tronditja në shoqërinë shqiptare nuk mund të linte pa prekur edhe themelet e sistemeve të vlerave, tek të cilët qenë bazuar një larmi marrëdhëniesh sociale e njërëzore që e panë veten të zbuluar në një sistem të ri, fare të panjohur. Watzlawick tërheq vëmendjen për domosdoshmërinë e ekzistencës së një kornize elementesh që merren në shqyrtim në studimit

e ndryshimeve të këtij lloji¹¹. Në këtë kapitull do të vëzhgohen elementë të vecantë duke mos pasur mundësinë për t'i hulumtuar të tërë, por duke i krijuar vetes luksin e përzgjedhjes së tyre. Ajo çka është interesante për punimin tim është analizimi i realitet të ri në fushën e komunikimit në dinamikën e re në të cilën u futën institucionet shtetërore shqiptare. Por çfarë trajtash merr procesi i komunikimit dhe si ndryshon ai në reletet e reja, me të cilat përballet politika shqiptare pas viteve '90? Si janë zhvilluar elementët e tij si p.sh. gjuha në raport me zhvillimet e vrullshme që jo gjithmonë kanë qenë konstruktive?

Një pjesë të rëndësishme në këtë panoramë zë edhe hulumtimi i marrëdhënies komplekse të medias dhe politikës si një paradigmë shumë e rëndësishme e procesit të komunikimit në tërësi, pa lënë mënjanë edhe shpjegimet e llojeve të komunikimit. Do të ndalem edhe në një moment të rëndësishëm në komunikimin siç është ai ndërfetar si element tipik shqiptar për t'u thelluar më pas në përthyerjen e politikës në ligjerim duke i paraprirë në këtë mënyrë analizës së tekstit që do të kryhet në kapitullin në vijim.

3.1.Roli i medias si pjesë sendërtuese e procesit të komunikimit në shoqërinë shqiptare pas viteve '90.

Jo rastësisht analizojmë rolin e medias në procesin e komunikimit, por këtë e bëjmë duke u nisur nga influenca dhe ndikimi i saj në përmasa reale në këtë proces. Ashtu siç sugjerohet, forcat politike janë në gjendje të komunikojnë direkt me elektoratin nëpërmjet organizimit të kapilarizuar në terren dhe shtypit¹². Analiza e kryer na vjen në ndihmë për të kuptuar më mirë të tërë procesin dhe sidomos lidhjet dhe marrëdhëniet e tij me klasën politike. Bëhet fjalë për një proces komunikimi të vendosur në një kuadër të ri si reflektim i marrëdhënieve të reja politiko -shoqërore të instalura mes medias dhe politikës. Ky kapitull synon të ofrojë një

¹¹ Watzlawick: La realite' de la realite': confision, disinformation, communication, 198.

¹² Grandi, Vaccari: Elementi della comunicazione politica, 65.

analizë të impaktit mediatik në mënyrën sesi politikanët kornizojnë pozicionet e tyre në marrëdhënie me publikun pas ndryshimeve politike të viteve '90.

*Studimi i medias së një epoke është një metodë, një portë hyrëse drejt kuptimit të gjithë shoqërisë*¹³. Ky është një argument më shumë në mbështetje të tezës së paraqitur më sipër për rolin dhe rëndësinë e medias në procesin e sendërtimit të procesit të komunikimit, proces ky që ka llojet e veta dhe nuk paraqitet kurrë linear dhe kurrësesi nuk mund t'i bëjë bisht e të mos ndikohet nga situata e përgjithshme politike, ekonomike dhe sociale që ka përjetuar Shqipëria që prej përmbyesjes së regjimit totalitar dhe hyrjes në një proces transformimi shumeplanësh. Transformim ky që synonte ndërtimin e institucioneve demokratike, aplikimin e ekonomisë së tregut dhe respektimin e shtetit ligjor ndërthurur me një mori ndryshimesh sociale të lidhura me transformimin e marrëdhënieve familjare edhe në raportin me moralin dhe fenë, elementë këta që nuk kanë kalaur pa lënë gjurmët e tyre.

Bashkë me pluralizmin politik, Shqipëria e viteve 1991 do të përjetonte një ringjallje të mediave që aso kohe identifikohesh me shtypin e shkruar.

Në mënyrë eksplicite i referohem lindjes së gazetës së parë opozitare „Rilindja Demokratike“ që debutoi në 5 janar 1991 duke thyer akullin e pothuajse gjysëm shekulli çensurë të frikshme dhe të paderpërtueshme në informimin e qytetarëve. Duke qenë se kam pasur fatin të përjetoj ditë pas ditë atë zhveshje graduale nga autoçensura, e vlerësoj si një nga momentet më të rëndësishme në historinë e brishtë të komunikimit në Shqipëri.

Profan dhe i paditur, pre e spontanitetit shpeshherë pa asnjë busull orientimi nisi të ridimensionohej procesi i komunikimit në një shoqëri të asfiksuar nga çensura e të zvjerdhur nga autoçensura, të brejtur nga varfëria ekonomike dhe të zhytur në errësirë nga ndjesitë e frikës dhe ndëshkimit për çdo fjalë të pakontrolluar dhe të artikuluar pa kujdes.

¹³ Fuga „Media, politika, shoqëria, 10.

Edhe pse fëmijë, kam përjetuar trysninë e gjyshërve dhe prindërve që dëgjonin fshehurazi radiot „Zëri i Amerikës“ apo „BBC“ dhe druanin një rrjedhje të mundshme të informacionit nga më të vegjlit që aso kohe nuk mund të realizonin kataklizmën që do të shkaktonte ky informacion i rënë në një vesh të kujdesshëm e vigjilent.

Thënë kjo, mendoj se numri i parë i një gazetë që artikulonte zërin opozitar dhe që merrte guximin për të materializuar në të zezën mbi të bardhë gjithë mllëfin dhe frustracionin e një populli të tjetërsuar moralisht dhe psikologjikisht nga çensura dhe diktatura, përbën elementin kyç të kthesës më drastike në historinë e komunikimit në shoqërinë shqiptare të post diktaturës.

Por kjo gazetë nuk mbeti e vetmja, për fat të mirë me ndryshimin e sistemit politik nga monopartiak në pluripartiak natyrshëm erdhi pluralizmi mediatik duke i ofruar shoqërisë së ndrydhur shqiptare në një terr informative një mbingopje me informacion. Është ky proces që do të analizohet më poshtë, duke u fokusuar në tiparet e komunikimit dhe llojet e tij pa lënë mbas dore edhe elementët më të rëndësishëm të tij, gjithmonë duke respektuar fokusin e këtij punimi.

3.1.1. Tiparet e komunikimit

Një analizë e këtij procesi kërkon së pari një prerje tërthore dhe vëzhgim të hollësishëm të tipareve më të rëndësishme të tij. Artan Fuga i referohet medias si mjeti më i mirë i propagandës së partive politike për të komunikuar në atë që ai e quan politikë të elektoratit, pra lexuasit të gazetave ¹⁴ duke i atribuar gazetave rolin e mbrujtësve të votuesve të ardhshëm. Nisur nga hapat e parë të mbrujtjes së procesit të komunikimit vlen të përmendet një prej tipareve të tij më të rëndësishëm në fillim të viteve '90: lidhja mes ekzistencës së një organi të masmedias (në atë kohë bëhej fjalë vetëm për shtypin e shkruar) dhe mbijetesës së

¹⁴ Fuga, Ikja nga kompleksi i Rozafës, 25.

partive politike. Pra përcjellja e ideve politike tek elektorati bëhej vetëm dhe ekskluzivisht nëpërmjet organit të shtypit duke marrë parasysh edhe kushtet e mjerushme infrastrukturore të Shqipërisë së viteve '90. Në fakt sa më e thjeshtë dhe eksplicite të qe gjuha, aq më e përceptueshme dhe e kuptueshme bëhet ideja për qytetarin duke konsideruar këtu faktin që partitë e sapokrijuara kishin nevojë të shtriheshin në hapësirë dhe të mbulonin edhe territorin më të thellë rural, një ambient potencial për t'u përkthyer në vota dhe elektorat në zgjedhjet politike.

Një tipar tjetër i rëndësishëm i procesit të komunikimit që sapo kishte filluar të bulëzonte edhe pse në formë shumë të thjeshtë dhe primitive ishte edhe shtrirja e përhapjes së mesazhit politik në kohë dhe hapësirë nëpërmjet gazetave më të rëndësishme në vend. Fuga e argumenton këtë tezë duke marrë për shembull zgjedhjet e para të lira të zhvilluara në Shqipëri në 31 mars 1991 dhe rezultatin që doli prej tyre. Sipas analizës së tij, komunistët fituar sepse ata kishin në dispozicion gjithë shtypin qendror plus edhe rreth 20 gazeta lokale të komiteteve të partisë në rrethe ¹⁵, situatë kjo që u përmbys në zgjedhjet e 22 marsit 1992. I atribuohet pikërisht shtimit të numrit të gazetave opozitare, shpërndarjes së tyre në të gjithë territorin e vendit dhe tkurrjes së fuqisë propaganduese të Partisë së Punës së shndërruar në Parti Socialiste përmbysja e rezultatit dhe fitorja plebishitare e forcave opozitare duke shënuar kështu qeverinë e parë jo komuniste që prej vitit 1944 në Shqipëri.

Vlen për tu përmendur në këtë rast edhe shëmbulli i zgjedhjeve parlamentare të 3 korrikut 2005 kur shumica e opinionit publik përfshirë këtu edhe mendiat kryesore të shkruara dhe elektronike parashikonin një fitore të Partisë Demokratike prej 8 vitesh në opozite dhe fitore që: konvergimi i opinionit mbizotërues në masmedia në këtë rast me atë të elektoratit për një ndryshim në qeverisje nuk mund të konsiderohet rastësi. Ndikimi është i ndërsjelltë: media

¹⁵ Fuga: Media, politika, shoqëria, 22-27.

ndikon politikën dhe ndikohet prej saj duke formësuar një proces komunikimi kompleks dhe shumëplanësh.

3.1.2.Funksionet e medias në procesin e komunikimit

Por çfarë funksionesh luan media në procesin e komunikimit në shoqërinë shqiptare dhe si realizohen ato?

Sipas Fugës¹⁶, roli parësor dhe më thelbësori në shoqërinë post komuniste ishte ai i shprehjes së lirë dhe pa autoçensurë dhe i dëgjimit të lajmeve nga më të larmishmet duke ngopur kështu një mungesë të kahershme duke i dhënë individit një dimension

të ri, larg kolektivizmit të forcuar dhe duke ndjellë dëshirën për të përmbushur atë boshllëk me çdo lloj informacioni, të nevojshëm e të panevojshëm. Në këtë prizëm duhet përmendur edhe nevoja e komentimit vend e pavend, mbase vetëm për t'u dëgjuar e për të shijuar secili zërin e vet, larg autoçensurës dhe ankthit se mos një fjalë e thënë pa menduar mund të kushtonte lirinë.

Një funksion tjetër i rëndësishëm i medias së lirë që prej fillimeve të saj vlerësohet edhe ai i stabilizuesit¹⁷ të një raportit mes publikut dhe politikës në kuptimin e saj më të gjerë.

Në një vend të sapodalë nga një tunel i gjatë dhe i mundimshëm monopartiak, shtypi luan rolin e ndërmjetësit për të trasmetuar dhe qartësuar idetë e reja politike që perthitheshin nga shoqëria e etur shqiptare, e etur për ide të reja, për pluritet mendimi larg klisheve bajate komuniste. Së treti ia vlen të përmendet edhe roli i medias si një dritare me botën e përtejkuqijve. E ngjuar në izolimin e saj absolut, shoqëria shqiptare e viteve '90 shfaqte simptomat e një pacienti klaustrofobik që nuk e nxë më hapësira që ka përreth dhe shfaq dëshirën për t'iu larguar mureve të qelqta të izolimit duke iu dorëzuar nevojës për të zbuluar botën, një mënyrë për të përmbushur në kohë dhe hapësirë atë çka kishin humbur në një

¹⁶ Po aty

¹⁷ Po aty

gjysëm shekulli, një gjysëm shekulli jo pak i rëndësishëm për sa i përket zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë. Por ana tjetër e medaljes e përballi dëshirën për të zbuluar horizonte të reja me rregullat burokratike që kishte vendosur pjesa tjetër e Evropës për t'i bërë ballë valës së prurjeve nga vendet ish-komuniste.

Për të gjithë ata që Përrëndimin nuk mund ta preknin realisht, televizioni ¹⁸por jo vetëm u bë dritarja që na lidhte me pjesën tjetër të botës. Një ndërlidhës që hapte horizonte të një mënyre jetese, botëkuptimi dhe padyshim të një kulture për ne të mohuar edhe pse shumë të dëshiruara. Imitimi i emisioneve të kanalave të huaja bëri që edhe gazetaria televizive shqiptare të hidhte hapa te ndrojtur në udhën e pafundme të zhvillimit teknologjik deri sa e gjejme veten sot ndër të paktat vende në Evropë ka aplikuar teknologjine dixhitale¹⁹ dhe që ka shpallur si sllogan qeverisës „Shqipëria në moshën e internetit²⁰“. Sa i realizueshme është ky qëllim , mbetet akoma për tu diskutuar dhe retorika e përdorur do të analizohet në kapitullin e IV. Padyshim që masmedia ka mëkatet e saj, por gjithësesi duhet pranuar procesi i evoluimit që ka sjellë si pasojë edhe ridimensionimin e rolit të saj në funksion të procesit të komunikimit. Ky është një shembull empirik i teorisë së Marshall McLuhan ²¹, i cili e konsideron median si formëdhënësin primar të civilizimit. Është shumë i rëndësishëm mesazhi i tij që nënvizon mënyrën dhe format sesi media ndikon në psikikën tonë për të stimuluar një bashkëveprim të ndërsjelltë të saj me ambientin që na rrethon. Teoria e tij shkon më tej duke vlerësuar se mënyrat që media ndikon tek ne në formësimin e opinionit publik duke i dhënë këtij procesi më shumë peshë se vetë përmbajtja e mesazhit që trasmeton media. Do t'i referohem po kësaj teorie më poshtë kur të analizoj llojet e ndryshme të komunikimit.

¹⁸Po aty

¹⁹ <http://www.top-channel.tv/rrethnesh.php>

²⁰http://www.facebook.com/note.php?note_id=62271892053

²¹ McLuhan, Fiore, The Medium is the Message, 8-15.

3.2.1 Llojet e komunikimit

Duke u përpjekur të hulumtoj sendërtimin e procesit në përgjithësi nuk mund të anashkaloj edhe tipet kryesore të komunikimit që vihen re në shoqërinë shqiptare, por jo vetëm. Në fakt procesi i klasifikimit dhe analizimit të llojeve të komunikimit është standart dhe në ndihmë më vijnë ekspertë dhe teoricienë tradicionalë të fushës si McLuhan, i cili analizon rolin dhe funksionin e alfabetit si mënyrë komunikimi. Ai ngul këmbë në rëndësinë e procesit të transformimit të civilizimit European nga një civilizim që bazohej në të dëgjuar në një syresh që në bazë të tij kishte leximin dhe ky transformim ishte thelbësor për procesin e komunikimit që tashmë përveç shqisë së të degjuarit përcillej tek ajo e të lexuarit. Siç u përmend më sipër, ai në kundërshtim me teorinë Marxiste, i mvesh medias meritën e stërmadhe të transformimit të njerëzimit duke ia hequr këto grada ekonomisë, politikës apo shkencës që i kishin mbajtur deri në atë moment. Por komunikimi me anë të alfabetit (këtu nuk nënkuptohet vetëm media e shkruar, por edhe libri dhe dimensionin kulturor dhe profesional që përfshin) nuk mbeti si një fidan i vetëm në hapësirën e pafund të komunikimit.

Zhvillimi i zinxhirit komunikativ që sugjeron McLuhan nga dëgjimi në lexim shkon më tej duke përfshirë këtu edhe figurën edhe zërin të mediumit audioviziv siç sugjeron Fuga²² si një mënyrë për të kuptuar edhe ndryshimin e brezave në marrëdhëniet socio-kulturore dhe padyshim si pjesë thelbësore e procesit të komunikimit. Ajo që vlen të përmendet është pikërisht implementimi i këtij evoluimi të procesit zinxhir në shoqërinë shqiptare të pas viteve '90. Me etjen e një shoqërie të mbetur thajse në errësirë, çelja e gazetave të para u prit si uji në shkretëtirë për t'i dhënë lexuesit të pamësuar më shumëllojshmërinë e lajmit dhe burimeve mundësinë e zgjedhjes dhe seleksionimit të tij. Gjithnjë në valën e komunikimit

²² Fuga: Brirët e Dhisë, 229.

alfabetik lulëzuan edhe botimet e ribotimet jo vetëm të veprave të reja e bashkëkohore, por edhe të atyre që më parë ishin përballur me çensurën e regjimit. Gjithsesi kjo formë tradicionale e komunikimit nuk hasi në qëndresë se në thelb të saj nuk përbënte ndonjë risi në formë, por lulëzimi i medias audiovizive dhe boom-i sai i saj i pas viteve 2000 pati vështirësi. Shqipëria e fillimit të viteve '90 ndryshon ndjeshëm nga ajo e vitit 2009 sa i përket larmisë së informacionit. Komunikimi alfabetik nuk është mënjeluar, por nuk mban më monopolin siç ndodhte dikur. Zhvillimi i vrullshëm teknologjik i medias audiovizive me lindjen dhe rritjen e shumë kanaleve televizive, radiove dhe oferta e pasur që ato sjellin në treg e ka bërë qarkullimin e informacionit shumë të shpejtë për të mos folur për elementë të tillë siç janë interneti dhe rrjetet sociale që mundësojnë shprendarjen e tij në kohë reale. Por gjithsesi nuk mendoj se ka vend për eufori. Shqipëria është vendi i paradokseve dhe disniveleve të mëdha, mungon njëtrajtshmëria në zhvillim dhe paradigma e mësipërme nuk shtrihet në të gjithë territorin.

Nëse pasja e internetit 24 orë në Tiranë nuk përbën më lajm, në një fshat të Tropojës nxënësit nuk dinë akoma se ç'është ai dhe kjo përbën sfidën e parë dhe më akute të nismës “Shqipëria në moshën e Internetit”: Tirana nuk është Shqipëria dhe Shqipëria nuk është Tirana. Kryeminsitri i vendit Sali Berisha deklaroi në 19/10/2008 në Bajzë të Malesisë së Madhe:

“Brenda muajit mars të vitit që vjen do të përfundojë instalimi i kabineteve të informatikës në të gjitha shkollat e vendit dhe më pas, bapë tjetër do të jetë shtrirja e përdorimit të internetit në çdo familje dhe kudo në komunitet”²³. Të njëjtën retorikë përdori ai edhe në një takim elektorale në Jug të vendit, në Kucovë më 06/06/2009 kur thotë se: “Për ne, Shqipëria evropiane, Kucova evropiane do të thotë që

²³ <http://www.keshilliministrave.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=9529>

fëmijët tuaj të mësojnë në shkollë të standardeve europiane. Sot interneti është në çdo shkollë. Ne do ta shtrijmë moshën dixhitale në të gjithë vendin²⁴”

Bazuar në retorikën e përdorur mund të analizojmë në hollësi cilësinë e komunikimit jo alfabetik. Shkolla tradicionale ruan me fanatizëm rëndësinë e komunikimit alfabetik të bazuar në peshën e shkronjës dhe në kapitullin në vijim grupi i politikanëve të intervistuar do të ballafaqohet edhe me këtë temë dhe ndërsa në retorikën e tyre vendin më të madh e zë dixhitalizimi i popullsisë, në realitet ata veprojnë ndryshe.

Në fakt bën përshtypje preferenca e tyre për të vendosur një komunikim të drejtëpërdrejtë me elektoratin apo maksimumi me anë të sms-ve duke mos i zënë fort besë mjeteve moderne të komunikimit masiv si interneti dhe rrjetet sociale të tipit Facebook apo Youtube që në kohë dhe hapësirë thyejnë çdo rekord por ajo ç’ka duhet mbajtur parasysh është dhe fizibiliteti i një komunikimi të tillë.

“Duke qenë se kostot e komunikimit tradicional vijnë gjithnjë e në ngritje, rrjetet me bazë Internetin i kanë ulur kostot e komunikimit aktivist²⁵”.

Por Shqipëria ka një infrastrukturë teknologjike që nuk i kalon kufijtë e kryeqytetit apo qyteteve më të mëdha pa u rrekur të shpërndahej në çdo cep të vendit dhe ky element nuk është për tu injoruar: Politikanët preferojnë të mos rrezikojnë dhe për këtë arsye i qëndrojnë besnik mënyrave klasike për të mbërritur pranë elektoratit.

Një shembull për këtë tezë është edhe rasti i sipërpërmendur i ndërtimit të shkollave apo restaurimi tyre dhe pajisja me një klasë me kabinetin e informatikës, por sa i vlfeshëm është ai në mungesë të energjisë elektrike të vazhdueshme, element shumë bazik që zhvelftëson gjithë investimin në fjalë. Pra në kushte të tilla si mund t’i besohet vetëm komunikimit të

²⁴ <http://www.keshilliministrave.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11164>

²⁵ Pels, Corner, Media and the Restyling of politics, 147.

avancuar teknologjikisht? Skepticizmi ndaj tij nuk është i pavend edhe pse modelet që klasa politike shqiptare përdor janë të lidhura pazgjidhshmërisht me avancimin teknologjik.

Një formë tjetër e komunikimit që trajton Fuga është edhe komunikimi me shifra²⁶ dhe këtui nuk bëhet fjalë për asnjë alfabet morsi të përdorur çuditshëm. Ky komunikim bën të mundur vendosjen e një ure mes qytetarit dhe shtetit, institucioneve dhe legjitimitetit të tyre.

Jo rastësisht në çdo fushatë elektorale komunikimi shifror bëhet më i pranishëm për t'u përdorur si retorikë në njërin apo tjetrin kah të saj me qëllime të pastra përfitimi politik.

Por sa i besueshëm është ai? A është pre e mosbesueshmërisë së përgjithshme që zotëron në Shqipëri sa i përket këtij procesi? Në plan të parë mund të mendohet që jo sepse shifrat lenë pak hapësirë për spekulim dhe të gjithë faktorët janë shumë të interesuar për të qenë të qartë mbi elemente siç janë buxheti, investimet, niveli i papunësisë dhe shifrat duket sikur nuk lenë vend për interpretime, por në fakt edhe ky komunikim ka pikat e veta të dobta në shoqërinë shqiptare duke marrë parasysh si ai bie pre i retorikës.

Ajo çka e bën komunikimin shifror të mos ndryshojë në besueshmëri nga tipet e tjera është metodologjia e përdorur për të arritur në shifrat aq të dashura dhe tek të cilat në përpiqemi të mbahemi aq fort.

Por në fakt ky besim bilbik tek shifrat fashitet sapo në analizojmë se kush i ka nxjerrë ato, si i ka përpunuar, sa të besueshme kanë qenë të dhënat e mbledhura dhe sa përfaqësuese janë ato. Në këtë prizëm problemi pushon së qeni përlllogaritës dhe thjesht statistikor dhe nis kalvari i dyshimit me sfond politik. Sa i pranishëm është ky problem në procesin e gjerë të komunikimit në Shqipëri do ta tregojnë shembujt e mëposhtën, që fatkeqësisht nuk janë të vetmit. Në hapjen e fushatës elektorale Edi Rama, kryetar i Partise Socialiste në datë 01/06/2009 thotë se:

²⁶ Fuga: Brirët e Dhisë, 219.

S'mund të ketë në Shqipërinë si gjithë Europa 1/5-ën e territorit të vendit pa këmbë mjeku e infermieri dhe pa asnjë lloj pike shërbimi shëndetësor, ndërkohë që në pjesën më të madhe të hapësirës rurale ky shërbim ekziston vetëm në listëpagesa mjekësh që duken vetëm për të marrë rrogën. Janë mbi 40% qytetarët shqiptarë që nuk janë të mbuluar nga sigurimet për shkak të varfërisë dhe që në rast nevojë u dubet ose të paguajnë nën dorë ose të vdesin kur s'kanë të paguajnë.

Dhe janë mjekët e infermierët, që padrejtësisht, janë vënë në shënjestër si fajtorët për një gjendje alarmante që prej 18 vjetësh nuk alarmon politikën, po vetëm të sëmurët e familjarët e tyre²⁷.

Po e njëjta situatë ndodh edhe në kahun tjetër të politikës kur Kryeministri Berisha në 27.05.2009 në një fjalim elektorale deklaroi se:

Ne kemi asfaltuar tërësisht rrugët e komunës Xhafzotaj, po asfaltojmë tërësisht rrugët e Katundit të Ri, kemi ndërtuar një sërë shkollash, kemi shtrirë internetin në të gjitha shkollat e fëmijëve tuaj, kemi rritur pensionet e të gjithë fermerëve të fshatit 100 për qind, kemi rritur pensionet në qytet nga 50 deri në 70 për qind, kemi dyfishuar pagat e mësuesve, mjekëve dhe infermierëve²⁸

Por sa të besueshme janë këto shifra? Ku bazohen ato? Çfarë metodologjie është përdorur për të arritur në të tilla përfundime? A është ky vetëm një përdorim i retorikës për interesa të pastra elektorale?

Të njëjtën pamundësi për t'i verifikuar faktet e sipërpërmendura shfaq edhe polemika në distancë sa i përket relacionit për buxhetin 2008-2009²⁹:

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2009 treguesit afatshkurtër statistikor të cilët paraqesin performancën e sektorit real tregojnë për ecuri pozitive të ritmeve të rritjes. Vlen të theksohet se të gjithë treguesit afatshkurtër (PBB tremujore, etj) tregojnë për një rritje pozitive të ekonomisë në intervalin 4-6 përqind, gjë e cila e rendit ekonominë tonë, si një nga ekonomitë më pak të prekurat nga griza ekonomike globale. . Informacioni që

²⁷ http://ps.al/index.php?option=com_content&task=view&id=2314&Itemid=74

²⁸ <http://www.keshilliministrave.al/index.php?fq=brenda&m=news&lid=11084>

²⁹ Situata makroekonomike dhe buxhetore për periudhën 2008-2009
<http://www.minfin.gov.al/>

japin treguesit statistikorë afatshkurtër për tremujorin e parë mbështetet gjithashtu edhe nga disa indikatorë “indirekt” të performancës së disa prej taksave kryesore, si psh TVSH-ja Gjithashtu një rritje prej 19 përqind u regjistrua në të ardhurat nga Akciza të mbledhura nga prodhimi vendas i mallrave me akcizë.

Ky paragraf i shkëputur është cituar në kontekst me paragrafin e mëposhtëm për të dhënë idenë e kontrastit dhe kundërshtisë së shifrave.

Në një deklaratë për shtyp Sekretari për Programin në Partinë Socialiste shprehet se:

Në mënyrë të përsëritur, për disa muaj rresht administrata tatimore dhe doganore vijojnë të mos mbledhin të ardhurat e programuara. Defiçiti i krijuar nga mosmbledhja e të hyrave është 185 milionë dollarë. Defiçiti i krijuar nga mosmbledhja e të ardhurave në tatime e dogana është 155 milionë dollarë. Realizimi i planit të tatim fitimit vetëm me 84 % dëshmon qartë për vështirësitë që kalojnë sipërmarrjet shqiptare. Realizimi i planit të kontributeve të detyrueshme vetëm me 94 % dëshmon përsëri qartë se nuk kemi rritje të punësimit siç është premtuar nga qeveria. Në 8 muajt e parë të 2009 është mbledhur si tatim mbi vlerën e shtuar vetëm 4.3 % më shumë se e njëjta periudhë e vitit 2008. Në kushtet që 70 % e TVSH-së mbledhet në dogana dhe në kushtet e zhvlerësimit të monedhës vendave me të paktën 6 % krabasuar me një vit më parë, rezulton se ekonomia shqiptare nuk është rritur në 8 muajt e parë të vitit 2009. Kjo është e dhëna më e saktë, e dalë nga raportimet zyrtare të vetë ministrisë së financave që dëshmon se deklaratimet e Kryeministrit dhe Ministrit të Financave për rritje ekonomike janë të gënjeshtërt³⁰.

Shifrat kontradiktore që paraqiten si argumente të palëve të përfshira në debat nuk bëjnë gjë tjetër vecse çorientojnë totalisht receptuesin dhe në këtë mënyrë edhe komunikimi me shifra humbet besueshmërinë që i jep origjina e tij dhe për hir të metodave dhe përdorimit politik nuk bën gjë tjetër veçse kthehet në një retorikë boshe dhe aspak të vlefshme. Ajo çka lipset është bërja me dije e metodologjisë dhe transparencës së menyrës së daljes në shifra të tilla që tashmë nëse humbin besueshmërinë, nuk lënë më me gojë hapur asnjë me gjuhën e tyre preçize.

³⁰ Beqja: Situatën e vështire ekonomike të vendit nuk do ta përmirësoj as ndryshimi në buxhetin e 2009-tës
http://ps.al/index.php?option=com_content&task=view&id=2540&Itemid=161

3.2.2. Gjuha dhe komunikimi

Gjuha natyrisht luan një rol të rëndësishëm në procesin e komunikimit, por jo vetëm në të. Ajo ka një peshë jo të vogël në formësimin e identitetit duke u identifikuar me një element thelbësor në bërjen dhe përfaqësimin e tij.

Gjuha mund të shihet edhe si një ndërmjetës, një mjet që politika përdor për të kontrolluar dhe influencuar elektoratin duke shfrytëzuar fuqinë që ajo ka mbi mendimin. Gjuha e politikës në fakt mbështetet në elementë të rëndësishëm që do të dalin në pah më poshtë duke i ilustruar me shembuj. Gjuha nuk është vetëm arti i të shprehurit, përkundrazi ajo mund të shprehi më shumë duke mos u prononcuar në mënyrë eksplicite, por duke nënkuptuar si në frazën e mëposhtme të artikuluar nga Presidenti i Republikës, Bamir Topi:

Sistemi i drejtësisë merret me konfliktet e çfarëdolloj natyre dhe këtu është e qartë që konfliktet eventuale të mundura të subjekteve politike në funksion të rezultatit të zgjedhjeve mund të angazhojnë në mënyrë të qartë edhe Kolegjin Zgjedhor, i cili është i mandatar dhe padysim sot edhe një herë dëshiroj të shprehem në cilësinë e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë për pritshmërinë e lartë që ne kemi për këtë Kolegj: për të realizuar detyrën mjaft të rëndësishme, mjaft delikate, sepse sikurse dibet vota e sistemit të drejtësisë është pikërisht në ndërgjegjen e çdo gjyqtari.³¹

Në mënyrë implicite President i Republikës i jep zë shqetësimeve që kanë karakterizuar situatën post zgjedhore për një anësi të organeve kushtetuese sic është Kolegji Zgjedhor pa i përmendur ato në mënyrë eksplicite, por duke theksuar pritshmërinë e secilit prej nesh që ky organ të jetë në lartësinë e duhur duke iu kujtuar atyre dy elementët ndaj të cilëve janë të detyruar të binden: kushtetuta dhe ligji. Mes rrjeshtave lexoj se Presidenti shmanget cdo lloj elementi tjetër të natyrës partiake apo personale në gjendje të ndikojë vendimet e këtij organi.

³¹ Fjala e Presidentit Topi në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Drejtësisë
<http://www.president.al/shqip/info.asp?id=5102>

Një element tjetër që përdor gjuha në procesin e komunikimit është edhe persuazioni ose përdorimi i retorikës në funksion të argumentimit duke shfrytëzuar një sërë figurash letrare si metafora dhe eufemizmi , por jo vetëm. Elementët e sipërpërmendur mund të përforcohen nga përdorimi i dialektit, lëvizje taktike kjo që përdor politika për t'u shfaqur më pranë komunitetit duke shfrytëzuar ndikimin psikologjik tek aiienca.

“A jeni dakort ju që në krye të listës së LSI-së përfaqësimit në kuvendin e ri të Shqipërisë të jetë kampioni i Vllaznisë, kampioni i Shqipërisë, kampioni i qytetarisë dhe qytetarisë shkodrane Seit Fishta. Ka dhe shumë të tjerë por këto diskutojini dhe zgjidhni vetë. Unë jam i bindur se me këta dy Sokola të qytetarisë Shkodrane të traditave më të mira shkodrane,të faljeve më të mira shkodrane³²”.

Jo më kot një nga pyetjet e përzgjedhura për t'u drejtuar të intervistuarve ka të bëjë pikërisht me përdorimin ose jo të dialektit gjatë procesit të komunikimit dhe analizimi i saj në kapitullin në vijim do të plotësojë kornizën e rolit të gjuhës në ndërtimin e procesit të komunikimit. Ajo çka bie në sy në analizën e gjuhës, një nga elementët me të cilën materializohet procesi i komunikimit në Shqipëri, është prania e dhunës verbale si element jetësor të klasës politike.Kjo dhunë nuk ka hiç respekt as për familjen tradicionalisht të konsideruar një vlerë shumë të rëndësishme të shoqërisë shqipëtare, të paprekshme gati gati tabu duke përfshirë në fyerje gjininë femërore me qëllimin diabolik për të prekur sedrën mashkullore dhe për të provokuar tek tjetri një reagim të shpërfyturuar. Një rast i tillë fatkeq është shënuar pikërisht në tempullin e demokracisë, në një seancë parlamentare duke dokumentuar një pikë kulminante të provokimit dhe denigrimit të kundërshtarit politik me çdo mënyrë³³Përpos skuqjes dhe ndjenjës së turpit që ngjall kjo video tek cdo njeri me një ndjenjë mesatare qytetarie, ajo tregon më së miri sesi tri përfaqësues të organeve kushtetuese

³² Fjala e Ilir Metës mbajtur në Shkodër 03.03.2009
<http://www.24-ore.com/mobile/politika/2720.html>

³³ <http://www.youtube.com/watch?v=fD7LZcbI-D8>

Kryeministri, Kryetarja e Parlamentit dhe një deputet i grupit parlamentar socialist të Republikës së Shqipërisë shprehen me një gjuhë të padenjë duke qenë në detyrë. Skena bëri xhiron e menjëhershme në një shoqëri, e cila përdor edhe elementët më të shpejtë të komunikimit dhe jo më kot unë sugjerova si burim pikërisht shfaqjen që serviret në youtube. Mund të përjetohet edhe pasi kanë kaluar vite sikur të ndodhte në kohë reale. Megjithatë nuk dua të ndalem në rolin e medias dhe mënyrën sesi ajo prodhon politikë në këtë rast, por në fuqinë demonizuese dhe stigmatizuese të gjuhës.

Impakti tek publiku që tronditës. U dëgjuan zëra që i dënuar, por fasha e simpatizantëve të njërit apo tjetrit krah nuk u dyzua shumë, përkundrazi nuk vonoi të radhitej në krahun përkatës e të sulmonte kundërshtarin me të njëjtin mllef si provokator apo dashakeq.

Ky rast vërteton teorinë e Fugës që tërheq vëmendjen për një patologji nga e cila vuan edhe publiku shqiptar: mpirjen dhe anestezin³⁴ e tij duke u imunizuar në një ambient ku të gjithë flasin dhe asnjë nuk degjon. Në kuadrin e një ambienti kakofon, gati gati kalohet në desementizim të fjalëve të përdorura. Gjuha në këtë rast luan këtë funksion mpirës në kuadrin e një kakofonie kolektive, në të cilën zor se mund të ketë vend për një ndjekje logjike të ngjarjeve dhe gjykim të paanshëm.

Pra duhet të jemi të kujdesshëm në përkufizimin e gjuhës si element bashkues që është thelbësor në ndërtimin e një komuniteti. Po aq i mprehtë është edhe roli i saj ndarës si në shembujt e përmendur më sipër që analizohen gjithmonë brenda kontekstit të përdorur.

3.2.3. Feja dhe etnija si elementë të komunikimit në Shqipëri

³⁴ Fuga: Brirët e Dhisë, 435.

Lidhja mes fesë dhe politikës ka qenë dhe mbetet edhe sot e kësaj dite një objekt shumë joshës i studimeve në shkencat humane duke u konsideruar si një parim bazë metodologjik³⁵ për të kuptuar natyrën e fesë. Mendimi filozofik botëror nga Weberi, Habermas, Tocqueville³⁶ etj ka trajtuar rrënjësisht këtë marrëdhënie të vështirë dhe komplekse duke analizuar dallimet dhe të përbashtat e këtyre dy formave të veprimtarisë njërëzore.

Ajo çka na intereson në këtë kapitull është dinamika e dialogut ndër fetar dhe ndikimi i tij në sferën më të gjerë të komunikimit në shoqërinë post komuniste shqiptare, shoqëri që përjetoi një rigjallërim të besimit qysh prej vitit 1967 kur Shqipëria, e frymëzuar nga Revolucioni Kulturor kinez u vetshpall i vetmi vend atist në botë nga regjimi i aso kohe. Gjatë asaj kohe, feja u godit rëndë nga shteti duke mbyllur gjithë institucionet fetare dhe duke i detyruar të gjithë klerikët pa përjashtim për të ndërprerë veprimtaritë fetare³⁷.

Ringjallja fetare në fakt nuk ndodhi e dhunshme, përkundrazi ajo ruajti tiparet e një bashkëjetese fetare mes tri feve kryesore monoteiste dhe dhjetra sekteve fetare që lulëzuan duke u përpjekur të mbushnin atë boshllëk disa dhjetra vjeçar, në të cilin besimi tek Zoti u zëvendëua me besnikëri të plotë ndaj doktrinës staliniste. Në këtë pikëpamje komunikimi fetar dhe etnik nuk kanë pasur periudha të errta gjatë dy dekadave të fundit, përkundrazi krahasuar me shumëllojshmërinë e problematikës së këtyre fushave që haset në vendet fqinj, shoqëria shqiptare nuk ka pësuar tronditje dhe arsyt janë të shumta. Ndër to mund të përmendim edhe homogjezimin kulturor, etnik dhe gjuhësor të Shqipërisë³⁸.

Gjithsesi kjo lloj marrëdhënie e “lëmuar” nuk përjashton edhe raste sporadike që kanë synuar në acarimin e marrëdhënieve si etnike ashtu edhe fetare, raste këto që kanë mbetur të lokalizuara dhe nuk janë përqaftuar nga masa e popullsisë duke ruajtur karakterin e disa

³⁵ Fuga, Brirët e Dhisë, 470-474.

³⁶ Po aty

³⁷ Fuga, Shtigje drejt guvës së gjarprit, 81.

³⁸ Fuga, Shoqëria periferike Tiranë, 352-355.

provokimeve fatkeqe. Sa i përket komunikimit ndërfetar, ai është një element që stimulohet fort nga politika. Gjatë këtyre pothuajse 20 vitesh pluralizëm politik, asnjë formacion serioz nuk ka pasur ngjyra fetare, edhe disa perpjekje për të themeluar një parti me ngjyrim fetar siç që Mëmëdheu dështuan në përballjen me elektoratin. E njëjta gjë ka ndodhur me Partinë Demokristiane, e cila nuk arriti të përfaqësohet në parlament pas zgjedhjeve të përgjithshme të qeshorit 2009.

Ndryshe ka ndodhur me pakicat etnike. Minoriteti më i madh, ai grek ka një grupim politik siç është PBDNJ dhe organizatën Omonia, formacione këto që e kanë gjetur veten pjesë të koalicioneve si majtas ashtu edhe djathtas duke siguruar një përfaqësim në qeverisje si në rrafsh lokal ashtu edhe në atë qendror thuajse permanent.

Së fundmi, ka pasur një zhvillim interesant në Parlamentin e Shqipërisë ku për herë të parë do të jetë i përfaqësuar komuniteti çam, po kjo lëvizje nuk pritet të trondisi ekuilibrat e brendshëm dhe duke konsideruar peshën specifike të saj as të ndikojë fuqishëm në ndryshimin e kursit të politikës së jashtme, politikë që ndahet nga të gjitha forcat politike në vend me një program të orientuar drejt integritit euro-atlantik³⁹ si prioritet të saj të parin dhe më të rëndësishmin. Edhe në raportin e fundit të DASH për vitin 2008-të (Departamenti Amerikan i Shtetit) theksohet se : *në përgjithësi, gjatë këtij viti janë respektuar liritë fetare. Ligjet dhe politikat e Shqipërisë kontribuojnë për ushtrimin e lirisë fetare në vend. Qeveria ka respektuar liritë fetare në praktikë dhe nuk konstatohet asnjë rast abuzimi ose diskriminimi për shkak të besimit dhe ushtrimit të një besimi*⁴⁰.

3.3. Media dhe politika: një marrëdhënie komplekse

³⁹ Programi i qeverisë

<http://www.mfa.gov.al/shqip/programi.asp>

⁴⁰ <http://www.dw-world.de/dw/article/0,2144,3660257,00.html>

Rasti i Shqipërisë post komuniste

Nuk është rastësi që kësaj marrëdhënie do ti kushtohet pjesa e dytë e këtij kapitulli dhe në fakt gjatë strukturimit të tij kisha dilemën se mos nuk po i kushtoja vëmendjen e duhur kësaj marrëdhënie shumë komplekse, që mund të ishte fort mirë objekti i një studimi të veçantë.

“Demokracia nuk është e mundur pa një sferë publike politike funksionale që stimulon individin të veprojë dhe vendosi në mënyrë të pavarur⁴¹” dhe vetë ndërthurja e interesave dhe kapilarizimi i tyre në shoqërinë shqiptare e bën binomin media politikë të pandashëm dhe njëkohësisht mjaft interesant për t’u analizuar në funksion të tezës kryesore siç është ajo e ndikimit të retorikës në komunikimin e politikës shqiptare. Është fort e rëndësishme kjo analizë për të realizuar shkallën e ndërlidhjes së politikës dhe medias si edhe marrëdhënien që kanë secila prej tyre me shoqërinë shqiptare dhe si ndikojnë tek ajo.

Thomas Meyer reflekton mbi atë që ai e quan një analizë të orientuar sociologjikisht të procesit mediatik⁴² dhe në kushtet shqiptare ky refleksion i shkon për shtat dinamikës së kësaj marrëdhënie. Analiza e aktualitetit shqiptar dhe metafora e ligjërimit politik nxjerrin në pah pushtetin dhe (keq)përdorimin e tij në përfaqësimin mediatik duke u kthyer në elementë që gjejnë përthyerje në marrëdhënien e sipërpërmendur.

Fuga konstaton se debati politik i shprehur në media merr shpesh përmasat e një komunikimi që bindshëm mund të cilësohet si dhunë verbale⁴³. Por a është i vërtetë ky komunikim në thelb apo vetëm një strategji makiavelike për të dominuar opinionin publik? Sa ndikohet publiku nga kjo mënyrë komunikimi dhe si reflektohet ajo në bindjet e tij politike?

⁴¹Meyer, Hinchman, Media Democracy: How media colonize politics, I.

⁴²Po aty, XVI.

⁴³ Fuga, Rrota e Mundimit, 9.

Këtu më vjen në ndihmë teoria e Gabszewicz dhe Sonnac , të cilët i referohen faktit sesi publiku identifikohet me një produkt të vecantë mediatik, i cili i korresponson “ideales” që secili ka në kokë si model⁴⁴. Pra mund të deduktojmë se është kjo media që prodhon politikë nëpërmjet një produkti të përfunduar që i ofron publikut. Gjithsesi do të shohim më poshtë të shtjelluara disa çështje që lidhen direkt me mbrurjen dhe tiparet e këtij komunikimi duke nisur pikërisht me argumentimin e tezës se media prodhon politikë dhe është kjo e fundit që varet kryekëput prej medias në procesin e komunikimit.

3.3.1. Politika si prodhim i medias

Më duket me vend të sqarohet metodologjia e përdorur që sugjeron një metodë studimore komunikative⁴⁵ për të analizuar realitetin shqiptar bazuar në analiza të ngjarjeve të veçanta por jo vetëm. Po në ç’raporte gjendet media me politikën në Shqipëri? Para se t’i përgjigjem kësaj pyetje , dua të bëj paktin e fjalës për cilësinë e së ashtuquajturit shërbimit publik të medias. Ka një shkollë mendimi që rendit cilësinë e prodhimit të orientuara teknikisht ku përfshihet cilësia superiore e ndriçimit dhe kamerave, skenareve të shkruara në mënyrë inteligjente, drejtimi profesional, aktrim i mrekullueshëm, narrativa efektive dhe ide të qarta dhe të kuptueshme⁴⁶ si thelbësore në vlerësimin e shërbimit publik të medias. Analiza ime nuk kufizohet në këto elementë. Në fakt problemi qëndron në akuzat e njohura dhe kundërakuzat se aksh media anon nga ky apo ai krah i politikës së ditës dhe jo në pak raste ka përjetuar një ndërrim orientimi politik duke vënë në dyshim profesionalizmin e tyre në tërësi.

Por Fuga⁴⁷ tërheq vëmendjen për të vëzhguar edhe lëvizjen me kah të kundërt, pra sa të ndikuara janë mendiat nga pushteti apo nga njerëz të veshur me të dhe sa është në gjendje

⁴⁴ Gabszewicz, Sonnac: L’industrie des medias, 33-45.

⁴⁵ Fuga: Brirët e Dhisë, III.

⁴⁶ Keane, The Media and Democracy, 120.

⁴⁷ Fuga, Brirët e Dhisë, 431.

media të prodhojë politikë. Në fakt në pamje të parë kjo hipotezë duket e palogjikshme nëse analizojmë Shqipërinë post komuniste të viteve '90 kur media kryesisht e shkruar ishte natyrisht e orientuar politikisht, por ishte e qartë se kush i mbante frenat në dorë. Konfliktet e viteve '96-'97 mes pushtetit të kohës dhe organeve të shtypit siç ishte gazeta “Koha Jonë” tregojnë se akoma ishte koha kur pushteti ushtronte tryzni mbi median dhe situata përsëritet me aktorë të ndryshëm por skenar të njëjtë pas ndërrimit të partive politike në pushtet: Televizioni i parë privat “TV Shijaku” ka kaluar një sërë peripecish përgjatë gjithë mandatit të Partisë Socialiste në pushtet. Por pas viteve 2000 gjendja ka ndryshuar thelbësisht me lindjen dhe lulëzimin e televizioneve të shumta private. Atëherë trysnia e pushtetit cilido qoftë ai mbi median nuk mund të mbetet më e kushtëzuar vetëm përmes komunikimit alfabetik, tashme kishte një zë dhe figurë që do të rregullonte marrëdhëniet e politikës me median duke përmbysur raportet e duke vendosur rregulla të reja loje.

Tashmë me kalimin e viteve dhe zbehjen e entuziasmit të mitingjeve nëpër sheshe, politika kishte po aq nevojë për median se edhe kjo e fundit për të. Lindja e televizioneve të reja shihej me admirim nga publiku dhe ai gjente aty të “vërtetën” e mohuar prej dekadash.

Por sa të besueshme ishin lajmet e dhëna në këto media? Pakkush mund të japi edhe sot e kësaj dite një përgjigje pozitive, vështirë të maten empirikisht fjalimet e politikanëve. Madje kjo vërtetohet edhe në komunikimin me shifra, në të njëjtën studio televizive paraqiten dy palë tregues të inflacionit, dy palë tregues të rritjes ekonomike, dy palë të dhëna për nivelin e papunësisë, në këtë rast nuk dihet ku fshihet e vërteta, por një gjë kuptohet: në këtë mes ka dicka që nuk shkon siç duhet. Këtu futet në lojë roli i medias në skalitjen e staturës së politikanëve dhe partive politike të të gjitha krahëve. Jo rrallëherë kemi qenë dëshmitarë të demonizimit dhe stigmatizimit të njërit apo tjetrit protagonist të politikës nga media. Ky proces nuk është kaq i thjeshtë dhe i shpejtë, ai ndodh përditë , kronikë pas kronike,

intervistë pas interviste. Në fund të ditës fati i politikës është në duart e medias dhe ç’është më e keqja fati i politikanit në duart e gazetarit, i cili sic e përshkruan Fuga “*duke dalë për një kohë të gjatë në ekran, duke u mësuar me teatrizimin e të luajturit përpara kamerave, duke kontrolluar përmbajtjen e emisioneve që drejton, pas njëfarë kohe, për të mirë a për të keq, me profesionalizëm dhe aftësi apo me dinakëri dhe sforco, arrin të bëhet një figurë, së cilës i referohet disi symbyllurazi një pjesë e gjërë e audiencës dhe elektoratit*⁴⁸ .

Gazetarit i mvishet roli i politikbërësit dhe politikanit roli i aktorit: situatë krejt e re kjo për ambientin e brishtë politik dhe mediatik të shoqërisë post komuniste, në të cilën po i lihet gjithmonë dhe më pak kohë dhe hapësirë përpunim mendimi qytetarit duke qenë se Shqipëria është në fakt vendi që ka mbi 150 organe shtypi dhe TV qëndrore e lokale ⁴⁹.

Sipas Cipës⁵⁰ Shqipëria është cilësuar në gjykimin e Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve si “ishull i marrëdhënieve informale në fushën e Medias⁵¹” duke vënë në pah gjithë problematikën që has në ditët e sotme gazetaria shqiptare dhe i vlerëson gazetarët si të pambrojtur ndaj punëdhënësve duke qenë se shpeshherë mungojnë kontratat që do të rregullonin statusin e tyre. Po në këtë optikë, shtypi shqiptar klasifikohet si pjesërisht i lirë duke u renditur në vendin e 101 me 50 pikë të mbledhura në vlerësimin e Freedom House për vitin 2009⁵². Por me gjithë përpjekjen për të mirëkuptuar komunitetin e gazetarëve, realiteti nuk ndryshon: procesi i komunikimit është i njëanshëm: politika krijon kornizën , media prodhon politikën dhe farkëton aktorët e saj duke ia servirur atë audiencës sipas shijes dhe interesit të saj dhe në fund të këtij vektori gjejmë audiencën që e konsumon këtë “vakt” në shumicën e rasteve pa e përtypur.

⁴⁸ Fuga, Brirët e Dhisë, 432-435.

⁴⁹ Jupe: Raporti i Qendrës Shqiptare për Monitorimin e Medias (QSHMM) 25 shtator 2006

⁵⁰ Drejtor i Unionit të Pavarur të Gazetarëve

⁵¹ http://www.fes.org.al/al/ProjectsAndPartners/CivilSocietyAndMedia/2006/shtator/Rap_Med.html

⁵² http://www.freedomhouse.org/uploads/fop/2009/FreedomofthePress2009_tables.pdf

Fuga sërish analizon atë që ai e quan “përkthim ideologjik” dhe propagandistik të çështjeve. Politika merr një përmasë ideologjike përgjatë kontaktit televiziv me telespektatorin⁵³

Si rezultat i kësaj strategjie përftohet një gjuhë e ashpër, polemike, plot fyerje drejtuar kundërshtarit por gjithsesi sintetike, me fjali të shkurtra dhe retorikë të qartë. Dhuna verbale është ajo që nuk mungon asnjëherë në fjalime politike dhe çka është më interesante sa më lart ngjitesh në hierarkitë partiake, aq më e pranishme është ajo.

Shembulli më flagrant i kësaj dhune verbale ka qenë deklarata e Jozefina Topallit gjatë një emisioni televiziv pak ditë para zgjedhjeve parlamentare të 3 korrikut 2005 kur aludonte për një plumb të muguar ballit ndaj një eksponenti të pozitës së asaj kohe dhe rezultati që i qartë: zonja në fjalë është zgjedhur aktualisht në një mandat të dytë si Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë për një periudhë 4 vjeçare.

Por për fat të keq nuk është një retorikë e izoluar: vite më parë ish Kryetari i Kuvendit Të Shqipërisë, mbajtës i shumë funksioneve kushtetuese ndër këto edhe Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë, Ministër i Punëve të Jashtme, Kastriot Islami kishte folur për thyerje kafkash demokratësh e tërheqje zvarrë të tyre.

Rastet e sipërpërmendura janë më spikatëset dhe mbresëlënëset se me keqardhje duhet praur se është e vështirë të degjosh një seancë parlamentare, një debat televiziv, një fjalim elektoral apo një deklaratë për shtyp që të mos jetë e mbarsur me etiketime aspakt të denja, fjalor të përçudnuar, stigmatizim të kundërshtarit politik, goditje personale deri në mungesë të çdo respekti ndaj familjes dhe cënim të rëndë të personalitetit dhe e gjithë kjo vorbull është produkt i mediatizimit të politikës apo politizimit të medias.

Viktima e parë dhe e fundit e kësaj dileme të përhershme mbetet receptuesi, i cili përfshihet emocionalisht dhe “harron” të qenit racional në gjendje të distancohet, por përfshihet në atë

⁵³ Fuga, Brirët e Dhisë Tiranë, 434.

që e quajtmë më sipër “mpirje” mediatike, i kapur peng nga kakofonia dhe i servirur me një produkt të gatshëm gati për të qenë i konsumuar prej tij

Kapitulli IV

Retorika dhe elementët kryesorë në analizën e procesit të komunikimit

Në këtë kapitull do të trajohet roli i retorikës dhe tiparet e ligjërimit politik në procesin e komunikimit nëpërmjet analizës semiotike që do të kryhet në intervistat e marra ligjvënësve duke u fokusuar në elementët retorikë dhe semiotikë të përdorur prej tyre gjatë procesit të komunikimit. Elementi i dytë i përdorur për këtë analizë krahasuese janë edhe fjalët e mbajtura prej tyre në Kuvendin e Shqipërisë duke synuar një përfundim përmbljedhës i cili do të analizojë empirikisht sesi përmbushje e programit narrativ përkon me një proces komunikimi të suksesshëm mes politikës dhe publikut.

4.1.Retorika dhe komunikimi

Para se të nisim analizën, dua të bëj paktin e përkufizimit duke iu referuar retorikës. Nëse i referohemi Aristotelit, retorika është arti i nxjerrjes nga çdo subjekt shkallën e bindjes që përmban⁵⁴ por jo vetëm. Në retorikë mund të përmbledhet edhe aftësia për të zbuluar në mënyrë spekulative atë që në çdo rast mund të jetë e vecanta e të bindurit⁵⁵. Në fakt jo rastësisht referohem retorikës së Aristotelit. Arsyeja nuk është preferencë personale, por e bazuar në thelbin e teorisë aristoteliane: në të vërtetë dukshmen. Në funksion të analizës që do të vijojë është shumë e rëndësishme ajo që publiku beson për të vërtetë, për të mundshme sesa të tregohet ajo që është realisht e mundshme, por që nuk perceptohet si e tillë nga publiku. Por sa e rëndësishme është retorika dhe çfarë roli zë ajo në procesin e komunikimit? Dihet tashmë se në ditët e sotme retorika moderne është një lloj diskursi bindës që karakterizohet nga shprehje shabllon që nuk identifikojnë në të vërtetë koklavitjen dhe

⁵⁴ Barthers, Aventura Semiologjike, 325.

⁵⁵ Po aty

kompleksitetin e problematikës të cilën trajton politika. Të intervistuarit i janë përgjigjur pyetjes së fundit se si do të jetë Shqipëria pas 30 vjetësh pothuajse në të njëjtën mënyrë duke vënë në pah se do të jetë ndryshe. Kjo është e kuptueshme, por sa ndryshe dhe a koinçidon koncepti i të qenit ndryshe apo është çështje perceptimi dhe variabël nga njëri tek tjetri?

Duhet theksuar se të bërit reklamë duket se është një nga format më të pranishme të retorikës moderne dhe kjo lloj reklame është e pranishme edhe në politikë.

Nxjerrja në pah e gabimeve të kundërshtarit politik për të nënvizuar se çfarë mund të bëhet më mirë nga forca politike së cilës i përkasin është një nga strategjitë më të pritshme dhe rutinore që vihet re edhe në ligjërimin politik në Shqipëri.

Duke i hedhur një vështrim të shpejtë intervistave që janë të pasqyruara në Apendix, gjëja e parë që bie në sy është përpjekja për të tërhequr vëmendjen e publikut nga problematika e momentit sic mund të jetë furnizimi me ujë të pijshëm, energji elektrike etj për t'u zhvendosur në kohë dhe hapsirë në çështje më makro siç është integrimi në strukturat euroatlantike si një qëllim thuajse unanim i klasës politike shqiptare. Duke ia arritur qëllimit për të zhvendosur vëmendjen, përdorimi i përsëritur i mesazheve për të ndryshuar bindjen e elektoratit nuk është fort i vështirë. Nuk është e pakët në numër fasha e elektoratit që joshet tashmë më shumë nga premtimet që lidhen me Integrimin European sesa nga premtimi për një rrugë të shtruar apo një çezmë që rrjedh ujë të pijshëm.

Një element shumë i rëndësishëm që vlen të përmendet është edhe vendosja e autoritetit në raport me audiencën për një çështje të caktuar⁵⁶. Kjo nuk mund të vijë vetvetiu dhe vihet re shumë qartë në rastin e intervistës së Znj Meksi, e cila nënvizon disa herë kompetencat e saj në fushën e ekonomisë edhe në fushën e mësimdhënies duke stabilizuar me taktikë dhe përunjësi këtë autoritet.

⁵⁶ Corbet, Connors, Classical Rhetoric for Modern Student , 264.

Si rrjedhojë e gërshetimit të elementëve të mësipërm, ndërtohet edhe ura e ndryshimit të këndvështrimit, urë kjo më e sigurt që të ndryshon mendimin dhe për pasojë edhe kahun e votës. Por ajo cka bie në sy është mungesa e vetëdijes për këtë ndryshim: pra shumë pak arrijnë të kuptojnë se kanë ndryshuar mendim dhe marrin vendime tashmë bazuar mbi vlera jo koherente më ato të tyre.(në këtë pikë kam parasysh fashën gri të elektoratit, të pavendosurit që votojnë herë majtas e herë djathtas) .Për t'iu rithyer retorikës, ajo çka konstatoj është përputhja në misionin e saj,qoftë ajo aristoteliane apo moderne e përthyer në element, të cilët i përmenda më sipër siç janë reklamimi apo tërheqja e vëmëndjes së publikut.

Natyrisht e frymëzuar dhe ushqyer mirë nga e vërtedukshmja aristoteliane, retorika moderne synon të servirë atë që besohet si e vërtetë nga publiku dhe ndikon vrullshëm në bindjen e elektoratit për të ndryshuar këndvështrim. Killingsworth ⁵⁷ pozicionon tre elementët e Aristotelit si ethos, logos dhe pathos në një kontekst të ri duke ravijëzuar një model, i cili përmbledh 4 elementë kryesorë në të cilët përfshihen tri pozicione dhe një mjet shkëmbimi: pozicioni i autorit, pozicioni i audiencës(lexuesi, shikuesi, përdoruesi) dhe pozicioni i vlerës së cilës i referohet autori, vlerë kjo që mund të jetë mirëqenie ekonomike, stabilitet politik, solidaritet me komunitetin pra çdo gjë që ka vlerë në jetën e audiencës së cilës i drejtohet. Pra autori në rastin tonë politikani komunikon me audiencën nëpërmjet masmedias(e shkruar, elektronike, emaile etj)duke punuar në mënyrë indirekte në drejtim të pozicionit të vlerës në raport me audiencën.

Qëllimi i autorit është të ndikojë tek audience dhe nëse arrihet një gjë e tillë të tri elementët mund të konsiderohen të mirëgërshetuar.

⁵⁷ Killingsworth: M.Appeals in Modern Rethoric, 1.

Në një koncept më të ngushtë, retorika lidhet direkt me aftësinë për të ndërtuar një diskurs bindës dhe argumentues.

Në fakt lind vetvetiu pyetja:

Në ndërtimin e procesit komunikues të politikanit dhe në diskursin si pjesë thelbësore të tij a është një kriter normativ përdorimi i “së vërtetës” dhe “objektivitetit”? A mund të mvishet retorika me kontribut epistemologjik ?A shërben ajo në ndërtimin e dijes?

Sugjerohet se gjatë një fjalimi apo interviste në përballje me publikun, vendimet duhen justifikuar me argumentim, por a ndodh përherë kështu dhe sa i besueshëm është ky argumentim?

Marrëdhënia mes politikës dhe retorikës është komplekse, por edhe lehtësuese nga njëra anë. Studimi i politikës dhe retorikës analizon rolin e persuazionit në procesin politik dhe nis natyrisht me leximin e klasikëve. Gjithësesi studimet nuk janë sherruese duke marrë parasysh se gjysma e dytë e shekullit të kaluar do të shënonte një “kundërvënie” në lëmin e studimit të komunikimit mes studiuesve të shkollës së perspektivizmit retorik si Cherwitz e Hikins , të cilët kanë artikuluar argumenta të rëndësishëm për sa i përket realitetit të pavarur dhe komunikimit njerëzor duke sfiduar skepticizmin epistemologjik që karakterizon shumicën e teorisë bashkëkohore të retorikës. Me pak fjalë, ajo çka sugjeron prespektivizmi retorik ka tendencë të favorizojë paramentrat epistemologjikë ndaj atyre metafizikë duke pohuar se retorika është epistemë⁵⁸ duke përforcuar në këtë mënyrë bindjen që specialistët e retorikës njohin edhe kontributet epistemologjike të saj të cilët theksojnë rolin e saj në krijimin e njohurisë dhe ndërtimin e perceptimit të realitetit politik.

⁵⁸Cherwitz, Hikins, Communication and Knowledge: An Investigation in Rhetorical Epistemology

Në fakt persuazioni(bindja) politike është e vështirë për t'u analizuar sepse shpesh gjendet e fragmentizuar. Ne normalisht shikojmë vetëm pjesë të shkëputura në lajme, jo të plota dhe normalisht të redaktuara nga dikush tjetër. Nga ana tjetër si perceptues edhe ne jemi të njëanshëm. Nuk jemi një fletë e bardhë në pritje për t'u shkruar, por ballafaqohemi bashkë me bindjet, idetë,emocionet dhe opinionet që i mbartim nga mjedisi nga vijmë.

Si rrjedhim thelbi i persuazionit politik është shumë kompleks dhe i ngarkuar emocionalisht, gjë që e bën analizën e retorikës politike më të vështirë , por dhe më të rëndësishëm.

Gjithsesi studiues si Booth⁵⁹ sugjerojnë se retorika mund të jetë një mjet i përshtatshëm për një komunikim më të mirë duke u bazuar në dëgjimin e të dy palëve dhe duke shmangur elementët konfliktualë, por sa mund të aplikohet kjo lloj retorike në sistemin komunikues në Shqipëri mbetet për t'u parë.

Duhet përmendur fakti se gjatë këtyre 20 viteve të tranzicionit retorika ka qenë shumë e ashpër dhe goditëse duke synuar goditjen dhe demtimin e kundërshtarit politik. Kjo retorikë është materializuar në një horizont të errët sharjesh e shpifjesh që nuk kanë kursyer as familjet dhe as sferën private.

Ndërkohë që po të konsiderojmë se reagimi ndaj gjuhës së ngarkuar emocionale është njëri nga pesë elementët⁶⁰ që radhiten si pengesat kryesore për të dëgjuar, mund edhe te dilet në përfundimin se në më të shumtën e rasteve bëhet pikërisht për të shpërqëndruar kundërshtarin politik.Por sa të vërteta ka brenda kësaj retorike? Sa jemi në gjendje si konsumues të përditshëm të këtij “vakti” të dallojmë mes engjëllit dhe djallit? Sa jemi në gjendje të identifikojmë sajesat e të dallojmë të vërtetën ?Ajo çka bie në sy është fakti se si një qytetar i thjeshtë nuk mundesh të kesh kurrë akses në informacionin e brendshëm ose të kesh kohë dhe aftësi për tu përballur me gjithë kompleksitetin e një fushate elektorale

⁵⁹ Booth, The rhetoric of Rhetoric, 44-46.

⁶⁰ Wood: Interpersonal Communication, 153.

prandaj analiza e këtyre tipareve të persuazionit ka një vlerë të kufizuar: nuk na tregon se cila prej palëve ka “të drejtë” apo ku qëndron “e vërteta” cila nga të dhënat e paraqitura është e besueshme apo seç duhet bërë. Mediat dhe specifikisht televizioni mbeten mbrujtësit e opinionit dhe sipas Giovannettit kanë detyrën për të trajnuar dhe formuar sa më shumë njerëz të jetë e mundur⁶¹.

Kjo është arsyeja pse e gjithë analiza serviret e gatshme më shumë në faqe gazetash, emisione radiofonike e televizive, internet apo blogje.

Aty është mejdani i vërtetë ku bëhen analiza më të sofistikuar të aspekteve politike, sociale, psikologjike dhe ekonomike të politikës dhe programeve politike. Për t'i mbetur besnikë realitetit në shumicën e rasteve bëhet fjalë për të vënë në dukje qëllimet e mbrapshta të tjetrit dhe pasojat e tmerrshme që do të ketë politikat e kundërshtarit në të ardhmen nëse votohet, sesa nënvizimi i anëve pozitive të programit të secilit.

Një analizë e strukturuar mirë ka gjithashtu një kontrast të theksuar me lajmet në TV apo artikujt në gazeta si burimi i mirëfilltë i informacionit të njerëzve, por jo vetëm. Masmedia konsiderohet si mbrujtësi i opinioneve. Ajo çka nevojitet është një paraqitje e ndershme nga profesionistë të zhdërvjellët që njohin mirë politikën, historinë, gjuhën dhe teknikat mediatike dhe trajtojnë me paanësi çështjet dhe japim mendime të menduara mirë në lidhje me kontekstin aktual politik, por sa është e aplikueshme kjo në mediat shqiptare mbetet për t'u diskutuar. Ajo çka nevojitet është një gjuhë jo partizane dhe një analizë sistematike më shumë se sa përgjigje të momentit dhe të frymëzuara politikisht dhe kjo do të ndikonte në ndryshimin e klimës në marrëdhëniet mes politikës dhe të rinjve duke shmangur cinizmin që rinia shpreh ndaj klasës politike. Ky cinizëm që përket në mospjesëmarrje në procesin zgjedhor duhet të zëvendësohet me atë që quhet skepticizëm i shëndetshëm. Në zgjedhjet e

⁶¹ Giovannetti: *Retorica dei Media*, 171.

fundit parlamentare ishte vetëm 50,77 %⁶² e votuesve që preferuan t'iu drejtohen kutive të votimit për të përcaktuar fatin e tyre qeverisës në 4 vitet e ardhshëm dhe natyrisht kjo është pasojë edhe e procesit të komunikimit të sendërtuar në media.

Gjithsesi politika i drejtohet gjithmonë retorikës për të apeluar miratimin e publikut dhe këtu dua të përmend retorikën e “politikës së re” që ishte refreni i fushatës së fundit zgjedhore në Shqipëri dhe synonte pikërisht ndërtimin e një kodi të ri politik që do të tërhiqte qytetarin të velur nga kodet e mëparshme. Por me sa duket edhe nga rezultati zgjedhor, pa shume sukses.

4.2. Analizë teksti

Po sa e rëndësishme është kjo analizë? Përse na shërben ajo? Marrone tërheq vëmendjen tonë duke na kujtuar së komunikimi politik përmban diçka strategjike duke iu referuar Foucault në tezat e tij se ai zëvendëson përdorimin e forcës në proceset e marrjes dhe mbajtjes së pushtetit: tashmë „lufta“ zhvillohet duke i bindur dëgjuesit dhe audiencën në vend që të ushtrohet dhunë mbi ta⁶³. Prandaj është shumë e rëndësishme që të ndriçohen dritëhijet e këtij procesi dhe të identifikohet roli i rij formësimin dhe zhvillimin e karrierës politike të politikanëve.

4.2.1 Vështrim teorik

Një analizë e mirë gjuhësore është në fakt një proces racional në kundërshtim me qasjen emocionale të shumë demagogëve në sipërmarrjet e tyre partizane, sulmet personale, fyerjet dhe slloganet saj, të cilat mjafton të shikojmë një debat televiziv apo të shfletojmë një gazetë ku ato janë përherë të pranishme.

⁶² Deklaratë për shtyp e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (01.08.2009)
<http://www.cec.org.al/2004/veprimtaria/2009/Gusht.htm>

⁶³ Marrone, Trupa shoqërorë: Proceset shoqërore dhe semiotika e tekstit, 223-227.

Për të realizuar analizën e tekstit në ndihmë më vjen skema narrative kanonike, e cila është një evolim i modelit të Propp-it dhe është përpunuar më pas nga Greimas⁶⁴.

Kjo skemë është më e përshtatshme sepse nëpërmjet 4 fazave të saj synohet të analizohet diskursi i prodhuar nga politikanët e përzgjedhur për të konstatuar më pas se sa i rëndësishëm është ky diskurs në raport me sendërtimin e procesit të komunikimit dhe karrierën e bërë.

Dy skajet e segmentit të komunikimit janë subjekti që në rastin tonë identifikohet me politikanin dhe dhënësi që është publiku. Skema kanonike narrative ofron siç u përmend më sipër katër faza: manipulimi, kompetenca, performanca dhe miratimi.

Në fazën e parë të manipulimit Subjekti (politikani) ka marrë detyrë nga Dhënësi (publiku) që nëpërmjet procesit të komunikimit dhe specifikisht nëpërmjet ligjerimit ta bindë këtë të fundit për alternativën që ofron duke pasur si qëllim kryesor marrjen e pushtetit. Për të arritur këtë shërbejnë premtimet, kërcënimet, joshja dhe provokimi.

Premtimi i përdorur rëndom nga politikanët e bën publikun të bëjë diçka në rastin tonë të votojë për të ose të mos bëjë diçka (të mos votojë për kundërshtarin) gjithmonë duke paraqitur përfundime pozitive⁶⁵ për atë do të arrihet pas marrjes së pushtetit.

Kërcënimi kryhet në kësoj rastesh duke identifikuar pasojat negative të një veprimi ose të mos veprimit. Duhet thënë se kjo lloj strategjie është përdorur shumë gjatë periudhës 1997-2005 nga Partia Socialiste që portretizonte kryetarin e opozitës së asaj kohe si “ të keqen e madhe” që do të rikthente situatën e errët të viteve të vështira 1996-1997. Ndërsa joshja apelon në kompetencën e dhënësit duke mikluar imazhin e tij pozitiv dhe gjendet rëndom në fjalime , vlen për t’u përmendur këtu përdorimi i fashave të votuesve siç mund të jenë ish të përndjekurit që votojnë kryesisht djathtas, apo veteranët që anojnë majtas. E njëjta strategji

⁶⁴ Pozzato: Semiotika e tekstit, 41-48.

⁶⁵ Po aty

vihet re edhe me përdorimin e qyteteve “bastione” nga krahët e politikës. Provokimi synon të bëjë dikë të bëjë ose ta ndalosh atë të bëjë duke përdorur imazhin negativ të aftësive të tij, në të kundërt të joshjes. Faza e dytë është ajo e kompetencës, e cila karakterizohet nga katër modalitetet dua, duhet, mundem edhe di, modalitete këto që praktikisht po sipas Greims-it janë thelbësorë në ngritjen e urës së komunikimit mes subjektit (në rastin tone klasa politike dhe veçanërisht politikanët që janë intervistuar) dhe publikut.

Ky raport orientohet në katër drejtime duke përmendur këtu modalitetin *dua*, në të cilin shkrihen të gjitha dëshirat që mbart subjekti (politikani), në modalitetin duhet, i cili përfshin një gamë më të gjerë detyrimesh dhe rregullash, të cilat përqafohen nga subjekti (politikani) edhe në respekt të përkatësisë së tij kolektive dhe sociale. Modalitetet e tjera janë di dhe mundem, modalitete këto që identifikojnë fushën e ekspertizës së subjektit dhe aftësitë e tij përfshi këtu atë që politikani është në gjendje të bëjë dhe ka mundësinë të bëjë.

Në momentin që i ofrohet publikut si i tillë, subjekti ynë (politikani) gjatë ligjërimit që përbën një hallkë shumë të rëndësishme të procesit të komunikimit, i përdor të katër modalitetet duke dalluar këtu modalitetet e virtualizuara siç janë duhet dhe dua dhe modalitetet e aktualizuara siç janë mund dhe di. Po sipas Greims-it, subjekti është i kompletuar dhe programi narrativ konsiderohet i tillë kur i ndërthur të katër këto modalitete⁶⁶.

Megjithatë nuk është e thënë të ndodhë përherë kështu siç do ta vëmë re edhe në rastin e analizës së intervistave dhe të fjalimeve të mbajura në Parlament në periudha të ndryshme kohore: modalitetet nuk janë përjashtuese, por ato janë “të polarizuara”⁶⁷ në tekste, kjo do të thotë që nuk ekziston një balancë hyjnore midis modaliteteve. Në varësi të dominimit të njërit prej modaliteteve, unë do të konkludoj nëse politikani, ligjërimi i të cilit është në

⁶⁶ Po aty

⁶⁷ Po aty

shqyrtim, është më shumë politikan i të mundurës apo i të diturës etj, politikan që përdor argumenta ekonomike apo moralë duke promovuar më shumë modalitetin duhet, apo ka si far dëshirat e veta dhe i ndjek ato duke përdorur modalitetin dua.

Faza e tretë është ajo e performancës që mat me anë të ndryshimit efektet e veprimit të subjektit (politikanit) dhe faza e katërt përkon me miratimin.

Miratimi është pjesa e fundit ku përthyhen të trija fazat e sipërpërmendura. Në fakt vetëm në fazën e fundit të narracionit mund të kuptojmë nëse dhënësi (publiku) ka miratuar ose jo veprimtarinë e subjektit (politikanit).

E aktualizuar në skemën kanonike ajo çka kërkon politikani është një objekt me vlerë që është pushteti dhe këtë do ta arrijë përmes procesit të komunikimit.

Ky proces komunikimi për tu quajtur i suksesshëm duhet të ketë një program narrativ të kompletuar, i cili kalon nëpër 4 fazat e sipërpërmendura dhe në pjesën e dytë do të shohim të pasqyruar analizën e kësaj skeme narrative në intervistat e marra dhe fjalimet për të dalë në konkluzionet e rastit mbi rolin dhe rëndësinë e retorikës në procesin e komunikimit dhe në peshën specifike që luan ky proces në evoluimin e karrierës së politikanëve.

4.2.2. Analizë e intervistave të politikanëve të rrangut të parë

Në këtë pjesë do të analizohen intervistat e marra sipas skemës kanonike duke u mbështetur parimisht në ndarjen në grupe që kam bërë si fillim. Për fat të keq nga grupi i politikanëve të rrangut të parë intervista e vetme që u mundësua ishte ajo me Ben Blushin.

Siç e shpjegova edhe në pjesën pararendëse të këtij kapitulli, çdo subjekt (në rastin tonë politikanët e intervistuar) në momentin që futet në një proces komunikimi me një subjekt tjetër apo me publikun ka një program narrativ që përthyn qëllimin që ai i ka vënë vetes: të bindi që të votohet. Në këtë këndvështrim, skema narrative kanonike ofron katër faza për ta

analizuar këtë programit narrativ dhe unë do të përdor intervistën dhe fjalimet në Parlament si bazë të kësaj analize.

Programi narrativ i subjektit në fjalë nis me fazën e manipulimit dhe kjo vihet re nga mënyrat e komunikimit që ai përdor: ato varjojnë nga mediatiket, përmes komunikimit me shtypin e deri tek forma më kolektive sic janë takimet, mbledhjet, mitingjet, pa neglizhuar këtu kontaktin e drejtpërdrejtë me publikun, kontakt ky që realizohet nëpërmjet takimeve kokë më kokë, në mënyrë individuale. Gjatë këtyre takimeve subjekti përdor figurën e joshjes duke paraqitur imazhin e tij pozitiv ndërkohë që analizon rolin e politikanit:

“Profesinoni i politikanit të jep mundësi të njihesh dhe kjo është arsyeja që shumë njerëz merren me politikë, shumë pak kanë ideologji apo ndonjë projekt për të vënë në jetë. Nevoja për t’u njohur është një shtysë e madhe sot në politikë, sepse duke qenë në politikë kthehesh në një njeri publik dhe ke më shumë vëmendje, dikush mendon se ke edhe më shumë respekt. Në këtë shumicë ka edhe një pakicë njerëzish që kanë projektet e veta dhe kjo është një shtysë e madhe. Ka dy mundësi: të hysh për tu bërë i njohur dhe të bëhesh pjesë e projektit të dikujt tjetër ose të ndjekësh projektin tënd nëse ke një të tillë.”

Figura e joshjes dhe e premtimit zbërthehet edhe në fjalimet e Blushit në Parlament në periudhën kur ishte në pozitë. Ai përdor ato që siapas tij janë arritje të qeverisë, pjesë e së cilës ai ishte duke mbajtur pozicionin e Ministrit të Arsimit. Siç e kemi përmendur më lart, premtimi, kërcënimi, joshja dhe provokimi janë sipas Greims katër figura të mëdha të manipulimit si fazë e parë e skemës narrative kanonike. Unë kam konstatuar se subjekti në fjalë gjatë periudhës në pozitë ka përdorur më shumë dy nga këto katër elementë siç janë joshja dhe premtimi: „*Vetëm kështu pra, duke investuar konform politikave të zhvillimit, të cilat synojnë zbutjen e disproporcioneve midis niveleve të ndryshme në arsim, rritjen e pjesëmarrjes në shkollim, krijimin e kushteve të barabarta për të gjitha shtresat e shoqërisë, rritjen e vazhdueshme të cilësisë së mësimdhënies, rritjen e cilësisë në shkollë në përgjithësi, do të arrijmë të zhdrukim në një kohë të pranueshme*

*diferencat arsimore mes zonave, fshatrave, qyteteve dhe vetë shkollave*⁶⁸.“ Ndërkohë që në një fjalim tjetër po para Parlamentit shqiptar, subjekti në fjalë tashëm në opozitë përdor më shumë figurën e kërcënimit si në rastin që vijon: *Më 3 korrik të vitit 2005 ju vendosët të na nxirrni ne në opozitë. Në këta 3 vjet, që nga 3 korriku, ne këtej kemi bërë detyrën tonë si opozitë, duke iu treguar shqiptarëve se Qeveria e ka zhjytur vendin në mjerim, se ka shtuar varfërinë, se i ka lënë njerëzit pa punë, pa drita, pa ujë, pa shkolla, pa spitale. Sigurisht që unë e di që shumë na kanë besuar, por shumë edhe nuk na kanë besuar, po sot mbas Gërdecit është një ditë tjetër. Sot jam këtu për t’iu thënë qytetarëve shqiptarë se Qeveria i ka vrarë, sot jam këtu për t’iu thënë shqiptarëve se Qeveria e tyre i ka vrarë. Dhe vrasja ndodhi ditën me diell, 10 km nga Tirana, në Gërdec*⁶⁹.

Në këtë kontekst vihet re që ndryshimet politike kanë ndikuar edhe në mënyrën sesi ndërtohet programi narrativ duke ia përshtatur ligjërimin situatës aktuale politike, në të cilën ndodhet subjekti që kam marrë në shqyrtim në momentin e intervistimit apo të fjalës së mbajtur në Parlament. Intervista dhe fjalimet e Blushit janë tipike sipas mendimit tim të një politikani të rrangut të parë dhe kjo vihet re edhe në fazën e dytë të skemës narrative kanonike. Gjatë analizës së kompetencës vihet re prania e të katër modaliteve, të cilat nuk e përjashtojnë njëra tjetrën, por dallohet kthjelltësia e mbizotërimit të modalitetit *di dhe mund*, pra e modaliteve të realizuara⁷⁰. Kjo vihet re kur ai nuk i referohet një modeli të caktuar në politikë, por nënkupton se ai me profilin e tij politik po punon për krijimin e një modelit të vet, modelit Blushi. Kjo gjë vihet re edhe në gjykimin që ai jep për ideologjitë dhe arsyet pse ato janë kaq të zbehta në politikën shqiptare dhe gjithashtu në faktin se subjekti përgatitet për diskutime të paralajmëruara siç janë buxheti duke treguar seriozitet në punën e tij, por

⁶⁸ Fjala e Ministrit të Arsimit Ben Blushi mbajtur në Seancën plenare të ditës së martë, datë 11.12.2001

⁶⁹ Fjala e Ben Blushit mbajtur në seancën plenare të ditës së mërkurë, datë 19.03.2008

⁷⁰ Pozzato, Semiotika e tekstit, 41-48.

edhe duke pranuar se ka edhe fjalime të improvizuara, gjë që nënvizon aftësinë e tij për t'i përballuar situata të tilla. Këto modalitete mbizotërojnë edhe në fjalime e tij si në pozitë:

„Unë mund të them sot se ky këshill vendos së fundi rishikimin e të gjitha politikave shkencore dhe në bazë të sugjerimeve dhe të mendimeve që ai do të tërbeqë, si organi më i lartë i vendimmarrjes në këtë lëmë, do të marrë edhe vendimet përkatëse. Personalisht, pas mjaft diskutimesh që janë bërë edhe me drejtuesit e Akademisë së Shkencave, mendoj se mund të zgjerohet autonomia universitare, mund të shtohet buxheti për shkencën, rimodulimi i programeve kombëtare, si dhe lidhja e shkollave të larta me fushat përparësore të shkencës, duke i'u dhënë një hov aktiviteteve shkencore në përgjithësi⁷¹“ ashtu edhe në opozitë: *Unë, si të gjithë ju dhe si të gjithë shqiptarët, e di pse-në. Unë e di përgjigjen, zotëri. Kjo është një mundësi për të fituar para dhe këtu fillon çështja dhe kjo është arsyeja pse është miratuar ky ligj nga ju⁷²*

Ai e konsideron veten një politikan me një projekt të tijin dhe kjo e çimenton më shumë dominancën e modalitetit *mund*. Pra ai është në gjendje të ketë një projekt edhe ta realizojë atë. Të pranishme janë edhe modalitetet që kanë një qasje më kolektive siç është modaliteti *dubët* që identifikohet me përgjigjen që subjekti jep për përdorimin e multimedias në komunikimin me publikun.

Ai sugjeron se duhet pasur parasysh asryet objektive pse nuk përdoren për momentin, por nënvizon edhe domosdoshmërinë e përdorimit të tyre në të ardhmen. Modaliteti *dua* është i pranishëm në përgjigjen e pyetjes së fundit për vizionin e Shqipërisë së pas 30 viteve, vizion ky që çlirohet nga kornizat e politikave lokale dhe synon drejt të qenit pjesë e vendimmarrjes globale gjithmonë në kuadër të integritit në strukturat Euro-Atlantike.

Në varësi të modalitetit të përdorur më shumë apo që dominon mbi të tjerët përcaktohet edhe lloji i ligjërimit. Duke qenë se tek ky subjekt modaliteti dominues është ai i aktualizuar

⁷¹ Fjala e Ministrit të Arsimit Ben Blushi mbajtur në seancën plenare të ditës së martë, datë 11.12.2001

⁷² Fjala e Ben Blushit mbajtur në seancën plenare të ditës së mërkurë, datë 19.03.2008

(di, dubet), edhe lloji i ligjërimit do të determinohet prej tij. Këta elementë përthyhen tek intervista e Z.Blushi duke e bërë më të zbërthyeshme fazën e tretë të skemës narrative kanonike: performancën. Është tërësia e elementëve të sipërpërmendur, të cilë bëjnë dallimin në performancë duke e lidhur atë me fazën e fundit të skemës që është miratimi. Në bazë të skemës narrative kanonike dal në përfundimin se subjekti në fjalë e ka realizuar programin narrativ për t'u zgjedhur duke fituar edhe miratimin e publikut. Kjo është edhe arsyeja pse subjekti që prej përfshirjes në politikë ka qenë përherë i pranishëm me projektet e tij siç është edhe angazhimi i tij i fundit në Lëvizjen për Mendimin Ndryshe që po zhvillohet brenda Partisë Socialiste me qëllim dhënien fund të bojkotit dhe kthimin e grupit parlamentar të opozitës në Parlament. Kjo lëvizje nuk habit duke marrë parasysh edhe atë çka Blushi mendon për rolin e parlamentit, mendim ky i shprehur në intervistën e tij: *„Parlamenti është rregullatori dhe kontrollori i jetës politike, pjesa dërmuese e politikës dhe e ligjvënies konsumohet në parlament, ai është zemra e demokracisë dhe pluralizmit në një vend ku përveç procesit të ligjvënies , i cili është i pakapërcyeshëm se ligjet mund të vendosen vetëm në Parlament dhe asgjëkundi tjetër dhe përveç se ka një rol rregullator, është arena e një debate politik me karakter social, ekonomik në varësi të temave të ditës Roli i tij po forcohet përfshi edhe mndryshmet e reja kushtetuese dhe pesha e Parlamentit dhe ndikimi i tij ose i debatit parlamentar në opinionin publik është në rritje.“*

Është kjo mënyrë e ndërtimit të ligjërimit që bën dallimin mes politikëve dhe peshës së tyre specifike në skenën politike shqiptare. Më poshtë do të shikojmë dallimet në këtë proces komunikimi në rrangun e dytë dhe të tretë të politikanëve.

Siç e thashë më sipër, ishte e mundur të bëhej vetëm një intervistë me politikanë të rrangut të parë, fakt ky që i bën përfundimet jo shtruese dhe nuk lë shumë shteg për përgjithësime branda kësaj kategorie politikanësh.

4.2.3. Analizë e intervistave të politikanëve të rrangut të dytë

Siç e kam argumentuar në kapitullin e dytë, grupi i dytë përfshinte fillimisht politikanë me një profil më të ulët politik, por gjithsesi aktivë në jetën politike në rrangje ministrash dhe ish ministrash, por njëkohësisht edhe të përfshirë në jetën akademike si Aldo Bumçi (PD); Ermelinda Meksi (PS); Pëllumb Xhufi (LSI)

Siç shihet edhe nga numri i të intervistuarve, politikanët e këtij grupi janë më të disponueshëm dhe dua të theksoj pozitën komode në të cilën jam ndier gjatë intervistimit të tyre. Edhe subjektet e këtij grupi kanë të njëjtin synim: në momentin që futet në një proces komunikimi me një subjekt tjetër apo me publikun kanë një program narrativ që mishëron qëllimin që ata i ka vënë vetes: të bindin që të votohen.

Fazën e manipulimit është e përbashkët tek të tre subjektet dhe kjo vihet re nga mënyrat e komunikimit që ata përdorin: mediat zënë një vend kryesor, por pa lënë mënjanë edhe takimet direkte me elektoratin duke vendosur një kontakt të drejtpërdrejtë .

Znj Meksi shfrytëzon edhe rolin e saj si lektore për të perfeksionuar këto kontakte, ndërkohë që Zoti Xhufi përcjell shpesh herë në median e shkruar mendimet e tij duke i bërë jehonë ngjarjeve të rëndësishme politike. Është interesante prania në shtyp edhe në rolin e analistit, jo vetëm të politikanit. A janë të pranishëm në shtyp këta politikanë sepse dëshirojnë t’ju dëgjohet zëri si të tillë, apo nuk ndihen mjaftueshëm të fuqishëm për t’u imponuar si politikanë dhe preferojnë ta gërshetojnë rolin e politikanit me atë të analistit? Në fakt përgjigjja vjen vetvetiu si rezultat i hulumtimit të këtij punimi: politika është produkt i medias dhe për të qenë tërësiht i pranuar nga publiku dhe elektorati këta politikanë e kanë ndjerë të nevojshme t’i qasen elektoratit edhe nëpërmjet optikës së analistit.

Edhe këta subjekte gërshetojnë figurat më kryesore të manipulimit siç janë premtimi pikërisht në intervistat e marra prej meje si p.sh. “nëse do të vijmë në pushtet, gjerat do të

ndryshojnë për mirë “ (Xhufi; Meksi) apo “nëse do të rimandatohej, do të kemi mundësi për të përfunduar shumë punë të mira të nisura nga kjo qeveri”(Bumçi) apo joshjen në shprehje të tipit “Shqiptarët do të dinë të zgjedhin”. Por figurat e manipulimit që përdoren janë pak a shumë të orientuara edhe nga raporti me politikën e momentit dhe pozicioni i secilit prej subjekteve në skakierën e pushtetit politik. Vihet re një ndryshim i ligjërimit jo vetëm në kalimin nga pozita në opozitë, por edhe në të pasurit një funksion ose jo brenda të qenurit në pozitë sic është rasti i Z.Bumçi: *“Kur erdha në drejtim të kësaj administrate, të gjithë punonjësit e Ministrisë së Drejtësisë ishin me vlerësimin “shumë mirë” (99% e tyre). Kjo është njëllë sikur nxënësve të shkollës, studentëve të fakultetit t’i thuash se, pavarësisht se si mësoni, jeni të gjithë me notën 10. Kur nuk kemi trashëguar një sistem vlerësimi, pjesë të përgjegjësisë këtu ka dhe Komisioni i Shërbimit Civil, atëherë si mund të vlerësojmë në nëpunësit që kemi gjetur?”*⁷³

Ligjërimit bëhet më pak dominues dhe i përgjithshëm në rastin kur i njëjti subjekt është tashmë vetëm një deputet i partisë në pushtet dhe kjo reflektohet edhe në ligjërimitin e tij: *“Unë mendoj se ka tri kritere të rëndësishme politike dhe morale për të vlerësuar qëndrimin ndaj kësaj shumice si deputet i saj. E para, a mbajti kjo Qeveri dhe kjo shumicë përgjegjësi politike? Unë mendoj se kjo Qeveri mbajti përgjegjësi politike dhe këtë e tregoi me dorëheqjen e ministrit të Mbrojtjes. E mbajti për dy arsye: dorëheqja e ministrit të Mbrojtjes nuk është kokë turku, por është dorëheqja e ministrit që mbulonte politikisht atë fushë. Kryeministri, si në çdo vend të botës, nuk drejton një ekip nëpunësish civilë, nuk është e vetmja figurë politike. Ai drejton një kabinet politik me njerëz që dekretohen nga Presidenti i Republikës dhe votohen nga Parlamenti, siç do të votojmë sot zotin Oketa. Pra, çdo person ka një përgjegjësi politike dhe ligjore për fushën e tij”*⁷⁴.

⁷³ Fjala e Ministrit të Drejtësisë Aldo Bumçi mbajtur në seancën plenare të ditës së hënë, datë 13.2.2006

⁷⁴ Fjala e deputetit Aldo Bumçi mbajtur në seancën plenare të ditës së enjte, datë 27 mars 2008

Dallohet qartë ndryshimi i mënyrës sesi ndërtohet ligjërimi në dy fjalimet duke reflektuar edhe pozicionin e subjektit: në rastin e parë në një pozicion të veshur me politikbërje dhe në rastin e dytë nën petkun e njërit prej deputetëve të shumicës duke u identifikuar me grupin dhe në respektim të plotë të vullnetit të këtij grupi.

Një aspekt tjetër interesant është edhe investimi me imazhin e tyre prej intelektualësh që i përkasin edhe botës akademike(Xhufi, Meksi) duke përdorur këtë aset si joshje, pra një prej figurave të fazës së parë të manipulimit. Ajo çka vihet re është ndryshimi i modalitetit të ligjërit, por gjithsesi i fokusuar në tema kyçe , të cilat përcillen vit pas viti e legjislaturë pas legjislature, p.sh le të shqyrtojmë sesi ndryshon diskutimi i Meksit në rrjedhë kronologjike:

Më lejoni t'ju falënderoj që dhe në kushtet e kësaj situatë të vështirë që po kalon vendi nuk keni lënë jashtë vëmendjes procese të rëndësishme, tepër vitale, siç është ai i integritetit ndërkombëtar të Shqipërisë. Kërkesa për këtë interpelancë më jep mua dhe ekipit ndërministror, që unë drejtoj, sigurinë që në përmbushjen e këtij objektivit, sa të vështirë dhe ambicioz, të anëtarësimit të Shqipërisë në Organizatën Botërore të Tregtisë⁷⁵.

Në këtë periudhë edhe nga leximi i plotë i fjalës së saj vihet re vështirësia dhe ngërci i një situatë jo fort të këndshme në Shqipërinë fill pas trazirave të viteve 1997-1998, e cila sapo kishte fituar një stabilitet të brishtë. Ndërsa më poshtë, në fjalën e saj në mbrojtje të buxhetit faktit 2002, subjekti ndërton ligjërimin duke nënvizuar faktet pozitive siç janë avancimi i reformave në mbështetje të sektorëve socialë:

Do të theksoja që në fillim që Buxheti faktik i vitit 2002 nga pikëpamja e përbërjes është një arritje, sepse ai përbën hapin dhe dokumentin e parë të hartuar sipas një kuadri politikash fiskale afatmesme, në të cilën një vend i veçantë i është dhënë avancimit të reformave dhe mbështetjes së sektorëve socialë, ku me përparësi janë konsideruar sektorët e shëndetësisë dhe arsimit⁷⁶ ndryshe nga ai që ka mbajtur 5 vite më vonë

⁷⁵ Fjala e Ministres së Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Ermelinda Meksi mbajtur në seancën plenare më 10.05.1999

⁷⁶ Fjala e Ministres së Integritetit Ermelinda Meksi mbajtur në seancën plenare të ditsë së hënë, datë 27.10.2003

tashmë në opozitë: *Si deputete e zonës 35, dhe në emër të një numri familjesh jo vetëm të kësaj zone, dëshiroj edhe një herë të sjell në vëmendjen tuaj një problem shumë të diskutuar, atë të çështjes së subvencioneve të teksteve shkollore në arsimin parauniversitar. Është sa fjes, edhe trishtues fakti që shpërndarja e këtij subvencioni për këto tekste pothuajse nuk ka nisur ende. U tha se do të fillonte në tetor, por asgjë nuk u bë. Pas kritikave të vazhdueshme të opozitës, ministria premtoi se kjo do të realizohej në fund të dhjetorit, por, përsëri sipas të dhënave, pothuajse nuk rezulton gjë. Asnjë qindarkë nuk është dhënë deri tani*⁷⁷

Ajo çka bie në sy është ndryshimi kryekëput i qasjes duke nënvizuar në rastin e parë arritjet e qeverisë (pjesë e së cilës qe edhe vetë) dhe duke nxjerrë në pah mungesën e koherencës së qeverisë aktuale me një gjuhë prekëse. Ky komunikim ndërtohet duke mbajtur zgjedhësin dhe njeriun e thjeshtë në vëmendje dhe në këtë aspekt subjekti është shumë koherent. Në fjalimin si ministre subjekti i referohet përparësisë në sektorët e shëndetësisë dhe arsimit, sektorë këta me një ndjeshmëri shumë të lartë për fashën e elektoratit së cilit ajo i drejtohet. Këtë gjë e bën edhe në fjalimin 5 vite më vonë duke iu referuar gjithmonë problematikës së votuesve të zonës së saj zgjedhore në lidhje me subvencionimin e teksteve shkollore në arsimin parauniversitar. Padyshim tematikë e majtë, tradicionale për të dhe kjo përforcohet edhe në intervistën e saj, në të cilën shprehet se: *Roli i ideologjive është i rëndësishëm në konceptin e alternativave, jo në kuptimin që është përdorur deri dje. Besoj se duhet të ekzistojë për shembull një platformë politike e së majtës që mbështetet në ide të shtjelluara mirë në shërbim të njerëzve duke iu ardhur atyre në ndihmë me politika sociale të caktuara*⁷⁸. Në këtë aspekt mund të them se subjekti ka një vijshmëri tematikore koherente që është pjesë e strategjisë së saj në ndërtimin e procesit të komunikimit me elektoratin e saj dhe publikun e gjerë në tërësi. Por gjuha ashpërsohet dhe mprihet në diskutime plot pathos, më qëllim bindjen e publikut përmes

⁷⁷ Fjala e deputetes Ermelinda Meksi në seancën plenare të ditës së enjte 24.01.2008

⁷⁸ Intervistë e Ermelinda Meksit, shih Appendix-in

mallëngjimit si në rastin më poshtë: *Duke vizituar të dëmtuarit këto ditë në spital apo aty ku janë strehuar përkohësisht, nuk ke si të mos prekesh nga vështirësitë e qindra familjeve që po vuajnë këto ditë të ftohta, por njëkohësisht nuk ke sesi të mos revoltosh për fajtorët që sollën në këtë ditë qindra banorë të Gërdecit dhe realisht një tragjedi kombëtare. Kush sulmoi dhe kush mbolli vdekjen? Kush i vrau ëndrrat dhe shpresën e këtyre njerëzve në hallin e tyre, në punën e tyre, në shtëpinë e tyre të ngritur me gjak e me djersë?*⁷⁹

Të njëjtën metamorfozë pëson edhe gjuha e subjektit Xhufi, i cili në një nga fjalët e tij në kuvend shprehet se: *“Të gjithë e ndiejmë se kësaj atmosfere pozitive të bashkëpunimit për reformat, në funksion të integritetit në NATO, nuk i ka munguar një dozë jo e vogël hipokrizie; nuk i kanë munguar edhe përpjekjet për të kaluar kontrabandë ligje të dyshimta e pakte të fshehta, që në thelb mbrojnë interesa të pjesshme dhe dëmtojnë interesin e përgjithshëm. Një prej këtyre pakteve të fshehta, që ka trazuar ujërat e politikës ditët e fundit është ai që ka të bëjë me sistemin zgjedhor të ideuar nga mendja pjellore e Kryeministrit dhe të promovuar nga segmente të caktuara të opozitës.”*⁸⁰ Gjuha e tij nuk “ëmbëlsohet” as në intervistën e marrë prej meje, aq sa kur pyetet për rolin e Kuvendit, ai nuk kursehet të shigjetojë drejtuesit aktualë të tij si më poshtë:

*“Ka një uzurpim të roleve , p.sh.Kryetari i Parlamentit që është një i parë ndër të barabartët, një shprehës i dhe mbrojtës i interesave të deputetëve, është një moderator në seancat por që nuk ka asnjë tagër për të shprehur qëndrime politike në emër të Parlamentit , por kjo ndodh rëndom. Kryetarja aktuale e Parlamentit ka krijuar konflikte me institucione të tjera si me Prokurorinë duke uzurpuar vullnetin e Parlamentit. Ka ndërhyrë duke shkruar letra të ashpra ndaj Prokurores së Përgjithshme, ndaj Gjykatave duke u hequr si shprehëse e vullnetit të Parlamentit dhe e tillë nuk është, ajo është thjesht një spikere, një moderatore dhe një përcjellëse, thjesht përcjellëse e vullnetit të Parlamentit, një depozitare e vullnetit të tij”*⁸¹.

⁷⁹ Fjala e deputetes Ermelinda Meksi në seancën plenare të ditës së enjte 27.03.2008

⁸⁰ Fjala e deputetit Pëllumb Xhufi në seancën plenare me datë 10.03.2008

⁸¹ Intervistë e Pëllumb Xhufit, shih Apendix-in

Ndërkohë që pozicionin e politikanit ky grup e sheh pak a shumë nën të njëjtën optikë duke e përkufizuar si “funksion komplementar (Meksi), të përkohshëm (Xhufi)”.

Qëndrimi i këtyre subjekteve ndaj profesionit të politikanit është tipike sipas mendimit tim e një politikasi të rrangut të dytë, aktiv në politikë dhe në qeverisje, por pa ambicje mjet të fortë për të qenë lider. Në ndryshim nga subjekti i analizuar në grupin e parë të politikanëve, ky grup nuk flet për projekte, por për devotshmëri dhe shërbim ndaj publikut. Kjo gjë nuk është domosdoshmërisht negative, përkundrazi i bën nder atyre, por është shenjë dalluese midis politikanëve që kanë një projekt për të realizuar dhe atyre që duan të bëhen pjesë e një projekti.

Një argument në favor të kësaj analizë janë edhe modalitetet e pranishme në analizën e kompetencës si fazë e dytë e skemës kanonike. Në ndryshim nga Blushi në skemën narrative të së cilit mbizotëronin modalitetet *di* dhe *mund*, në rastin e subjekteve të grupit të politikanëve të rrangut të dytë mbizotërojnë më shumë modalitetet e virtualizuara si *dua* dhe *duhet*, sidomos tek Bumçi dhe Xhufi. Kjo nuk do të thotë që modalitetet e aktualizuara *mund* dhe *di* nuk janë të pranishme, por ato shfaqen më të zbehta.

Për hir të së vërtetës duhet të përmend se modaliteti *di* është më i theksuar tek Znj.Meksi, ndërkohë që ajo e përmend shumë herë pozicionin e saj në fushën akademike si një vlerë të shtuar për të qenë më e besueshme.

Edhe pse hezitojnë në pamje të parë për t’iu referuar një figure si model, Meksi dhe Xhufi shpalosin figura që i korrespondojnë imazhit të tyre për politikanin: Meksi përmend Nënë Terezën duke përforcuar natyrën e saj idealiste që e konsideron politikën si një shërbim ndaj publikut duke u shprehur se: *“Unë e konsideroj veten një idealiste që kërkon të përballojë sfidat dhe të zgjidhi problemet duke synuar perfeksionizmin dhe të bërit e gjërave sa më mirë .Një figurë që më frymëzon*

është Nënë Tereza, një jetë e kalaur në misionin e saj në shërbim të njerëzimit. Edhe unë besoj tek mundësia e njerëzve për të bërë mirë e për të sjellë ndryshim”

Z. Xhufi përmend Fan Nolin ndër të tjera edhe për figurën e tij poliedrike si një intelektual dhe kontribues në kulturën shqiptare: *Fan Noli është një idhull jo vetëm në kuptimin e aktivitetit të tij politik dhe shoqëror, por edhe atij shkencor dhe kulturor, Sami Frashëri e Abdyl Frashëri janë modele për këmbënguljen dhe pathosin me të cilin luftuan për të idenar shtetin shqiptar, si do ishte shteti shqiptar dhe Ismail Qemali natyrisht duke bërë një vështrim kritik si të thuash jo vetëm për Ismailin , por edhe për të gjithë personazhet që unë përmenda dhe duke marrët pozitive racionale që ata kanë pasur.”*

Ajo çka bie në sy nga intervistat është edhe rënia dakort nga e majta në të djathtë për rolin e ideologjive. Bumçi i referohet shtresave jetike në të cilat e djathta duhet të mbështetet:

“P.sh. unë nuk do të isha futur në Partinë Demokratikë nëse nuk do ta shikoja atë si përfaqësuese të disa vlerave. A është PD-ja përfaqësuese ideale e këtyre vlerave? Jo, nuk mund të jetë sepse si një parti e madhe duhet të përfaqësojë një grup më të gjerë shoqëror, jo vetëm të përndjekurit apo të shpronsuarit. Ky element identiteti sic janë të përndjekurit apo të shpronsuarit duhet të jetë i patjetërsueshëm dhe kjo ka qenë arsyeja që unë jam future në këtë forcë. Elementi i identitetit si forcë antikomuniste që duhet të riktheje indentitetin e një Shqipërie para periudhës së komunizmit për mua janë shume të rëndësishme. Nëse këto nuk ekzistojnë (se kjo ka të bëjë edhe me kompromisin që bën njeriu me veten), atëherë kjo forcë nuk do të ishte më ajo që unë mendoj”⁸²

Pra ai në kundërshtim me idetë e Blushit për një zbehje aktualisht të ndasive ideologjike majtas e djathtas, identifikon një shtresëzim të partive politke. Ato duhet të mos humbin nga vëmendja interesat e grupeve bazë të elektoratit në të cilat duhet të mbështeten. Edhe Meksi e vlerëson rolin e ideologjive si orientues për platformat që partitë politike duhet të gjenerojnë në përputhje edhe me nevojat e shtresave sociale, në të cilat mbështet elektorati i

⁸² Intervistë e Aldo Bumçit, shih Apendix-in

majtë: Roli i ideologjive është i rëndësishëm në konceptin e alternativave, jo në kuptimin që është përdorur deri dje. Besoj se duhet të ekzistojë për shëmbull një platformë politike e së majtës që mbështetet në ide të shpjelluara mirë në shërbim të njerëzve duke iu ardhur atyre në ndihmë me politika sociale të caktuara⁸³.

Në të njëjtën linjë është edhe Xhufi kur flet për rëndësinë e piketave historike

“Në këtë këndvështrim partitë e sotme janë gjithnjë e më pak ideologjike, dhe gjithnjë e më shumë parti të ditës, të së përditshmes që orientohen nga problematika që lindin probleme të mëdha siç është ai i ambientit. Ambienti është sot pjesë e programeve të të gjitha partive politike dhe nuk ka ekzistuar dikur. Megjithatë unë mendoj se ekzistojnë disa piketa në historinë e një kombi të cilave i referohen partitë politike si masë për pozicionimin e tyre në të majtë dhe në të djathtë pikërisht sepse ka zgjedhur disa referenca historike të caktuara që lidhen me njerëzit apo shtresat shoqërore që tërheqin këtë parti apo atë parti⁸⁴” duke pohuar atë që Fuga e quan një model të së majtës në politikë, model ky që është formuluar nga e majta demokratike perëndimore si një tërësi vlerash⁸⁵.

Subjektet flasin me gjuhë thuajse të unifikuar sa i përket të ardhmes. Ky lloj ligjërimi standart që ka si kryefjalë të tij integrimin euro-atlantik kushtëzon performancën e tyre duke marrë edhe miratimin e publikut. Edhe në këtë rast programi narrativ është i realizuar dhe subjektet janë aktivë në jetën politike, por gjithsesi si pjesë e projektit të dikujt tjetër pa spikatur elementë lidërimi.

4.2.4. Analizë e intervistave të politikanëve të rrangut të tretë

Në grupin e tretë përfshihen intelektualë të mirëfilltë të angazhuar me kohë në politikën shqiptare, por disa prej tyre pa patur një investim të përhershëm në të: Gjovalin

⁸³ Intervistë e Ermelinda Meksit, shih Apendix-in

⁸⁴ Intervistë e Pellumb Xhufit, shih Apendix-in

⁸⁵ Fuga, Majtas jo Djathtas, 217.

Prenga(PD);Parid Teferiçi (PD); Besnik Bisha (PR),Gëzim Karapici (PD)dhe Genc Sharku (PR)

Subjektet i drejtohen pak a shumë publikut me të njëjtat mjete për të realizuar programin e tyre narrativ, ata preferojnë takimet e drejtpërdrejta me publikun dhe kjo fazë e parë e skemës narrative kanonike është pothuajse e njëtrajtshme në të gjitha grupet kampion të politikanëve. Ajo që vlen për t'u theksuar është se gjatë intervistave subjektet ishin shumë më të kursyer në detaje. Edhe këta subjekte gërshetojnë figurat më kryesore të manipulimit siç janë premtimi dhe joshja, figura këto që vihen re edhe në fjalët e tyre në Kuvendin e Shqipërisë. Ajo çfarë bën përshtypje është fakti që të gjithë deputetët e këtij grupi janë për herë të parë në Kuvendin e Shqipërisë dhe nuk janë rizgjedhur në legjislaturën vijuese. Një tipar tjetër që karakterizon shumicën e intervistave dhe diskutimet e tyre në Kuvend është partizanizmi dhe tifoja politike që bëjnë, një prirje që në shumicën e rasteve bazohet në fraza të fryra emfatike, që venë në shënjestër kundërshtarin politik dhe karakterizohen nga një kahje e fortë politike dhe në disa rastë ka veprim “Ilustrues” e lajkatar ndaj liderit politik të partisë përkatëse. Karapici shprehet se: *“Në shtypin e majtë dhe nga opozita , përveç mohimit të çdo akti pozitiv të mirëpritur nga opinioni i gjerë shqiptar, po dëgjojmë vazhdimisht për rrezikun që do t'i sillka të ardhmes ekonomike të vendit politika e përgjysmimit të taksave, e shpallur nga PD dhe Kryeministri Berisha që në periudhën e fushatës elektorale. Së pari, për herë të parë, shqiptarët, pas tetë vjetësh, po kuptojnë nga veprimet energjike e të singerta të kabinetit Berisha se ata kanë një Qeveri që e mban fjalën e premtuar, filluar kjo me reduktimin e taksave dhe me iniciativën për lënien e imunitetit të deputetit për akte korruptive⁸⁶”.*

⁸⁶ Fjala e mbajtur nga Gëzim Karapici në seancën plenare të ditës së enjte, 13.10.2005

Ajo që bie në sy është përdorimi i kësaj gjuhe shpotitëse në fillim të legjislaturës si një shenjë devotshmërie ndaj barrikadës politike. Ndryshon mënyra e ndërtimit të ligjërimit politik dhe gjuha që përdoret në një diskutim në përfundim të legjislaturës. Tashmë ajo është gjuhë esëll, e ekuilibruar, pa ngjyime të forta partiake dhe shumë profesionale: “*Në kohën e sotme universitetet private në Shqipëri nuk janë më një realitet i dorës së dytë. Universitetet private, kur e meritojnë një titull të tillë, duhen konsideruar një thesar i arsimit kombëtar, sepse me shembullin e tyre mund të kontribuojnë në pasurimin e mozaikut kombëtar të arsimit të lartë, veçanërisht në drejtim të një menaxhimi më efikas, vendimmarrjeje më të shpejtë, me fleksibilitet e kushte optimale në mësimdhënie e një infrastrukturë didaktike moderne*⁸⁷” Duke parë rezultatin e përzgjedhjes së listës proporcionale të kandidatëve për deputetë, kuptohet qartë se subjekti në fjalë e ka kuptuar se tashmë nuk bën pjesë në rrethin e afërt të të preferuarve nga lideri dhe si rrjedhojë i kthehet ligjërimit të ekuilibruar dhe aspak agresiv, duke ndërhyrë me profesionalizëm në debatin parlamentar dhe kjo është arsyeja pse kam zgjedhur të analizoj dy fjalë të subjektit në Kuvend, një në fillim të legjislaturës dhe tjetrën në fund të saj për të bërë dallimin në mënyrën sesi ndërtohet komunikimi në raport me kostelacionin politik aktual të subjektit. Bie në sy një intervistë shumë e sintetizuar e subjektit në fjalë, më përgjigje që deri diku tentojnë të jenë edhe dogmatike: “*Modeli më i mirë është të jesh vetvetja dhe i ndershëm me shoqërinë dhe elektoratin*⁸⁸”.Duket një lloj “bezdisje” nga intervistat e drejtpërdrejta dhe kjo duket e cuditshme kur subjekti në fjalë ka mbajtur edhe postin e nënkryetarit të komisionit parlamentar të Medias dhe Arsimit, përpos mbajtës i titujve shkencorë në fushën e tij.Ky grup është më atipik sesa grupi i politikanëve të rrangut të dytë. Shumë më heterogjen nga përbërja ky grup është interesant të analizohet në larminë e intervistave dhe fjalëve të mbajtura në Parlament.

⁸⁷ Fjala e mbajtur nga Gëzim Karapici në seancën plenare të ditës së hënë, datë 3 mars 2008

⁸⁸ Intervistë e Gëzim Karapicit, shih Apendix-in

Pyetja që bën diferencën është ajo mbi profesionin e politikanit. Me sa duket kjo është një pyetje që i detyron disa të intervistuarit për t'u parë në pasqyrë. Është interesante sesa të larmishme janë konsideratat për këtë profesion: ka syresh që e quajnë mision dhe këtu shoh analogji edhe me politikanët e grupit të dytë, pra nuk është e rastësishme konsiderimi i politikës si mision. Përgjigjet janë ngacmuese duke filluar nga Bisha që shprehet se:

„Duke qenë se jam regjizor, politika nuk ka qenë profesioni im primar. Mendoj se si çdo profesion kërkon eksperiencë dhe kualifikime dhe tashmë po filloj ta ndjej se po futem në optikën e të qenit i tillë⁸⁹. Pra me sa duket u dashka një legjislaturë për të kuptuar thelbin e të qenit politikan. Koncepti i të qenit politikan i humb konturet e të kuptueshmes në rastin e Sharkut kur shprehet se:
„Politikani nuk është profesion, është mision. Profesion i tjetër gjë, pavarësisht se politikën e trajtojmë si të tillë, po nuk jam dakort. Është një mision i vështirë dhe përballjet që ndodhin në politikë tregojnë për suksesin, nëse ajo rrymë që unë përfaqësoj, apo dikush tjetër përfaqëson, atëherë ajo është politikë e suksesshme⁹⁰“ Por në intervista hasen edhe përkufizime interesante dhe realiste siç është ai i Prengës: „Profesioni im i parë nuk është politikan dhe tani kam filluar të mendoj se si do kthehm në profesionin tim. Mendoj që në Shqipëri është një profesion që konsumon, sigurisht edhe promovon. Unë besoj se secili politikan në vetvete do të realizojë diçka për njerëzit që e mbështesin dhe është shumë e vështirë ta bëjë një gjë të tillë prandaj them se politika në Shqipëri është shumë centrifugale dhe të konsumon⁹¹.

Në këtë këndvështrim, vjen edhe mënyra se si e konsideron Teferiçi profesionin e politikanit, një përkufizim shumë i goditur për klimën e ashpër të të bërit politikë në Shqipëri: *„Atëherë, politika në Shqipëri si profesion është pak si atipike, nuk është si në vendet e tjera me demokraci të zhvilluar ku politika mund të konsiderohet si profesioni i mirëfilltë në konceptin weberian. Në Shqipëri duke pasur parasysh edhe lëkundjet dhe sizmikën, nuk mund të ketë askush siguri në jetëgjatësinë politike, përveç se të*

⁸⁹ Intervistë e Besnik Bishës, shih Appendix-in

⁹⁰ Intervistë e Genc Sharkut, shih Appendix-in

⁹¹ Intervistë e Gjovalin Prengës, shih Appendix-in

*angazhohet fort dhe në mënyrë konsistente*⁹². Në mënyrë elokumente ngrihet shqetësimi se politika shqiptare përveçse të qenit art i së pamundurës, nuk është aspak e thjeshtë për vetë kushtet specifike shqiptare.

Ajo çka bie në sy është distancimi prej tij në mënyrë indirekte duke nënvizuar faktin se për shumicën e subjekteve ai nuk është profesioni primar. Ndihet ndjeshëm diferenca në përcaktim dhe konceptim nga politikani i rangut të parë edhe për nga mënyra sesi e trajton politikën. Në fakt në këtë grup as nuk bëhet fjalë për të pasur dikë me një projekt të vetin, por me sa duket as ambicja për të qenë pjesë e një programi të dikujt tjetër nuk është aq e fortë. Ka subjekte që janë përgjigjur se po e mendojnë seriozisht rikthimin në profesionin e mëparshëm, me një lloj dorëzimi ndaj një fati që duket se është parashikuar tashmë në prag të nisjes së fushatës zgjedhore. Pra për herë të parë kemi të bëjmë me një shprehje të sinqertë pasigurie në atë terren që është larg skemave klasike dhe luhatet në një improvizim që prej 20 vitesh është bërë skenë e debutimeve shpesh edhe shumë të pasuksesshme të profesionistëve të zotë në fushat e tyre sic është edhe rasti i Karrapicit, i cili jep konsiderata shumë të përcipta. Fraza shabllon dhe mendime të fragmentarizuara karakterizojnë intervistën e këtij grupi që duket pak i stërvitur me ambientin politikbërës.

Vlen për t'u përmendur shumëllojshmëria e profesioneve fillestare, poetë, regjizorë, inxhinjerë që katapultohen në politikë pa ndonjë meritë të veçantë në këtë fushë. Për rrjedhojë edhe programi narrativ i tyre do jetë i çalë, ata nuk kanë një ambicje të fortë për t'ia përcjellë atë publikut pasi nuk ndiejnë të kenë bërë investime në këtë fushë. Në ndryshim nga subjekti i analizuar në grupin e parë të politikanëve, por edhe nga grupi i dytë, grupi i tretë i subjekteve që kemi në shqyrtim nuk flet jo vetëm për projekte, por gati gati ka humbur

⁹² Intervistë e Parid Teferiçit, shih Apendix-in

entuziasmin për të qenë edhe pjesë e një projekti të dikujt tjetër. Afër finishit të legjislaturës, ndihet një “ftohje” e tyre me politikën dhe me sa duket jo rastësiht asnjë prej tyre nuk është rizgjedhur në legjislaturën e re.

Fjalim më se i ekuilibruar ai i pari i Bishës në Parlament: *„Më vjen mirë që diskutimin tim të parë në këtë Parlament e nis me një përshëndetje dhe një urim për fillimin e vitit të ri shkollor universitar.*

Do të doja të uroja të gjithë studentët që janë ulur në auditoret e universiteteve dhe në veçanti do të doja të uroja ata studentë që janë ulur për herë të parë. Urime, përshëndetje dhe një vit të mbarë shkollor⁹³!” dhe në fakt nuk është kaq “paqësore” fjala e Tefriçit kur shprehet në fjalimi e tij të parë se:

“Që Shqipëria këto vite iu rikthye sërish atyre kohëve ku Hasan Zyko Kamberi u thurte lavde aftësive magjike të rushfetit dhe parasë, kjo pa dyshim është meritë e së ashtuquajturës e majta shqiptare. Ajo na risolli pranë ato vite primortiale, kur shteti shqiptar nuk ekzistonte akoma dhe vendimet merreshin nga një administratë e korruptuar dhe e dhjamur në periferinë e një perandorie në agoni. E majta vazhdon të përsëritë për justifikim po ato fjalë që përdorte Skënderbeu për lirinë, korrupsionin nuk ua solla unë. Në një sinkroni të çuditshme, kjo me disa media që sillnin para 3 korrikut “fakte”, se sa të korruptuar paskeshin qenë edhe etër të shtetit tonë si Noli me shokë⁹⁴.

Ndërkohë që retorika bëhet më neutrale me kalimin e viteve ndihet se ka një diferencë të ndjeshme në ligjërimin parlamentar të po të njëjtit subjekt:

“Në fillim desha të shpreh keqardhjen për mungesën e theksuar të vëmendjes nga ana e deputetëve të të dy kampeve gjatë seancës së kaluar dhe të sotmes. Çështja e Radiotelevizionit Publik nuk duhet të jetë një çështje që trajtohet me gjaknxehtësi, vetëm për konsum të jashtëm dhe vetëm në prag fushatash elektorale. Ky institucion ka nevojë për vëmendje konstante nga ana e Parlamentit dhe nuk duhet parë si e tepërt asnjë përpjekje jona për ta përmirësuar atë⁹⁵

⁹³ Fjala e Besnik Bishës në seancën plenarë të së enjtes, 13 tetor 2005

⁹⁴ Fjala e Parid Teferiçit në seancën plenare të së hënës, 14 nëntor 2005

⁹⁵ Fjalë e mbajtur në seancën plenare të ditës së hënë, datë 02.04.2007

Edhe në këtë grup vihet re një “polarizim” i modaliteteve. Në ndryshim nga grupi i parë, në skemën narrative të së cilit mbizotëronin modalitetet *di* dhe *mund*, programet narrative të subjekteve në grupin e tretë janë të dominuara nga modalitetet e virtualizuara që përthyjnë dëshira të subjekteve dhe një ndeysi obligimi ndaj publikut në propagandimin e gjërave që duhen bërë. Në këtë grup prania e modaliteteve të aktualizuara *di*, duhet është shumë më e zbehtë edhe në krahasim me grupin e dytë. Ajo çka bie në sy në këtë grup është prania e modeleve aktualë, që kushtëzojnë edhe rolin dhe deri praninë e subjektit në politikë. .

Këtu përmend rastin e Z.Sharku që rendit në modelet e tij Kryeministrin dhe Kryetaren e Parlamentit, modele që nuk argumentohen por thjesht përzgjidhen: *“Kryetari i Partisë është modeli nr 1 që merret referencë në të tilla raste, Zoti Berisha dhe unë do të vlerësoja Znj.Topalli si përfaqësuese të legjislativit.Ndërsa në politikën e huaj do të vlerësoja Finin.*

Pa dashur të instrumentalizoj këtë model, më duket interesant sesi në 10 intervistat e marra, ishte i vetmi subjekt që frymëzohet nga nga dy modele të veshur me pushtet në kohë reale.

Një rast interesant është edhe modeli Sokol Olldashi: *Më shumë sesa modele kam shembuj të miqve të mi, të cilët janë angazhuar në politikë që herët. Si rast mund të marr Sokol Olldashin, mik i hershëm i imi dhe ka qenë moshatar me mua, i apasionuar dikur pas letërsisë, ka shkruar poezi dhe më pas in përkushtua me sukses politikës. Për mua ai është modeli i politikanit të suksesshëm*⁹⁶

Subjekti e argumenton si një njëri të letrave që po ka sukses në politikë, mbase duke bërë një analogji edhe me veten duke qenë se të dy janë marrë me letërsi. Bie në sy një lloj partizanizmi në modele, sidomos në ato të sipërpërmendurat ndërkohë që një model tjetër është edhe ai i Gianfranco Fini-t⁹⁷, eksponent aktual kryesor i së djathtës italiane. Ky model nuk vjen i papritur dhe ka një lloj logjike duke konsideruar bindjet e tij të djathta dhe ndikimin që ka shteti fqinj Italia në Shqipëri, me modele jo vetëm në politikë, por edhe në

⁹⁶ Intervistë e Parid Teferiçit, shih Appendix-in

⁹⁷ Ish –kryetar i Alenaza Nazionale, tashmë eksponent i Popolo della Liberta

shumë fusha të tjera për vetë marrëdhëniet specifike midis dy vendeve. Këta subjekte kanë një lloj “rrudhje” dhe mungesë zhdërvjellësie në paraqitjen e programit të tyre narrativ, gjë që është pasqyruar edhe në fazën e performancës të tyre në lidhje me trasmetimin e programit dhe për rrjedhojë miratimi nga publiku nuk mund të ishte i suksesshëm. Gjithsesi do të isha e kujdesshme të dilja në konkluzionin se mungesa e tyre në legjislaturën aktuale është ekskluzivisht si pasojë e mos realizimit të programit narrativ prej nga buron edhe mungesa e miratimit nga publiku duke pranuar edhe ndikimin e ndryshimit të sistemit elektoral, tashmë ai është proporcional rajonal me lista të mbyllura që me fjalë të tjera iu jep fuqi të plotë kryetarëve të partive të caktojnë fatin e secilit prej kandidatëve.

Duke përfunduar këtë analizë dua të theksoj se ajo cka bie në sy është rritja e numrit të deputetëve të intervistuar në proporcion të zhdrejtë me rëndësinë e tyre në politikë duke sjellë këtu shembullin e numrit minimal të subjekteve të intervistuara në grupin e parë dhe numrin më të madh në grupin e tretë.

Një veçori tjetër është përputhja e realizimit të programit narrativ me progresin e tyre në politikë dhe këtu dua të veçoj diferencimin që bën analiza e fazës së kompetencës nëpërmjet identifikimit të modaliteteve dhe klasifikimit i të ligjërimit sipas dominimit të njërit prej tyre.

Në funksion të objektivave të komunikimit sugjerohet një lloj ligjërimi politik që të jetë i kuptueshëm dhe afër publikut dhe kjo bëhet edhe nëpërmjet përdorimit të dialekteve si shenjë e shkrirjes së akujve. Gjuhë e thjeshtë, e kuptueshme, me leksik të pastër e sintakse elastike që sintetizon ide sa më të thjeshta larg abstraktes janë tiparet e një ligjërimi popullor të kuptueshëm e natyror,⁹⁸ por që gjithsesi nuk e humbet përmbajtjen dhe elokuencën në përputhje me nivelin intelektual të subjektit.

⁹⁸ Marrone, Trupat shoqërore, 219-242

5.Përfundime

Nga ana metodologjike ky punim bazohet në zgjedhjen e një rasti studimor siç është shoqëria post komuniste shqiptare duke qenë se Shqipëria mund të konsiderohet një shembull unik ndër vendet e Evropës Lindore e Qëndrore që po hedh pas krahëve një tranzicioni të stërzgjatur e të mundimshmëm në shumë aspekte. Në fakt periudha 1990-2009 në vetvete nuk përbën një fenomen të pahasur dendur në vendet e tjera që janë karakterizuar nga probleme të ngjashme, por ajo çka i fal veçanti këtij procesi shpesh shqiptar në tipologji, është reflektimi në të i periudhës totalitare, periudhë që në gjykimin tim i shmanget skemave të regjimeve të tjera totalitare të vendeve që u gjetën pas Perdes së Hekurt. Hulumtimi i rolit të retorikës në ndërtimin e procesit të komunikimit mes politikës dhe publikut është thelbësor për të kuptuar dinamikën e kësaj marrëdhënie .Në ndihmë të këtij hulumtimi më kanë ardhur instrumente antropologjike siç janë intervistat, të cilat së bashku me fjalimet përbëjnë thelbin e analizës së kryer. Analiza e kryer vlen për të kuptuar më mirë të tërë procesin dhe sidomos lidhjet dhe marrëdhëniet e tij me klasën politike. Bëhet fjalë për një proces komunikimi të vendosur në një kuadër të ri si reflektim i marrëdhënieve të reja politiko -shoqërore të instalura mes medias dhe politikës.Ajo çka kam synuar që në fillim të këtij punimi është kryerja e analizës empirike, analizë kjo që u bazua në dy elementë kryesorë: në intervistat e marra dhe në fjalimet e grupit kampion të ligjvënësve të intervistuar. Vlerësoj se është e rëndësishme përzgjedhja e grupit kampion të të intervistuarve në një studim empirik dhe unë jam përpjekur të përftoj një të tillë sa më përfaqësues.

Për fat të keq më duhet të pranoj se përpos përpjekjeve, nuk mund të përfshij të tërë spektrin politik shqiptar me gjithë ndarjet e nëndarjet e tij dhe kompleksitetet që përfaqësojnë në grupin e të intervistuarve. Por unë jam udhëhequr nga parimi për të lundruar në mënyrë të balancuar sa majtas e aq djathtas, për të sjellë formulën e përfaqësimit gjinor në politikë, për

të mos mbetur peng e centralizimit të politikës në kryeqytet, por për të sjellë edhe refleksin sesi shihet politika shqiptare në pasqyrën e komunikimit në të gjithë territorin shqiptar.

Për këtë kam intervistuar ligjvënës nga jugu në veri, nga perëndimi në lindje duke u thelluar edhe në shtresa të ndryshme brenda politikës. Në këtë listë kam përfshirë nga politikanë të karrierës tek “profanët” e politikës duke gjeneruar hipoteza dhe i argumentuar ato, por duke rezervuar gjithmonë të drejtën për të mos përgjithësuar konkluzione të shtrira në hapësirë dhe në kohë si prerje tërthore e klasës politike shqiptare dhe kjo bëhet duke konsideruar numrin e këtyre intervistave.

Një nga tezat e shtjelluara gjatë këtij punimi është ajo se komunikimi dhe retorika në politikën shqiptare gjatë periudhës e tranzicionit 1990-2009 në Shqipëri nuk është zhvilluar ndryshe nga hallkat e tjera të shoqërisë shqiptare. Hap pas hapi kam tentuar të shpalos panoramë të gjerë të procesit të komunikimit në Shqipëri dhe të elementëve në të cilët bazohemi për ta ndërtuar atë. Teza kryesore ka lidhje me ndikimin e drejtpërdrejtë të retorikës në komunikim dhe të këtij të fundit në politikë duke marrë për bazë në analizën time një grup politikanësh të ndarë në tri rrafsh të ndryshme duke tentuar të zbuloj sa përfaqësues është ky komunikim dhe sa ndikon në zhvillimet politike përfshirë këtu edhe vetë fatin politik të subjekteve në fjalë. Unë nuk kam pretenduar të rindërtoj historinë e këtyre viteve përmes intervistave, por kam dashur të sjell dhe të parashtroj vizionin komunikues të politikës përmes tyre. Pra vlera e shtuar nuk qëndron në interpretimin tim, por në analizën e aktorëve të kohës pa të cilët ky komunikim do të ishte një rrugë vetëm më një drejtim.

Komunikimi nuk është një trup amorf që mund të transplantohet në politikën shqiptare i huazuar nga ndonjë strategji në gjuhë të huaj, ai është një proces shumë kompleks dhe i ndërlikuar, pasqyrues i pagabuar i një shoqërie dhe gjithë problematikës që ajo mbart.

Gjatë këtij punimi është kristalizuar teza se komunikimi dhe retorika në politikën shqiptare gjatë periudhës e tranzicionit 1990-2009 në Shqipëri nuk është zhvilluar ndryshe nga hallkat e tjera të shoqërisë shqiptare. Unë kam sjellë përmes analizës së situatës së komunikimit në Shqipëri një vështrim të përgjithshëm, vështrim ky që përfshin rolin e medias si pjesë sendërtuese të procesit të komunikimit në shoqërinë shqiptare pas viteve '90 duke u ndalur në tiparet e komunikimit.

Një kujdes i veçantë i kam kushtuar edhe analizës së funksioneve të medias në procesin e komunikimit duke u ndalur në llojet e komunikimit dhe marrëdhënien mes gjuhës dhe komunikimit. Nuk mund të mbetej jashtë kësaj analize edhe roli që luan feja dhe etnia si elementë të komunikimit në Shqipëri për tu ndalur në marrëdhënien komplekse mes medias dhe politikës. Analiza e impaktit mediatik në mënyrën sesi politikanët korrnizojnë pozicionet e tyre në marrëdhënie me publikun pas ndryshimeve politike të viteve '90 është e rëndësishme përderisa studimi i medias na ofron një mënyrë për të deshifruar dhe zbërthyer kuptimin e një shoqërie në kompleks.

Ky është një argument më shumë në mbështetje të tezës së paraqitur më sipër për rolin dhe rëndësinë e medias në procesin e sendërtimit të procesit të komunikimit, proces ky që ka llojet e veta dhe nuk paraqitet kurrë linear dhe kurrësesi nuk mund t'i bëj bisht e të mos ndikohet nga situata e përgjithshme politike, ekonomike dhe sociale që ka përjetuar Shqipëria që prej përmbykses së regjimit totalitar dhe hyrjes në një proces transformimi shumëplanësh.

Transformim ky që synon ndërtimin e institucioneve demokratike, aplikimin e ekonomisë së tregut dhe respektimin e shtetit ligjor ndërthurur me një mori ndryshimesh sociale të lidhura me transformimin e marrëdhënieve familjare edhe në raportin me moralin dhe fenë, elementë këta që nuk kanë kalaur pa lënë gjurmët e tyre.

Shqipëria e viteve 1991 do të përjetonte një ringjallje të mediave që aso kohe identifikoheshin me shtypin e shkruar dhe roli parësor dhe më thelbësori i medias në shoqërinë post komuniste ishte ai i shprehjes së lirë dhe pa autoçensurë dhe i dëgjimit të lajmeve nga më të larmishmet duke ngopur kështu një mungesë të kahershme duke i dhënë individit një dimension të ri, larg kolektivizmit të forcuar dhe duke ndjellë dëshirën për të përmbushur atë boshllëk me çdo lloj informacioni, të nevojshëm e të panevojshëm. Një funksion tjetër i rëndësishëm i medias së lirë që prej fillimeve të saj vlerësohet edhe ai i stabilizuesit të një raportit mes publikut dhe politikës në kuptimin e saj më të gjerë.

Në një vend të sapodalë nga një tunel i gjatë dhe i mundimshëm monopartiak, shtypi luan rolin e ndërmjetësit për të trasmetuar dhe qartësuar idetë e reja politike që perthitheshin nga shoqëria e etur shqiptare, e etur për ide të reja, për pluralitet mendimi larg klisheve bajate komuniste.

Së treti ia vlen të përmendet edhe roli i medias si një dritare me botën e përtej kufijve. E ngujuar në izolimin e saj absolut, shoqëria shqiptare e viteve '90 shfaqte simptomat e një pacienti klaustrofobik që nuk e nxë më hapësira që ka përreth dhe shfaq dëshirën për t'iu larguar mureve të qelqta të izolimit duke iu dorëzuar nevojës për të zbuluar botën, një mënyrë për të përmbushur në kohë dhe hapësirë atë çka kishin humbur në një gjysëm shekulli, një gjysëm shekulli jo pak i rëndësishëm për sa i përket zhvillimit të shkencës dhe teknologjisë. Por ana tjetër e medaljes e përballi dëshirën për të zbuluar horizonte të reja me rregullat burokratike që kishte vendosur pjesa tjetër e Evropës për t'i bërë ballë valës së prurjeve nga vendet ish-komuniste.

Në Shqipërinë post komuniste politika mund të analizohet si prodhim i medias dhe në këtë mbrurje të publikut një rol të rëndësishëm luan edhe retorika. Për këtë arsye është trajtuar edhe raporti mes retorikës dhe komunikimit, raport ky që është zbërthyer më tej në të gjithë

elementët e tij nga analiza e teksit që u krye në të tre grupet, në të cilat janë klasifikuar politikanët e intervistuar.

Duke qenë se kam dashur të zbërthej evolucionin e retorikës dhe si ka ndikuar ky ndryshim i retorikës në procesin e komunikimit dhe si pasojë edhe në karrierën politike të të intervistuarve, kam preferuar të zgjedh fjalime që datojnë fillimet e karrierës parlamentare për secilin dhe natyrisht edhe fjalime të mbajtuara në legjislaturën e fundit. Vihet re një lloj panorama e ndryshme pasi fillimet e karrierës politike datojnë në kohë të ndryshme për subjektet e përzgjedhura dhe natyrisht edhe kurbat e karrierës së tyre kanë kahje të ndryshme. Ajo çka vihet re është se kurba e karrierës nuk shkon në proporcion të drejtë me moshën apo vjetërsinë në politikë, përkundrazi

Bie në sy gjatë analizave se ka një ndryshim thelbësor në retorikën dhe si rrjedhim edhe në procesin e komunikimit dhe është kjo mënyrë e ndërtimit të ligjërit që bën dallimin mes politikanëve dhe peshës së tyre specifike në skenën politike. Në bazë të skemës narrative kanonike që kam përdorur për të analizuar tekstet në shqyrtim (intervistat dhe fjalimet në Parlament), kam konstatuar se në varësi të modalitetit të përdorur më shumë apo që dominon mbi të tjerët përcaktohet edhe lloji i ligjërit. Duke qenë se tek subjekti i grupit të politikanëve të rrangut të parë modaliteti dominues është ai i aktualizuar (*di, duhet*), edhe lloji i ligjërit do të determinohet prej tij. Këta elementë janë të pranishëm në intervistën dhe fjalët e Z.Blushi duke e bërë më të zbërthyeshme fazën e tretë të skemës narrative kanonike: performancën. Është tërësia e elementëve të sipërpërmendur, të cilë bëjnë dallimin në performancë duke e lidhur atë me fazën e fundit të skemës që është miratimi. Në bazë të skemës narrative kanonike dal në përfundimin se subjekti në fjalë e ka realizuar programin narrativ për t'u zgjedhur duke fituar edhe miratimin e publikut. Kjo është edhe arsyeja pse subjekti që prej përfshirjes në politikë ka qenë përherë i pranishëm me projektet e tij.

Ndërsa grupi i dytë përfshin fillimisht politikanë me një profil më të ulët politik, por gjithsesi aktivë në jetën politike në rrangje ministrash dhe ish- ministrash. Edhe subjektet e këtij grupi flasin me gjuhë thuajse të unifikuar në princip. Karakterizohen nga një lloj ligjërimi standart që ka si kryefjalë të tij intergrimin euro-atlantik, ligjërim ky që kushtëzon performancën e tyre duke marrë edhe miratimin e publikut. Edhe në këtë rast programi narrativ është i realizuar dhe subjektet janë aktiv në jetën politike, por gjithësesi si pjesë e projektit të dikujt tjetër pa spikatur elementë lidërshipi si në grupin e parë.

Ndërsa politikanët e grupit të tretë karakterizohen nga fakti që të gjithë deputetët e këtij grupi janë për herë të parë në Kuvendin e Shqipërisë dhe nuk janë rizgjedhur në legjislaturën vijuese. Një tipar tjetër që karakterizon shumicën e intervistave dhe diskutimet e tyre në Kuvend është partizanizmi dhe tifoja politike që bëjnë, një prirje që në shumicën e rasteve bazohet në fraza të fryra emfatike, që vënë në shënjestër kundërshtarin politik dhe karakterizohen nga një kahje e fortë politike dhe në disa rastë ka veprim “llustrues” e lajkatar ndaj liderit politik të partisë përkatëse.

Vlen për t’u përmendur shumëllojshmëria e profesioneve fillestare, poetë, regjizorë, inxhinjerë që katapultohen në politikë pa ndonjë meritë të vecantë në këtë fushë. Për rrjedhojë edhe programi narrativ i tyre do jetë i çalë, ata nuk kanë një ambicje të fortë për t’ia përcjellë publikut pasi nuk ndiejnë të kenë bërë investime në këtë fushë. Në ndryshim nga subjekti i analizuar në grupin e parë të politikanëve, por edhe nga grupi i dytë, grupi i tretë i subjekteve që kemi në shqyrtim nuk flet jo vetëm për projekte, por gati gati ka humbur entuziasmin për të qenë edhe pjesë e një projekti të dikujt tjetër. Afër finishit të legjislaturës, ndihet një “ftohje” e tyre me politikën dhe me sa duket jo rastësiht asnjë prej tyre nuk është rizgjedhur në legjislaturën e re.

Duke përfunduar këtë analizë dua të theksoj se ajo çka bie në sy është rritja e numrit të deputetëve të intervistuar në proporcion të zhdrejtë me rëndësinë e tyre në politikë duke sjellë këtu shembullin e numrit minimal të subjekteve të intervistuar në grupi të parë dhe numrin më të madh në grupin e tretë.

Ajo çka konkludoj është se retorika është e lidhur ngushtë me procesin e komunikimit dhe ky i fundit luan një rrol kyç në politikën shqiptare duke përcaktuar edhe (mos)suksesin e subjekteve të analizuar.

Pra nuk është rastësi përputhja e realizimit të programit narrativ me progresin e tyre në politikë dhe këtu dua të veçoj diferencimin që ben analiza e fazës së kompetencës nëpërmjet identifikimit të modaliteteve dhe klasifikimi i ligjërimit sipas dominimit të njërit prej tyre.

Gjithsesi në funksion të objektivave të komunikimit sugjerohet një lloj ligjërimit politik që të jetë i kuptueshëm dhe afër publikut dhe kjo bëhet edhe nëpërmjet përdorimit të dialekteve si shenjë e shkrirjes së akujve. Gjuhë e thjeshtë, e kuptueshme, me leksik të pastër e sintakse elastike që sintetizon ide sa më të thjeshta larg abstraktës si tipare të një ligjërimi të kuptueshëm dhe të pranueshëm, por që gjithsesi nuk e humbet përmbajtjen dhe elokuencën në përputhje me nivelin intelektual të subjektit.

6.Bibliografia

Artan Fuga, Les mots dans la communication politique en Albanie (L'Harmattan /Paris2003) 11.

Artan Fuga, Ikja nga kompleksi i Rozafës (Dukagjini Pejë/2001) 25.

Artan fuga, Majtas jo djathtas (Ora Botime Tiranë/2003) 217.

- Artan Fuga, Media, politika, shoqëria (Botime Dudaj Tiranë/2008) 10, 22-27.
- Artan Fuga, Rrota e Mundimit (Botime Dudaj Tiranë /2007) 9.
- Artan Fuga, Shoqëria periferike (Ora Botime Tiranë/2004) 352-355.
- Artan Fuga, Brirët e Dhisë (Ora Botime Tiranë /2008) 229, 219,435, 470-470, III, 431, 432-435.
- Artan Fuga, Shtigje drejt guvës së gjarprit (Ora Botime Tiranë /2001) 81.
- Carter McNamara, General guidelines for conducting interviews (Minnesota 1999) 10.
- Deanna Kuhn, The skills of the argument (Cambridge University Press /1991) 68-71.
- Edited -John Corner dhe Dick Pels, Media and the Restyling of politics: Consumerism, Celebrity and Cynicism W.Lance Bennet, Lifestyle Politics and Citizen Consumers: Identity, Communication and Political Action in Late Modern Society (Sage/ London 2003) 147.
- Edward P. J. Corbett, Robert J. Connors, Classical Rhetoric for Modern Student (4th ed. New York dhe Oxford: Oxford U. Press/1999) 264.
- Emmanuel Pedler, Sociologie de la Communication (Edition Berytand Dreytuss, Nathan/VUEF 2002) 55.
- Jane Ritchie dhe Jane Lewis, Qualitative Research Practice (Sage/London 2003) 37.
- Jean Gabszewicz, Natalie Sonnac, L'industrie des medias (Edition La Decouverte/ Paris 2006) 33-45.
- Jimmie Killingsworth, M. Appeals in Modern Rethoric (Southern Illinois University Press /2005) 1.
- John Keane, J: The Media and Democracy (Polity Press and Blackëell Publishers Ltd 1991) 120.
- Julia T.Wood, Interpersonal Communication (Wadsworth /Boston 2007) 153.
- Marshall McLuhan, Quentin Fiore, The Medium is the Message (Penguin Books London/1967) 8-15.
- Gianfranco Marrone: Trupat shoqërorë (Universiteti Marin Barleti Press Tiranë 2008) 223-227, 219-242.
- Paolo Giovannetti, Retorica dei Media (Edizioni Unicopli /Milano 2004) 171.

Paul Watzlawick, La realite' de la realite': confision, disinformation, communication (Editions du Seuil/Paris 1978) 198.

Pertti J. Peltto, Gretel H. Peltto, Anthropological Research. The structure of inquiry (Cambridge University Press/ 1978) 251-254.

Maria Pia Pozzato: Semiotika e tekstit (UET Press 2008) 41-48.

Richard A. Cherwitz, James w. Hikin, Communication and Knowledge: An Investigation in Rhetorical Epistemology (University of South Carolina Press 1st edition/ 1986)

Roberto Grandi, Cristian Vaccari, Elementi della comunicazione politica (Carocci/ Roma 2007) 65.

Richard A. Krueger, Moderating focus groups (Thousand Oaks, CA /1998) 118.

Roland Barthes, Aventura Semiologjike (Dukagjini /Pejë 2008) 325.

Steinar Kvale, Interviews: A Introduction to Qualitative research Interviewing (Sage Publications, Thousand Oaks California/ 1996) 32.

Strauss Hollstein, Qualitative Netzwerkanalyse. Konzepte, Methoden, Anwendungen, (GWV Fachverlage GmbH /Wiesbaden 2006) 340.

Tom Wengraf, Qualitative Research Interviewing. Biographic Narratives and Semi-structured Methods (Sage: London/2001) 181.

Thomas Meyer, Lew Hinchman, Media Democracy: How media colonize politics (Cambridge Polity Press/2002) I, XVI.

Wayne Booth, The rhetoric of Rhetoric. A Quest of Effective communication (Blackwell Publishing/ Oxford 2004) 44-46.

Punimet të senacave Parlamentare

Set intervistash të marrë prej meje grupit të politikanëve të përzgjedhur

<http://www.top-channel.tv/rrethnesh.php>

http://www.facebook.com/note.php?note_id=62271892053

1

http://ps.al/index.php?option=com_content&task=view&id=2314&Itemid=74

<http://www.keshilliministrave.al/index.php?fq=brenda&m=neës&lid=9529>

<http://www.keshilliministrave.al/index.php?fq=brenda&m=neës&lid=11164>

<http://www.keshilliministrave.al/index.php?fq=brenda&m=neës&lid=11084>
 Situata makroekonomike dhe buxhetore për periudhën 2008-2009
<http://www.minfin.gov.al/>
 Beqja: Situatën e vështirë ekonomike të vendit nuk do ta përmirësoj as ndryshimi në buxhetin e 2009
http://ps.al/index.php?option=com_content&task=view&id=2540&Itemid=161
 Fjala e Presidentit Topi në mbledhjen e radhës së Këshillit të Lartë të Drejtësisë
<http://www.president.al/shqip/info.asp?id=5102>
 Fjala e Ilir Metës mbajtur në Shkodër 03.03.2009 <http://www.24-ore.com/mobile/politika/2720.html>
<http://www.youtube.com/watch?v=fD7LZcbI-D8>
 Programi i qeverisë :<http://www.mfa.gov.al/shqip/programi.asp>
 Raporti I Qendres Shqiptare per Monitorimin e Medias (QSHMM) 25 shtator 2006
http://www.fes.org.al/al/ProjectsAndPartners/CivilSocietyAndMedia/2006/shtator/Rap_Med.html
http://www.freedomhouse.org/uploads/fop/2009/FreedomofthePress2009_tables.pdf
 Deklaratë për shtyp e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (01.08.2009)
<http://www.cec.org.al/2004/veprimtaria/2009/Gusht.htm>

7. Apendix

Aldo Bumçi

1. Cilat forma përdorni për të komunikuar me publikun?

Kontaktet që vendos si deputet i zonës me njerëzit, kjo nuk mendoj se është një formë shumë e sofistikuar se kontaktet nuk bëhen me grupe shumë të mëdhaja, bëhen me grupe individësh që janë edhe brenda partisë. Një mundësi tjetër është edhe media. Media qendrore që vendos komunikim jo vetëm të deputetit të zonës, por edhe të të gjithë qeverisë në gjithë Shqipërinë. Atje ku jam unë ka një media lokale, kur kemi inaugurime, një shkollë një rrugë e re, aty mund të flitet dikë më shumë, aty ftohem nga televizioni lokal. Nuk janë shumë të sofistikuar gjithsesi format e komunikimit, nuk ka një axhendë të mirëpërcaktuar p.sh. çdo 6 muaj unë do të bëj këtë gjë apo atë tjetrën....

2. çfarë roli luan Parlamenti në jetën e vendit tuaj dhe në gjykimin tuaj çfarë roli duhet të luajë?

Parlamenti është institucioni kyç për një Republikë Parlamentare dhe jo vetëm në Shqipëri, por në çdo Republikë Parlamentare shumica që është qeveria është edhe shumica në Parlament, pra nuk është fort e lehtë të ndahen shumicat parlamentare nga ajo e ekzekutivit. Nuk është si në rastin e Amerikës që mund të qëllojë që njëra parti drejton ekzekutivin, por partia tjetër mund të ketë shumicën në Kongres apo në Senat. Parlamenti për sa i takon shumicës ndjek vullnetin e Qeverisë, por ka dhe raste kur ke qeveri koalicioni dhe nuk është e lehtë që çdo anëtar koalicioni të ndjekë këtë vullnet. Jeta politike zhvillohet në Parlament dhe puna e tij ndiqet nga populli. Gjithcka që thuhet në parlament të hënën dhe të enjten pasqyrohet në media vizive dhe e shkruar duke pasqyruar debatin. Reformat kalojnë aty, çdo ligj kalon në Parlament, nuk është i vetmi forum, patjetër por mbetet një nga forumet më të rëndësishme në këtë vënd. Reformat hartohen në qeveri, kur vijnë ke detyrën që ti kalosh, mund të bësh ndryshime, por jo shumë të mëdhaja, shumica e projektligjeve vijnë nga Qeveria, më pak nga grupi parlamentar. Për çështje të rëndësishme siç është ajo e të

përndjekurve politike që kanë pasur ndjeshmëri, ka pas ndërhyrje edhe nga grupi parlamentar.

3.A keni ju një model në politikë?

Jo, nuk kam asnjë model, në politikë kam të vështirë të kem një model, njeriu çdo moment ka një përgjegjësi, ka një sërë detyrash për të bërë. Unë si deputet kam një sërë detyrash, edhe nëse ke funksion partiak ke një sërë detyrash. Politika nuk është çështje formulash që ti bën, një dy tre... Mendoj që çdo njeri duhet të reagojë ndaj atyre që ka si detyra, pastaj si e bën është mënyra e tij individuale.

4.Sa i rëndësishëm është për ju referimi ndaj ideologjive në politikë?

Roli i ideologjisë është shumë i rëndësishëm. P.sh. unë nuk do të isha futur në Partinë Demokratike nëse nuk do ta shikoja atë si përfaqësuese të disa vlerave. A është PD-ja përfaqësuese ideale e këtyre vlerave? Jo, nuk mund të jetë sepse si një parti e madhe duhet të përfaqësojë një grup më të gjerë shoqëror, jo vetëm të përndjekurit apo të shpronsuarit. Ky element identiteti siç janë të përndjekurit apo të shpronsuarit duhet të jetë i patjetërsueshëm. dhe kjo ka qenë arsyeja që unë jam futur në këtë forcë politike. Elementi i identitetit si forcë antikomuniste që duhet të riktheje identitetin e një Shqipërie para periudhës së komunizmit për mua janë është të rëndësishme. Nëse këto nuk ekzistojnë (se kjo ka të bëjë edhe me kompromisin që bën njeriu me veten), atëherë kjo forcë nuk do të ishte më ajo që unë mendoj.

Pastaj mund të hymë në debat në periudha tranzicioni, por mendoj që çdo qeveri ka programe 4 vjeçare dhe ka çështje që s'kanë të bëjnë me deputetin, të tipit teknik siç do ishin kanalet në Lezhë kundër përmbytjeve, kjo s'ka të bëjë fare me identitetin. Këto janë xhaketa, ti duhet të veshësh një xhakete për t'u futur në BE me reformat që do kryehen për t'ia arritur qëllimit.

5. A i përgatisni ju fjalimet paraprakisht apo improvizoni?

Unë i përgatis, përherë, pastaj niveli i fjalimit është çështje tjetër, por unë i përgatis sepse fjala kërkohet paraprakisht, nuk mund të merret në moment. Janë 2 momentet kur flitet në Parlament: momenti 60 minutësh kur deputeti ngre tema që ai mendon se janë të rëndësishme për vendin dhe aty nuk ka kufizime, deputeti mund të ngreje çdo temë që ai dëshiron, ka edhe një moment tjetër kur diskutohet projekt-ligji dhe diskuton për të. Debati bëhet më shumë në komisione, po kryesisht është qeveria dhe ministrant e ndryshëm që diskutojnë, por edhe opozita mund ta nxisi debatin. Një çështje që nxit debatin është edhe buxheti, ku ne si deputetë flasim për zonën tonë.

6. Si e konsideroni profesionin tuaj si politikan?

7. çfarë roli luan multimedia në komunikimin tuaj me publikun? Blogosferat, Facebook, Twitter?

Nuk përdor asnjë nga këto, unë vetë nuk i zotëroj shumë. Por edhe elektorati në zonë rurale nuk ka këto mjete komunikimi. Përdor shumë sms-të sidomos në raste festash, në Krishtlindje, Pashkë apo Vit të Ri për t'f'uuar.

8. çfarë gjuhe përdorni ju, gjuhë letrare apo dialekt?

Unë nuk përdor dialekt. Unë jam me origjinë nga Veriu, por kam lindur në Tiranë. Në shtëpinë time , babai, nëna kanë folur gegërisht, shkodrançe, por shumë e zbutur se edhe babi ka lindur në Tiranë. Unë e kam familjare, por nuk e përdor shumë se edhe ndryshimet nuk janë të mëdha. Përdorimi i dialektit mund të jetë një debat shumë i gjerë dhe prania e shumë dialekteve tregon që jemi popull shumë konservator. Gjithsesi duhet përshtatur me dialektin duke folur gjuhën letrare.

9.Si e përfytyroni Shqipërinë pas 30 viteve dhe si mund të arrihet aty?

E kam vështirë të flas pas 30 vitesh...periudhë shumë e gjatë kohe...Nato është një gjë e kryer , BE do të ndodhi shumë më shpejt. Një çështje që duhet të gjejë zgjidhje është çështja e pronës, do eci pak..jo shumë shpejt, për të mos thënë ngadalë.. çështja e rregullimit të territorit , pastrimit të tij dhe sistemit të ndërtimeve, mund të gjejë zgjidhje dhe jo shumë shpejt. Nuk do ketë më ndjesi të zonave të harruara, pas 30 vitesh do të ketë një linjë elektrike të qëndrueshme, rrugë rurale dhe çdo komunitet do jetë i lidhur me telefon, me rrugën , do ketë furnizim me uje dhe energji elektrike.Vendi do jetë më i pashëm, më i bukur për t'u parë dhe do të ndërgjegjësohemi për të mos ndotur e hedhur plehrat këtej andej, në breg të lumit etj.

Kjo do të arrihet me penalizime të forta për njerëzit që shkelin ligjin.

Hapësirë komunikimi konkrete në Ballkan, s'ka rëndësi kufijtë , mund të jenë këta të sotmit. Do të ketë një hapësirë të komunikimit mbarëshqiptar, qoftë në media , në kulturë, biznes e infrastrukturë...do të jetë një hapësirë mbarëshqipëtare.

Besnik Bisha

1. Cilat forma përdorni për të komunikuar me publikun?

Dy janë mënyrat me anë të së cilave komunikoj me publikun: media qoftë nëpërmjet sallës së Parlamentit ose nëpërmjet konferencave të shtypit dhe së dyti me anë të kontakteve me strukturat e Partisë.

2. çfarë roli luan parlamenti në jetën e vendit tuaj dhe në gjykimin tuaj çfarë roli duhet të luajë?

Parlamenti ekziston edhe si një sistem referimi. Në gjykimin tim ai duhet të përmirësojë funksionimin e tij nga ai aktual dhe të eci drejt vetëpërmirësimit bashkë me pushtetet e tjera.

3.A keni ju një model në politikë?

Modeli im në politikë është o politikanit që lufton për të bërë mirë, kjo është motoja ime.

4. Sa i rëndësishëm është për ju referimi ndaj ideologjive në politikë?

Ideologjitë janë të rëndësishme dhe klasa politike shqiptare e ka kuptuar këtë rëndësi kështu që mendoj se jemi në rrugë e sipër për t'i rigrupuar ato sepse ne kemi një spektër politik të ngatërruar.

5. A i përgatisni ju fjalimet paraprakisht apo improvizoni?

Varet. Kam gjithmonë pika mbështetëse tek të cilat bazoj diskutimet e mia, por ka raste që i përgatis fjalimet më përpara.

6. Si e konsideroni profesionin tuaj si politikan?

Duke qenë se jam regjizor, politika nuk ka qenë profesioni im primar. Mendoj se si çdo profesion kërkon eksperiencë dhe kualifikime dhe tashmë po filloj ta ndjej se po futem në optikën e të qenit i tillë.

7. çfarë roli luan multimedia në komunikimin tuaj me publikun? Blogosferat, Facebook, Twitter?

.Në Shqipëri përdoren pak për arsye që i dime dhe që varen më shumë më anën infrastrukturore të komunikimit.

8. çfarë gjuhe përdorni ju, gjuhë letrare apo dialekt?

Unë përdor gjuhë letrare, por në fakt dialektet janë të rëndësishme se shkrijnë shumë akuj.

9. Si e përfytyroni Shqipërinë pas 30 viteve dhe si mund të arrihet aty?

Gjëja e parë që më vjen ndërmend është se do të jetë shumë më mirë seç është tani. Shqipëria po lë pas një periudhë 18 vjeçare tranzicioni gjatë së cilit kanë ndodhur ndryshime. Tashmë jemi një vend anëtar me të drejta të plota në NATO dhe kemi firmosur marrëveshjen e Stabilizim Asocimit me BE(MSA) duke i hapur kështu rrugën për aplikim në këtë strukturë kaq të rëndësishme.

Mendoj që jemi në udhë të mbarë duke besuar fort në zhvillimin e vetvetes, vetëkorrigjimin dhe padyshim duke u mbështetur tek partnerët tanë ndërkombëtarë.

Gezim Karapici

1. Cilat forma përdorni për të komunikuar me publikun?

E-maile, celular , por preferoj kontaktet direkte.

2. çfare roli luan Parlamenti në jetën e vendit tuaj dhe në gjykimin tuaj çfare roli duhet te luajë?

Parlamenti, konform kushtetutës, është vendi ku bëhen ligje të cilat reformojnë shoqërinë. Në kuptimin e ndarjes së pushteteve nuk mendoj se duhet të ketë rol tjetër kaq të rëndësishëm. Megjithatë, në kuadrin e komisioneve parlamentare, mund të promovohen politika bashkëpunimi e promovimi të çështjes shqiptare në parlamentet e vendeve miq.

3. A keni ju nje model ne politikë?

Modeli më i mirë është të jesh vetvetja dhe i ndershem me shoqërinë dhe elektoratin.

4. Sa i rendesishem eshte per ju referimi ndaj ideologjive ne politike?

Referimi ndaj ideologjive të caktuara të çon dhe në kufizime të mendimit, natyrisht ato duhen marrë në konsideratë dhe studjuar por jo të merren si dogma për tu zbatuar.

5. A i pergatisni ju fjalimet paraprakisht apo improvizoni?

Në shumicën e rasteve i përgatis paraprakisht, se më duket se kështu mendimet dalin më të pjekura. Improvizimet mund të jenë joshëse në fillim, por pasi kalon euforia e parë, në shumicën e rasteve ato mund të rezultojnë jo shumë frutëdhënëse.

6. Si e konsideroni profesionin tuaj si politikan?

Interesant, por do të ishte më mirë të mos konsiderohej profesion, por si një veprimtari paralele.

7. Cfare roli luan multimedia ne komunikimin tuaj me publikun? Blogosferat, Facebook, Twitter?

Nuk i preferoj, preferoj kontaktet njerzore.

8. çfare gjuhe perdorni ju, gjuhe letrare apo dialekt?

Natyrisht gjuhën zyrtare

9. Si e perfytyroni Shqiperine pas 30 viteve dhe si mund te arrihet aty?

Shumë herë më të mirë se e sotmja. Do t'isha i lumtur t'i ngjante vendeve nordike. Rëndësi ka që çdo ditë e çdo orë të punohet me ndershmëri në drejtim të progresit në çdo fushë të jetës.

Pëllumb Xhufi

1. Cilat forma përdorni për të komunikuar me publikun?

Më efektive natyrisht është media, arrin në të gjitha rrethet e vendit, në të gjitha shtresat e popullsisë, madje arrin edhe përtej kufijve të vendit dhe kjo është një formë që përdoret pavarësisht se mediat janë të kontrolluara këtu dhe nuk janë plotësisht të lira. Formë tjetër është ajo nëpërmjet kontakteve dhe ne jemi parti e terrenit (LSI) duke qenë parti e re, fituam këtë instiktin e vajtes në bazë për të ndërtuar struktura të partisë dhe kjo na ka sjellë natyrisht edhe përvoja të reja, kontakte me njerëzit, njohjen me problematikën lokale të vendit dhe trajtimin e tyre. Forma e tretë është prapë nëpërmjet mediave, unë personalisht duke qenë se më vjen diçka dorësh botoj edhe në gazetatat e mëdha përveç se në gazetën e partisë për problematikë të ndryshme, të cilat jo domosdoshmërisht lidhen me probleme të partisë, mund të lidhen edhe me probleme të përgjithshme që kanë të bëjnë me kulturën, me artin, me shkencën dhe çështjen kombëtare dhe këto krijojnë një rezonancë në publik dhe ndihmojnë një politikan për të krijuar një profil sa më të plotë.

2. çfarë roli luan Parlamenti në jetën e vendit tuaj dhe në gjykimin tuaj çfarë roli duhet të luajë?

Parlamenti nuk ka rolin që duhet të kishte, është një aparencë në një masë të mirë, sepse deputet megjithëse janë aty për të përfaqësuar interesat e elektoratit që i ka zgjedhur fatkeqësisht drejtohen nga disiplina e Partisë. Kështu që ndodh shpesh që në votimin e ligjeve , marrëveshjeve të ndryshme për të cilat një deputet ka një mendim të tijin, duke qenë se bën pjesë në një grup parlamentar dhe i përket një partie të caktuar , ai voton symbyllurazi dhe kjo ndodh për fat të keq shumë shumë shpesh. Është ngjarje e jashtëzakonshme që të shohesh një deputet të mazhorancës të votojë kundër një projektligji të cilin e voton me shumicë gjithë spektri o tij politik.

Roli i Parlamentit duhet të jetë i fiksuar mirë në Kushtetutë. Me ndryshimet që u bënë para një viti (në Kushtetutë) roli i tij u reduktua në raport me institucionet e tjera. Ka një uzurpim të roleve , p.sh.Kryetari i Parlamentit që është një i parë ndër të barabartët, një shprehës i dhe mbrojtës i interesave të deputetëve, është një moderator në seancat por që nuk ka asnjë tagër për të shprehur qëndrime politike në emër të Parlamentit , por kjo ndodh rëndom. Kryetarja aktuale e Parlamentit ka krijuar konflikte me institucione të tjera si me Prokurorinë duke uzupuar vullnetin e Parlamentit. Ka ndërhyre duke shkruar letra të ashpra ndaj Prokurores së Përgjithshme, ndaj Gjykatave duke u hequr si shprehëse e vullnetit të Parlamentit dhe e tillë nuk është, ajo është thjesht një spikere, një moderatore dhe një përcjellëse, thjesht përcjellëse e vullnetit të Parlamentit, një depozitare e vullnetit të tij. Pra edhe këtu ka një deformim të rolit të institucionit të kryetarit të parlamentit që është një nga difektet e mëdha dhe mungesa demokratike që ka për fat të keq klasa politike shqiptare. Një tjetër qëndrim i padrejtë është ai që deputetët shpeshherë i nënshtrohen presioneve, deputetët e opozitës i nënshtrohen presioneve të gjithëanëshme që janë politike dhe

ekonomike duke iu hequr pagën, duke iu shkurtuar pagën apo duke iu hequr të drejta të tjera që iu jep ligji. P.sh.me një vendim të absurd Këshillit të Ministrave , deputetër që kanë tituj shkencorë, profesorë, doktorë që si çdo nënpunës tjetër i administratës publike duhet të marrin një kuotë respektive, deputetëve kjo u është hequr, në një kohë që këtë e marrin nënpunës të Parlamentit që kanë tituj shkencorë dhe nuk e merr deputeti. Ky është një mesazh shumë negativ se thotë që na duhen deputetë injorantë, se ky është kuptimi: në vend që të stimulohet hyrja e deputetëve me nivel të lartë kulturor dhe shkencor, përkundrazi penalizohen ata duke i demotivuar edhe në këtë aspekt. Edhe presione politike që deputetët i nënshtrohen vazhdimisht: diskriminimeve p.sh në përbërjen dhe kompozimin e delegacioneve dhe psh përjashtohen deputetët nga delegacionet pranë Këshillit të Evropës, BE-së, NATO-s dhe favorizohen deputetë të caktuar të cilët si të thuash i bëjnë fresk mazhorancës apo Kryetares së Parlamentit.Pra ka qëndrime të tilla që bien ndesh me ligjin edhe me rregulloren e Parlamentit, por edhe me etikën dhe moralin e Parlamentarit.

3.A keni ju një model në politikë?

Unë model politik nuk kam një, se i përkas një brezi që është zhveshur nga kulti i idhujve duke qenë se kam jetuar periudhën para viteve '90 dhe si të thuash gjithë ajo klasë politike ishte plot klishe që u mbollën para viteve '90 dhe u shëmbën e u shkërmoqën dhe natyrisht bashkë me sistemin u shkërmoq edhe modeli politik, nuk mund të gjeshe një model politik. Megjithatë unë kam jashtëzakonisht admirim dhe mundohem të mësoj nga burra të politikës dhe të shtetit shqiptar të së shkuarës të cilët kanë dhënë shumë, psh për mua Fan Noli është një idhull jo vetëm në kuptimin e aktivitetit të tij politik dhe shoqëror, por edhe atij shkencor dhe kulturor, Sami Frashëri e Abdyl Frashëri janë modele për këmbënguljen dhe pathosin me të cilin luftuan për të ideuar shtetin shqiptar, si do ishte shteti shqiptar dhe Ismail Qemali

natyrisht duke bërë një vështrim kritik si të thuash jo vetëm për Ismailin , por edhe për të gjithë personazhet që unë përmenda dhe duke marrët pozitive racionale që ata kanë pasur.

4.Sa i rëndësishëm është për ju referimi ndaj ideologjive në politikë?

Tashmë ideologjitë kanë rënë, në kohën tonë. Unë gjykoj që ka një rënie të ideologjive pas rënies së murit të Berlinit, konvergjent tashmë për të gjitha vendet të paktët të rajonit tone dhe kontinentit tonë, vende që kanë një aspiratë integrimi në BE dhe NATO.Ky proces imponon rregulla të ngjashme për të gjitha vendet përtej ideologjive dhe sisteme që bazohen në tri gjëra esenciale: në njohjen e të drejtave të njeriut dhe demokracisë, lirisë së tregut nga ana tjetër dhe të shtetit ligjor.Këto janë tri pilastrat mbi të cilat ngrihen demokracitë moderne dhe këto janë tri rekuizite për të gjitha shtetet përfshirë edhe Shqipërinë edhe përderisa edhe ne kemi si prioritet integrimin në Evropë , natyrisht pranojmë këto koncepte që asgjesojnë pozicionimet ideologjike.Në këtë aspekt them që sot edhe në vendet përfundimtare me demokraci të zhvilluar kemi parë që partitë me një të kalaur historike të madhe tashmë ose janë reduktuar, ose janë minimizuar dhe sot lufta bëhet në planin e ofertave dhe programeve që ofron një parti për të përballuar programet e zhvillimit dhe të zgjidhjes së problemeve të njerëzve.Në këtë këndvështrim partitë e sotme janë gjithnjë e më pak ideologjike , dhe gjithnjë e më shumë parti të ditës , të së përditshmes që orientohen nga problematika që lindin probleme të mëdha sic është ai i ambientit. Ambienti është sot pjesë e programeve të të gjitha partive politike dhe nuk ka ekzistuar dikur.Megjithatë unë mendoj se ekzistojnë disa piketa në historinë e një kombi të cilave i referohen partitë politike si masë për pozicionimin e tyre në të majtë dhe në të djathtë pikërisht sepse ka zgjedhur disa referenca të caktuara historike të caktuara që lidhen me njerëzit apo shtresat shoqërore që tërheqin këtë parti apo atë parti. Kështu p.sh. një parti e majtë nuk mund të heqë dorë nga referenca të tilla historike sic janë luftat për liri, Rindja Kombëtare, Shteti Shqipëtar, LNC ashtu si një parti e djathtë

ka referenca si nga këto që thashe si psh Rilindja Kombëtare por edhe të tjera dhe personazhe dhe personalitete historike të cilat mbahen si emblema të së djathtës.

5. A i përgatisni ju fjalimet paraprakisht apo improvizoni?

I përgatis kur bëhet fjalë për çështje të anoncuara më parë dhe që kërkojnë analizë të hollësishme dhe jam spontan në debatet që lindin gjatë diskutimeve.

6. Si e konsideroni profesionin tuaj si politikan?

Po përsëris një definicion, është një shërbinm në favor të qytetarëve, të paktën kështu e kam kuptuar unë pozicionin tim kur kam hyrë në politikë, për të dhënë kontribut. Hyra për pak dhe për të qenë kalimtar dhe më ka zënë këmbët politika dhe vazhdoj ta kryej këtë punë natyrisht me përkushtim dhe dëshirë për të dhënë kontribut dhe për të lënë një emër të mirë në fund të fundit dhe jo për të realizuar qëllime e interesa personale të mia apo të familjes sime siç ndodh për fat të keq ndonjëherë në politikë.

7. çfarë roli luan multimedia në komunikimin tuaj me publikun? Blogosferat, Facebook, Twitter?

Në Shqipëri janë me kapacitet të kufizuar për vetë kushtet që në kemi, unë vetë jam një nga ata. Lundroj në internet mjaft mirë, punoj shumë mirë së kam shtypur shumë gjatë jetës sime, përdor teknikat që janë bërë elementare sic janë email, tek Fb akoma nuk kam hyre dhe nuk kam ndonjë dëshirë të shkoj të thellohem në ato mundësitë e pafundta të internetit. Më duken mjete shumë interesante për të komunikuar me një lloj publiku sic është ai i ri, por he për he me këto lloj teknikash hyn, po jo kudo. Ndikojnë edhe mungesat e karakterit teknik të ofertës që nuk të kënaqin, jo dritat jo niveli në provincë, sa më shumë larg Tiranës të shkosh , aq më e vështirë bëhet një gjë e tillë, por thashë është shumë e rëndësishme sidomos për një popull si ai shqiptar që gjysma jeton jashtë kufijve dhe natyrisht shqiptarët e emigracionit

janë ata që janë introdiktuar më mirë në këto teknikat e komunikimit me ata dhe ne e përdorim shumë , këtë lloj komunikimi në distancë.

8. çfarë gjuhe përdorni ju, gjuhë letrare apo dialekt?

Unë përdor gjuhë letrare pavarësisht se jam lindur e rritur në Tiranë, tani po kuroj një lagje të Tiranës që është me tiranas autoktonë dhe në mënyrë spontane të vjen të komunikosh dhe ta përshtatësh, e bën dhe ndonjëherë edhe me shejtanllëk por e di se njerëzve iu pëlqen një gjë e tille, po edhe mua më pëlqen të kthehem në vitet e rinise kur të gjithë flisnim tirançe tirançe dhe kjo ndodh, kurse kur shkoj në Jug e kam fare të natyrshme të flas dialektin e Jugut madje të hyj edhe në stërhollime të dialektit jugor se kam një formim edhe prej gjuhëtari përveç se historiani dhe kjo mirëpritet edhe nga njerëzit. Këto janë delikatesa që kanë rëndësinë e tyre.

Na e ka mësuar shoku Enver (qesh)..ai kur shkonte në Tropojë p.sh që bënte një herë në gjithë jetën bëri një vizitë, mësoi dicka një legjendë nga folklori I vendit, ose një varg dhe kshu ka ndodhur dhe gjeja e parë që bënte ishte të citonte këtë varg dhe krijonte impaktin e parë , afrimin për të vazhduar më tej bisedat. Është teknikë e vjetër që shkon përtej të majtës dhe të djathtës dhe ideologjive , por është fare e natyrshme. Kur takon njerëz duhet të tjetërsohesh në kuptimin pozitiv dhe të harrosh nga vjen e kush je dhe të hysh në botën e tyre nëse do të ndërtohet një komunikim sa më të hapur për t'ju kërkuar votën, duke qenë shumë më dhënësi ti sesa të tjerët.

9. Si e përfytyroni Shqipërinë pas 30 viteve dhe si mund të arrihet aty?

Shiko...mbas 30 vjetësh nëse do jetoj se s'jam fort I ri.....progresi do të bëjë të vetën, Shqipëria do të jetë vend anëtar I BE-së, shumë gjera nga këto që na irritojnë dhe na stresojnë sot do rregullohen: psh. zhurmat , makiant që I bien burive, më falni pështymat që mbulojnë rrugët që tregojnë për një barbarizim të Tiranës në raport me Tiranën që unë kam

jetuar si fëmijë. Atëherë nuk lejohej të hidhje letra përtokë, fëmijët të kapnin për mënge dhe të kallzonin..këto gjëra jam i bindur se qytetërimi do të bëjë të vetën, zhvillimi do bëjë të vetën, do te zhduken.

Vështirë ama që të rregullohen disa gjynahe që ka bërë politika e këtyre viteve , edhe ajo e para viteve '90 dhe pas viteve '90....Edhe pas 30 viteve do të kemi ndërtesa të shëmtuara, impiantë të cilat do të kthehen në impiante të rrezikshëm si hidrocentralet që do amortizohen, duke mbajtur parasysh edhe mirëmbajtjen jo të mirë që iu bëhen dhe do shndërrohen në rreziqe potenciale për popullsinë.

Shpresoj që fushat do të lulëzohen, popullsia do ti rikthehet fshatit, do të ngrihet një kult I natyrës që nuk ekziston sot. Në Tiranë vështirë të ndryshojnë gjërat për mirë se hapsirat janë zënë, por jam i bindur se në fushë e mal,a ty ku popullsia ka ikur, ose qëndron po jeton në mënyrë rentiere pa punaur tokën do të kemi një brez të ri , cili do jetë saturuar me jetën që karakterizohet nga një anë nga papaunësia, nga ana tjetër nga vrasja e kohës kot nëpër klube e pabe dhe do jetë një brez më i përgjegjshëm, më serioz, më i përgatitur dhe s'do kemi këtë klasë politike diletante kështu që politika do çlirohet edhe nga mbeturinat e para '90 po edhe nga ne nga politikanët diletantë që kemi hyrë në politikë për të bërë dicka të mirë, por që natyrisht kemi difekte dhe mangësitë tona.

Natyrisht nëse do jetoj, në moshë të thyer do jetoj me fotografi, me Tiranën e vjetër në mëndje, më shtëpitë e prishura s'do jetë më Kinema 17 Nëntori apo Kursal sic quhej dikur apo shkolla Kosova ku kam bërë shkollën, apo zonat tiranase me ato shtëpitë përdhese po aq njerëzore aq miqësore që tani po shndërrohen në palatë shumëkatëshe, përbinshe të tillë.

Zhvillimi sjell edhe këto aspekte që fshijnë memorjen, historinë njerëzore e krijon boshllëqë që ndihen kur I afroresh kurbës në rënje të jetës.

Do vazhdoje të ekzistojë kultura e shteteve të organizuara me institucione , qeverira, parlamente e ushtri, kufij pavarësisht se kufijt se do të bëhen sa vjen e më të depërtueshëm më (in)formalë, por do ketë institucione, angazhime kontraktuale të shtetit me shtete të tjera, marrëdhënie dypalëshe, po vendimtare do jetë qenia jonë në BE si anëtarë të klubit evropian dhe më t'u bërë të tillë do të ketë një kurë në pikëpamjen e pastrimit të institucioneve dhe çlirimit nga të këqijat e mëdha sic janë korrupsioni, klientelizmi, krahinarizmi që karakterizon jetën institucionale në Shqipëri.

Shqiptarët do të jenë më evropianë, do të detyrohen të flasin, të sillën si të tillë duke modeluar shoqërinë , politikën dhe kulturën me standarte që je i detyruar t'i respektosh.

Ben Blushi

1. Cilat forma përdorni për të komunikuar me publikun?

Janë tre: mediatike , përmes komunikimit me shtypin , forma më kolektive sic janë takimet, mbledhjet , mitingjet dhe e treta janë ato kokë më kokë, në mënyrë individuale.

2. çfarë roli luan Parlamenti në jetën e vendit tuaj dhe në gjykimin tuaj çfarë roli duhet të luajë?

Parlamenti është rregullatori dhe kontrollori i jetës politike, pjesa dërmuese e politikës dhe e ligjvënies konsumohet në Parlament, ai është zemra e demokracisë dhe pluralizmit në një vend ku përveç procesit të ligjvënies , i cili është i pakapërcyeshëm se ligjet mund të vendosen vetëm në Parlament dhe asgjëkundi tjetër dhe përveç se ka një rol rregullator, është arena e një debati politik me karakter social, ekonomik në varësi të temave të ditës. Roli i tij po forcohet përfshi edhe ndryshmet e reja kushtetuese dhe pasha e Parlamentit dhe ndikimi i tij ose i debatit parlamentar në opinionin publik është në rritje.

3. A keni ju një model në politikë?

Unë personalisht? Se kam menduar.....

4.Sa i rëndësishëm është për ju referimi ndaj ideologjive në politikë?

Roli i ideologjisë është praktikisht i zbehtë, pavarësisht se vazhdojmë të mbajmë një ndarje tradicionale majtas e djathtas më shumë për konvencion sesa për praktikë, apo për doktrinë zbatuese apo implementuese. Po të shohesh sesi sillen partitë në Shqipëri është e vështirë të shohesh sjellje shumë të djathta apo shumë të majta. Kjo ndodh për dy arsye: e para për shkak të një pluraliteti relativisht të ri që ka ka Shqipëria dhe një traditë të zbehtë demokratike të konsoliduar dhe e dyta sepse ideologjia e importuar të paktën në ditët tona është gjithmonë dhe me flu.

5. A i përgatisni ju fjalimet paraprakisht apo improvizoni?

Të dyja i bëj, varet nga rëndësia dhe pesha e debatit parlamentar, ka debate ku mund të shkosh i përgatitur sepse ata janë futur në një axhendë të përgatitur paraprakisht dhe në varësi të peshës së debatit dhe varësisë së temës mund të përgatitesh duke shkruar, por ka edhe gjëra që ke nuk ke mundësi ti parapërgatësh, pra duhet të ndjekësh debatin nëq ai lind aty ku je.

6. Si e konsideroni profesionin tuaj si politikan?

Profesioni i politikanit të jep mundësi të njihesh dhe kjo është arsyeja që shumë njerëz merren me politikë, shumë pak kanë ideologji apo ndonjë projekt për të vënë në jetë. Nevoja për t'u njohur është një shtysë e madhe sot në politikë, sepse duke qenë në politikë kthehesh në një njeri publik dhe ke më shumë vëmendje, dikush mendon se ke edhe më shumë respekt. Në këtë shumicë ka edhe një pakicë njerëzish që kanë projektet e veta dhe kjo është një shtysë e madhe. Ka dy mundësi: të hysh për t'u bërë i njohur dhe të bëhesh pjesë e projektit të dikujt tjetër ose të ndjekësh projektin tënd nëse ke një të tillë.

7. Cfarë roli luan multimedia në komunikimin tuaj me publikun? Blogosferat, Facebook, Twitter?

Besoj se e ardhmja do ti japi më shumë rëndësi, sidomos në Shqipëri. Jemi akoma në fazën e televizionit ku 99 % e komunikimit publik zhvillohet nëpërmjet ekranit. Ka të bëjë me kulturën dhe me siguri edhe prapambetjen, ne kemi akses shumë të vogël në Internet, më të voglin në Evropë. Ka disa pengesa objektive.

8. çfarë gjuhe përdorni ju, gjuhë letrare apo dialekt?

Në zonën ku unë kryej aktivitet politik, në Korçë sigurisht ka dialekt po është shumë afër gjuhës letrare, kështu që pak ose shumë pak bie në sy. Sigurisht në takime politike përdor gjuhën letrare, po dialekti është pjesë e takimeve rutinë të ditës. Dialekti luan rol, ka raste ku luan rol, sidomos në fushata kur gjuha politike ka arsye të jetë disi më e thjeshtë, më e kuptueshme, ndoshta e mbushur me batuta apo shprehje të zonës, kjo lloj gjuhe qoftë dialektore ose pak folklorike ka ndikim duke i dhënë një rrezve përshtypjen se ti e njeh zonën dhe e kupton atë.

9. Si e përfytyroni Shqipërinë pas 30 viteve dhe si mund të arrihet aty?

Në ç'kuptim? Gjëja e parë që më vjen ndër mend është të them që do jetë anëtare e BE, por kjo nuk mjafton. Çështja shtrohet si do jetojmë, jo ku do jetojmë. Do jemi vend me shumë pak arsye për të bërë politikë lokale kaq të ndezur dhe të rëndësishme siç e kemi sot. Do jemi duke u integruar dhe do jemi pjesë e një vendimarrje më globale europaine ose me gjerë kështu që arsyet për të ndërtuar politikë mbi konflikte lokale ndoshta do jenë zbehur në atë kohë.

Genc Sharku

1. Cilat forma përdorni për të komunikuar me publikun?

Vetëm forma edukimi jo një herë, ato që kanë ekzistuar një herë ë një kohë. Unë I përdor të gjitha mënyrat, komunikimet e drejtpërdrejta, telefoni non stop.

2. Cfarë roli luan Parlamenti në jetën e vendit tuaj dhe në gjykimin tuaj cfarë roli duhet të luajë?

Parlamenti aktualisht...të them me dy fjalë...por edhe me dy fjalë nuk thuhet...Parlamenti në aspektin e opinionit është shumë i hipërbolizuar në fakt roli i tij duhet të jetë tjetër...ta lidhim me pyetjen e parë, elektorat shpeshherë nuk e ka të qartë se cfarë është një Parlamentar, ngatërrohen dhe çdo problem e lidhin me Parlamentin, edhe problemet lokale i lidhin me Parlamentin, edhe ato personale. Aktualisht Parlamenti po kryen misionin e tij të tranzicionit. Meqë e tha dhe Kryeministri me hyrjen në NATO mbaroi edhe Parlamenti do të marri përmasa të reja.

Ne morëm një Parlament dhe parlamentarë që kishin të tjera atribte, nuk ishte ai misioni i parlamentarit. Në momentin që morëm këtë besim nga njerëzit, vërtet nuk i zgjidhëm hallet në mënyrë individuale, por janë zgjidhur në mënyrë masive sic është problemi i punësimit. Është ligji ai që rregullon edhe marrëdhëniet personale të votuesve.

3. A keni ju një model në politikë?

Kryetari i Partisë është modeli nr 1 që merret referencë në të tilla raste, Zoti Berisha dhe unë do të vlerësoja Znj. Topalli si përfaqësuese të legjislativit. Ndërsa në politikën e huaj do të vlerësoja Finin.

4. Sa i rëndësishëm është për ju referimi ndaj ideologjive në politikë?

Unë jam duke gjetur veten, jam në rrugë e sipër.

5. A i përgatisni ju fjalimet paraprakisht apo improvizoni?

Kur i drejtohem elektoratit janë improvizime se ndikohesh nga ambjenti dhe rrethanat, përveç se statistikave që si ndryshoj dot unë. Ndërsa gjatë seancave varet nga ngacmimet e momentit në sallë që edhe mund të reagosh gjithmonë paqësor, unë reagoj në këtë mënyrë.

6. Si e konsideroni profesionin tuaj si politikan?

Politikani nuk është profesion, është mision. Profesioni është tjetër gjë, pavarësisht se politikën e trajtojmë si të tillë, po nuk jam dakort. Është një mision i vështirë dhe përballjet që ndodhin në politikë tregojnë për suksesin, nëse ajo rrymë që unë përfaqësoj, apo dikush tjetër përfaqëson, atëherë ajo është politikë e suksesshme.

7. Cfarë roli luan multimedia në komunikimin tuaj me publikun? Blogosferat, Facebook, Twitter?

Ka zona ku multimedia e interneti luajnë rol, por zona që unë përfaqësoj nuk ti ofron këto mundësi. Për shkak të terrenit aty nganjëherë nuk funksionon celulari, jo më interneti. Emigracioni ka ndikuar shumë në kuptimin e këtyre mjeteve të reja të komunikimit. Njerëzit e tyre që jetojnë jashtë i nxisin të përqafojnë mjetet e reja të komunikimit.

8. Cfarë gjuhe përdorni ju, gjuhë letrare apo dialekt?

Unë përdor gjuhën letrare se fatmirësisht zona ime flet gjuhë letrare.

9. Si e përfytyroni Shqipërinë pas 30 viteve dhe si mund të arrihet aty?

Unë e shoh shumë të lidhur me tim bir, ai do jetë 37 vjeç... unë në fakt do të dëshirjoja të mos përdorej më ndërhyrja, lidhjet, miqësia që të jemi transparent ndaj korrupsionit, dmth të mos ndikojnë në punësim, të shmanget nepotizmat, çdo gjë do të shkojë mirë. Do të ketë shumë ndryshime në aspektin legjislativ duke qenë se do të jemi anëtarë të BE-së

Gjovalin Prenga

1 Cilat forma përdorni për të komunikuar me publikun?

Forma e parë janë takimet publike. Marr pjesë shpesh në takime publike për çështje të caktuara që kanë lidhje me zonën elektorale, ato janë periodike, synoj që të jenë periodike. Pastaj është edhe forma ligjore, unë kam një zyrë që e hap çdo të premte në të cilën pres njerëz, ndonëse njerëzit jo gjithmonë vijnë për çështje që kanë të bëjnë me punën

time, vijnë shpesh për çështje që kanë të bëjnë me pushtetin lokal, gjithsesi kontakti me ta është i mirë, qoftë edhe duke i adresuar aty ku duhet të trokasin. Pastaj edhe kontaktet njerëzore natyrisht, unë jetoj në Mirëditë dhe jam i pranishëm atje çdo ditë. Ndërkohë unë jam përherë i pranishëm në nivel lokal, në analizat që bëhen nga prefektura, jam i angazhuar dhe marr informacion nëpërmjet drejtuesve për problematikën e zonës. Sa për median, ne kemi edhe media lokale, por nuk është fort prezente. Unë kam marrë pjesë në emisone edhe në median lokale, por për çështje të mëdha të politikës që s'besoj se kanë pasur ndonjë interes fort të madh për zgjedhësit. Media lokale imiton shpesh atë kombëtare dhe nuk luan ndonjë rol. Komunukimi në median lokale determinohet nga cilësia e kësaj të fundit.

2. çfarë roli luan Parlamenti në jetën e vendit tuaj dhe në gjykimin tuaj çfarë roli duhet të luajë?

Parlamenti është vendi ku promovohen politikat dhe përplasen konceptet. Roli i tij sa po vjen dhe po forcohet. Shpesh politika ka qenë ekstraparlamentare dhe tani besoj që parlamenti po fiton rol qoftë edhe nëpërmjet institucioneve që janë në varësi të tij, që kontrollohen dhe monitorohen prej tij. Une mendoj që roli i Parlamentit po forcohet edhe nëpërmjet komisioneve që ndjekin sektorë të veçantë të qeverisë në aspektin e zbatimit të atyre politikave që janë të përcaktuara në parlament dhe në aspektin që është kryesor të zbatimit të ligjmërisë. Edhe për buxhetin e shtetit roli i Parlamentit është shumë i fortë në monitorimin e qeverisë në zbatimin e buxhetit. Parlamenti tashmë ka fituar edhe një dimension të ri që është ai i diplomacisë parlamentare që ka qenë besoj një etapë, një veprimtari që ka dhënë rezultate. edhe risi, absolutisht risi por që ka dhënë rezultate.

3.A keni ju një model në politikë?

Eh..besoj jo model, model ekzakt jo.Unë nuk pëlqej protagonizmin e politikanëve në Shqipëri.Nuk më pëlqen protagonizmi. Unë mendoj se roli i politikanit është të shërbeje, dhe

jam i mendimit se protagonizmi shpesh i sforcuar nuk është në shërbim të qytetarit, përkundrazi është më fort në shërbim të vetë politikanit. Kështu që do pëlqej edhe diskursin politik. Shpesh ka ballafaquar diskursin politik në Shqipëri me diskursin politik në Kosovë apo në vende të tjera. Ai yni është shpesh emfatik, me fraza të fryra që praktikisht nuk thonë asgjë, me një oratori boshe me fjali shumë të gjata. Ato përdoren në funksion të atij që përmendëm më sipër, të protagonizmit politik dhe po ti shtrydhish çfarë ka brenda do dilte gjysma ose çereku i tyre. Une do isha jo për modelet e njohura, që të them të drejtën nuk i pëlqej. Një model që pëlqej është modeli i Ridvan Bodes sepse është konkret, ndërsa në arenën ndërkombëtare Fini është një politikan që më pëlqen shumë se është vetvetja.

4. Sa i rëndësishëm është për ju referimi ndaj ideologjive në politikë?

Ne kemi një përvojë shumë të keqe me ideologjitë, përvojë negative. Por besoj se për secilën forcë politike është shumë e rëndësishme të identifikohet me interesat e një grupimi të një shtrese të caktuar dhe të llojë për ato interesa. Kjo është shumë e rëndësishme për vetë identitetin e forcës politike dhe për stabilitetin e saj, për karrierën, për demokracinë brenda partisë. Mendoj se ideologjitë janë të rëndësishme në kuptimin pragmatik, më saktë besnikëria ndaj disa parimeve që përcaktojnë karakterin e një force politike.

5. A i përgatisni ju fjalimet paraprakisht apo improvizoni?

Sigurisht që i përgatis. Në komisione jo, aty i besoj improvizimit, aty je i detyruar të përgjigjesh diskutimeve dhe mënyrës sesi rrjedhin diskutimet. Ndërsa në Parlament i përgatis me kujdes. Edhe kur flas për çështje që i njoh mirë apo pretendoj se i njoh mirë që ka ndjeshmëri zona dhe përpiqem most të dal në përfundime kategorike

6. Si e konsideroni profesionin tuaj si politikan?

Profesioni im i parë nuk është politikan dhe tani kam filluar të mendoj se si do kthehm në profesionin tim. Mendoj që në Shqipëri është një profesion që konsumon, sigurisht edhe

promovon. Unë besoj se secili politikan në vetvete do të realizojë diçka për njerëzit që e mbështesin dhe është shumë e vështirë ta bëjë një gjë të tillë prandaj them se politika në Shqipëri është shumë centrifugale dhe të konsumon. Megjithatë unë nuk jam njeri nihilist, unë mendoj se në 18 vjet në Shqipëri është bërë goxha punë, këta 4 vite është bërë shumë punë, por edhe në 18 vite, nuk jam nihilist dhe e vlerësoj sa ka ecur Shqipëria. Ka ecur mënyra e të bërit politikë, ka ecë ndjeshmëria ndaj shërbimit ndaj njerëzve, kanë ecur shumë

7. çfarë roli luan multimedia në komunikimin tuaj me publikun? Blogosferat, Facebook, Twitter?

Jo në masë, Facebook jo, por emailin po, edhe internetin por duhet parë edhe shtrirja në zonën time. Unë nuk përfaqësoj ndonjë zonë fort të urbanizuar. Unë përdor at mjete që më japin rezultat, nuk do të më pëlqente me qenë snob me fut gjera moderne që nuk shkojnë në zonën time. Celulari është mjet pune i përhershëm sepse në gjithë zonën zgjedhësit e mi pothuajse të gjithë e kanë atë.

8. çfarë gjuhe përdorni ju, gjuhë letrare apo dialekt?

Unë përdor gjuhën e zgjedhësve sepse ajo ndikon në shkrirjen e distancës. Tek ne ka një prirje drejt autoritetit, prirje kjo e trashëguar dhe sidomos deputetin e shohin sikur ç'është...besoj se gjëja më e rëndësishme është komunikimi dhe duke përdorur gjuhën e tyre shkrihen akujt, shkurtosh distancën dhe të arrish të komunikosh duke përcjellë diçka por edhe të marrësh diçka se ndryshe ska sens.

9. Si e përfytyroni Shqipërinë pas 30 viteve dhe si mund të arrihet aty?

Shiko e mendoj...do të them një shaka: një politikan austriak më pati thënë një herë: 'A mendon që do ta shohesh Shqipërinë të lulëzojë?'- e i thashë sigurisht që po. Ai më pyet se ç'fëmijë kam dhe i tregova se kam një vajzë 13 vjeçare. Ai nguli këmbë se vajza ime do kishte mundësi që ta shihte. Ndërsa unë ngula këmbë që edhe unë do ta shoh sepse jemi vend i

vogël me një dëshirë të madhe për të ecur përpara. Politikani austriak vijoi tregimin duke më konfiduar se gjyshi i tij kishte punuar shumë dhe kishte jetuar pak, babai i tij kishte punuar dhe jetuar pak, ai kishte punuar më pak dhe jetuar mirë duke krijuar përshtypjen se duhen tri breza.

Unë iu përgjigja se Evropa është e vjetër, kjo është Evropa kontinentale, ndërkohë është globalizuar dhe ritmet e zhvillimit përcaktohen nga dëshira për t'i bërë gjërat. Unë e besoj këtë gjë, dhe besoj se për 30 vjet në do të kemi standarte dhe do të jemi të barabartë me vendet evropiane, une për vetë e besoj fort këtë gjë duke u nisur nga ritmet e këtyre 18 viteve. Ne sigurisht jemi akoma larg vendeve të zhvilluara, por nëse shikojmë trendin në rritje, jemi goxha përpara.

Kryetari i Parlamentit maqedonas më ka thënë njëherë se ju (shqiptarët) keni ecur me ritme shumë më të shpejta se ne (maqedonasit).

Ne kemi potenciale dhe i pari potencial është dëshira dhe ajo është shumë e rëndësishme dhe do punojmë për të.

Parid Teferiçi

1. Cilat forma përdorni për të komunikuar me publikun?

Preferoj kryesisht takimet e drejtpërdrejta me votuesit. Shkrimet nëpër gazeta, por janë shumë të rralla, edhe daljet në television, akoma më të rralla.

2. çfarë roli luan Parlamenti në jetën e vendit tuaj dhe në gjykimin tuaj çfarë roli duhet të luajë?

Duke qenë Shqipëria Republikë Parlamentare, Parlamenti duhet të jetë institucioni kyç në mekanizmin legjislativ dhe social në Shqipëri. Aty ndërmerren gjithë nismat kryesore edhe duke qenë Republikë Parlamentare edhe roli i deputeti merr përmasa të tjera.

3. A keni ju një model në politikë?

Më shumë sesa modele kam shembuj të miqve të mi, të cilët janë angazhuar në politikë që herët. Si rast mund të marr Sokol Olldashin, mik i hershëm i imi dhe ka qenë moshatar me mua, i apasionuar dikur pas letërsisë, ka shkruar poezi dhe më pas iu përkushtua me sukses politikës. Për mua ai është modeli i politikanit të suksesshëm.

4.Sa i rëndësishëm është për ju referimi ndaj ideologjive në politikë?

Megjithëse disi të zbehura pas shekullit të 20-të ku prirjet ideologjike qenë shumë të forta, periudha post moderne vjen me humbjen e ideologjive të mëdha , më shumë beteja zhvillohet e atomizuar, e copëzuar. Nuk mund të themi që ekziston një ideologji e majtë apo e djathtë që përballen, për probleme të ndryshme kemi kundërvenie të ndryshme mënyrash dhe zgjedhjesh, kemi kaluar në gjëra teknike më shumë se në ndarje ideologjike dhe parimore. Këtu mund të përmend reformat standarte të kryera nga 3 korriku e këtej si model i reformave të sukseshme. Fakti që jemi në vigjilje të hyrjes në Nato dhe në vigjilje të hyrjes si vend kandidat në BE mendoj që tregojnë për suksesin e reformave së kësaj qeverie të djathtë.

5. A i përgatisni ju fjalimet paraprakisht apo improvizoni?

Absolutisht i përgatis përpara.Më mungon aftësia dhe eksperiencia që të improvizoj fjalime.

6. Si e konsideroni profesionin tuaj si politikan?

Atëherë, politika në Shqipëri si profesion është pak si atipike, nuk është si në vendet e tjera me demokraci të zhvilluar ku politika mund të konsiderohet si profesion I mirëfilltë në konceptin weberian.Në Shqipëri duke pasur aprasysh edhe lëkundjet dhe sizmikën, nuk mund të ketë askush siguri në jetëgjatësinë politike, përveç se angazhohet fort dhe në mënyrë konsistente.

7. çfarë roli luan multimedia në komunikimin tuaj me publikun? Blogosferat, Facebook, Twitter?

Me turp e them se e përdor pothuajse fare qoftë emailin qoftë mjetet e tjera të Internetit.

8. çfarë gjuhe përdorni ju, gjuhë letrare apo dialekt?

Në shumë raste edhe dialektore si një shenjë përkatësie komunitare përdorimi i një gjuhe me të cilën je rritur dhe ke komunikuar me qytetarët e tu. Pastaj dialeti kavajas është shumë i këndshëm.

9.Si e përfytyroni Shqipërinë pas 30 viteve dhe si mund të arrihet aty?

Më mungon ky horizont parashikimi , por jam shumë optimist edhe për Shqipërinë e pas 5 viteve, them që po shkojmë në drejtimin e duhur, do të jemi patjetër pjesë e familjes europiane dhe do të jemi seriozisht pjesë e asaj kulture së cilës i përkasim, qytetërimit perëndimor.

Kjo do të arrihet duke forcuar sistemin demokratik, ekonominë e lirë të tregut dhe duke u ndërgjegjësuar i tërë populli shqiptar mbi përkatësinë e tij dhe vetë demokracia i ka mjetet për t'ia arritur këtij qëllimi, vota është mjeti më i mirë për të vetërregulluar një vend.

Ermelinda Meksi

1.Cilat forma përdorni për të komunikuar me publikun?

Forma më e shpeshtë është ajo direkte që varjon nga takimet e organizuar tek mbledhjet , por ma lënë pas dore dhe mesazhet, emailed e letrat që marr përditë si rezultat edhe i të qenit tim aktive në politikë , por jo vetëm. Fakti që lektoroj në Univeristet më sjell shumë pranë brezit të ri. Një formë tjetër komplekse janë edhe debatet televizive, pra prania në media.

2. çfarë roli luan Parlamenti në jetën e vendit tuaj dhe në gjykimin tuaj çfarë roli duhet të luajë?

Parlamenti në fakt duhet të luajë rol shumë të rëndësishëm si një institucion që i jep mundësi për transparencë publikut, por për fat të keq jo gjithmonë ndodh kështu. Për hir të së

vërtetës duhet pranuar se mazhoranca i lë shumë pak hapësirë debatit dhe këtu dua të përmend debatin për buxhetin. Po të ndiqni fjalët e mia në Parlament, unë kam tërhequr vëmendjen për çështje shumë të rëndësishme siç janë buxheti, integrimi evropian etj. Po të vini re në publik ka një debat për shifrat dhe bëhet shumë pak debat për çështje të rëndësishme. Ajo çka është e rëndësishme është që palët të dallohen nga alternativat që ofrojnë. Për shembull unë kam mendimin që qeveria shqiptare nuk ka reaguar me politika të forta për parandalimin e krizës.

3.A keni ju një model në politikë?

Unë mendoj se me përmbysjen e sistemit në vitet '90 ne u sfiduar për të realizuar gjërat ndryshe. Unë e konsideroj veten një idealiste që kërkon të përballojë sfidat dhe të zgjidhi problemet duke synuar perfeksionizmin dhe të bërit e gjërave sa më mirë. Një figurë që më frymëzon është Nënë Tereza, një jetë e kalaur në misionin e saj në shërbim të njerëzimit. Edhe unë besoj tek mundësia e njerëzve për të bërë mirë e për të sjellë ndryshim.

4.Sa i rëndësishëm është për ju referimi ndaj ideologjive në politikë?

Roli i ideologjive është i rëndësishëm në konceptin e alternativave, jo në kuptimin që është përdorur deri dje. Besoj se duhet të ekzistojë për shembull një platformë politike e së majtës që mbështetet në ide të shtjelluara mirë në shërbim të njerëzve duke iu ardhur atyre në ndihmë me politika sociale të caktuara.

5. A i përgatisni ju fjalimet paraprakisht apo improvizoni?

Unë mendoj se përgatitja paraprake është shenjë serioziteti dhe unë i përgatis gjithnjë.

6. Si e konsideroni profesionin tuaj si politikan?

Mendoj se do të bëj politikë dhe do të jem pjesë e saj për deri sa të kem frymëzimin për të bërë një gjë të tillë. E konsideroj si sfidë të momentit, por gjithmonë komplementare me profesionin tim të lektore. Gjithsesi mendoj se ky mision do të mbarojë një ditë, por për

deri sa kohë të mëndoј se kam për të dhënë dhe jam e frymëzuar për të punaur fort për të mirën e njerëve, në shërbim të tyre do të mbetem në politikë.

7. çfarë roli luan multimedia në komunikimin tuaj me publikun? Blogosferat, Facebook, Twitter?

Siç e thashë më sipër, përdor të gjitha format e komunikimit me elektoratin përfshi këtu mesazhet e shumta që shkëmbeј me ta, emailet me dashamirësit brenda dhe jashtë vendit. Me mënyrat e reja të komunikimit, debatet tona televizive ndiqen edhe jashtë kështu që mua më vijnë komentet edhe nga bashkëatdhetarët tanë që jetojnë përtej kufijve.

8. Cfarë gjuhe përdorni ju, gjuhë letrare apo dialekt?

Përdor gjuhë letrare.

9. Si e përfytyroni Shqipërinë pas 30 viteve dhe si mund të arrihet aty?

E përfytyroj shumë ndryshe, nëse vazhdon me këto ritme ndryshimi dhe nxjerrim mësime nga pësimet tona, shoh një të ardhme të ndritur, natyrisht pjesë e familjes europiane dhe strukturave të saj.

Irida Vorpsi

Home Address: Molkereisst.1 3066/2
1020 Vienna
Austria

Email: irida.vorpsi@gmail.com

Mobile Phone: (355)692265797

Date of Birth: 14.07.1979
Female

Nationality: Albanian

Gender:

Education:

- **October 2007-July 2009** EMGS Master of Arts in Global Studies- A European Perspective; University of Leipzig & University of Vienna
- **January 2006, George Washington University & Georgetown University;** Junior Faculty Development Program in D.C. which combines for 6 months research and the attendance of courses in Cultural Anthropology
- **October 2003-September 2004** DEEI-MASTER (online) in European Studies at Institut de Recherches et d'Enseignement en Relation Internationales & Européenne . Master thesis: "Albania: from the communist isolation to the European Integration"
- **September 2000-February 2001** One semester exchange student at KARL- RUPRECHT UNIVERSITY Heidelberg
- **March –July 2003** One semester exchange student at Humboldt University zu Berlin
- **September 1998-July 2002** University of Tirana, Albania, Undergraduate Diploma in German Studies

Current Employment:

March 2004-Present Lecturer at the Faculty of Foreign Languages,
German Department, University of Tirana
(Subjects: "Political Geography", "Civilization" and "Text Analyses")

February 2004-Present Part Time Instructor at Goethe Institute in Tirana

March 2004-March 2009 Peace Corps Language Tester (Conduct
language proficiency interviews)

Freelance journalist: writing analysis, opinions and editorials for daily & monthly newspapers in Albania.(Shekulli, Gaia Magazine, Gazeta e se Shtunes and Standard) .

Work Experience:

- **January 2007 –January 2009** Member of the Advisory Board of Regional Centre for Minorities) RCM is an regional NGO based in Belgrade which has been established and supported by Swedish Helsinki Committee for Human Rights.
- Activist of the **Albanian Liberal Institute** which is the only free market think tank established in March 2003. The Albanian Liberal Institute is a public policy institute,

- member of various international networks like the Stockholm Network, International Policy Network and Freedom Network.
- January- July 2003 Short period of research at the German Bundestag working with the MP Dr. Lale Akguen

Additional training, studies and attendance of seminars and conferences

- Attended the Summer School on Goethe and its Poetry at Otto Friedrich University in Bamberg. July 1999
- Attended the gathering: A Balkan without war in Leipzig August 2000
- Research period at Ruprecht-Karls-Universität Heidelberg October-December 2001
- Attending training seminars at: Friedrich Ebert Foundation in Berlin. March 2003
- Participated at seminar of the Hans Seidel Foundation in Brussels. April 2004
- Attended the seminar of Konrad Adenauer Foundation in Eichholz, May 2003
- Attended the American Institute on Political and Economic System organized by Charles University and Georgetown University. I attended graduate classes and sat for the final exam at the end of the course in Prague July 2004
- Attended the International Summer Seminar: “The European Union: 2005 and beyond” organized by Westminster University and Centre for European Studies in Belgrade in Montenegro. July 2005
- Attended the Seminar in Goethe Institute “PC in Teaching with a focus on Methodology” in Munich. August 2005
- Attended the Summer School “Cultural Identities in Balkan and Europe” organized by Westminster University and Belgrade University in Budva. September 2005
- Research at Vienna University in June 2006
- Attending the summer school “Nationality and Democracy” organized by Westminster University, Belgrade University and Centre for European Studies in Belgrade. September 2006
- Research period at Friedrich –Schiller University in Jena May-June 2007
- Attendance of the II PhD summer school on Methods of research organized by Sofia State University "Saint Kliment Ohridski" in Sozopol. June 2007
- Attended the VII European Young Leaders Conference **“Superpower Shadows”** July in Kranj. July 2007
- Participated in the 4th International Student School devoted to the Human Rights and Democratic Values in the EU-Russia Dialogue organized by Lomonosov Moscow State University in Paris. November 2007
- Participated in the ENIUGH congress in Dresden. July 2008
- Participated in HEC summer school organised by European University Institute in Florence. September 2008

Additional Skills:

Native Albanian, excellent command of English, German and Italian, good knowledge of French, passive Spanish. Moreover very good computer skills, fast typing and good knowledge of Microsoft Office, experience Web Design. Clean driving licence.

Interests:

Books, politics, history, international relations, political science, foreign languages, travel.

Awards:

- ❖ DAAD Scholarship in 2001
- ❖ Awarded the IPP fellowship from the German Parliament and the Consortium of the Universities in Berlin 2003
- ❖ Awarded the JFDP fellowship from State Department of USA in 2006
- ❖ Awarded the Erasmus Mundus Scholarship from European Union in 2007